




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR' S OFFICE – BAŞKAN OFISI

RAPORTI VJETOR I PUNËS

Janar – Dhjetor 2019

Gjilan, 2020

Përmbatja

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS, Z. LUTFI HAZIRI.....	1
I. DREJTORIA E ADMINISTRAËS SË PËRGJITHSHME.....	2
II. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË.....	8
III. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM.....	15
IV. DREJTORIA PËR ARSIM	17
V. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	26
VI. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	28
VII. DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	57
VIII. DREJTORIA E INSPEKSIONIT	61
IX. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA.....	68
X. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK	69
XI. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM	74
XII. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	77
RAPORTET E PUNËS SË ZYREVE DHE NJËSIVE	90
I. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	90
II. NJËSIA E KUVENDIT	90
III. NJËSIA E PERSONELIT.....	92
IV. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT.....	94
V. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM	98
VI. ZYRA LIGJORE	101
VII. ZYRA PËR INFORMIM	102
VIII. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE.....	103
IX. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	103
X. ZYRA E AVOKATIT TË KOMUNËS.....	109
XI. ZYRA PËR PRESHEVË, BUJANOC DHE METVEGJË.....	110

FJALA HYRËSE E KRYETARIT TË KOMUNËS, Z. LUTFI HAZIRI

E nderuar zonja kryesuese e Kuvendit, të nderuar anëtarë të Kuvendit, drejtorë, përfaqësues së institucioneve të Komunës, shoqërisë civile dhe mediave,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që para jush të paraqesë raportin vjetor të punës për vitin 2019. Është kënaqësi të paraqes të arriturat, sukseset por edhe sfidat dhe vështirësitë me të cilat është përballur Komuna e Gjilanit gjatë kësaj periudhe kohore.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që të kryejmë pjesën më të madhe të objektivave, aktiviteteve si dhe detyrave sipas planifikimeve strategjike dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky raport, sikurse edhe raportet paraprake ofron punët, aktivitetet dhe rezultatet e çdo Drejtorie , Zyre dhe Njësie Administrative të Komunës. Falë përkushtimit dhe angazhimit të të gjithë stafit sipas përgjegjësiave, kompetencave dhe me profesionalizëm, janë realizuar me sukses objektivat dhe janë përmbushur detyrat punuese në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës së Gjilanit, pa dallim duke reflektuar pozitivitet në ndërtimin e një administrate profesionale, efikase, transparente dhe të përgjegjshme si dhe motivim shtesë për angazhimin e mëtutjeshëm në tejkalimin e sfidave në të ardhmen.

Raporti në fjalë përfshinë projektet e ndryshme të realizuara dhe ato të cilat janë në proces të realizimit të secilës drejtori dhe secilës njësi organizative, raporti në fjalë përmban edhe të dhëna statistikore ku ndërmjet tjerash, ju të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, qytetarë të nderuar, keni mundësinë për t'u informuar më në hollësi përkitazi me çështjet e raportuara në këtë dokument si për projektet madhore, investimet në infrastrukturë, çështjet buxhetore, të arriturat në arsim, shëndetësi, subvencionimi i bujqve, aktivitetet kulturore, bashkëpunimet e komunës me instancat e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe të gjitha fushat dhe shërbimet e tjera administrative që prekin interesat e përditshme të qytetarëve të komunës sonë.

Sikurse në vitin paraprak edhe në këtë vit kemi pasur projekte të ndryshme dhe të shumta, kemi pasur investime të shumta në shumë fusha, kemi ofruar shërbime efikase administrative dhe si të tilla vazhdojnë të jetësohen për qytetarët e Komunës sonë, duke u mbështetur edhe nga donator, partnerë dhe investitorë të ndryshëm që kanë shprehur dhe vazhdojnë të shprehin interesim për të ndihmuar komunën tonë në ngritjen e kapaciteteve në shumë sfera, ku njëherësh përfitoj nga rasti që të ju shprehi falënderim dhe mirënjohje të thellë!

Si kryetar i Komunës, më lejoni që në fjalën time të paraqes shkurtimisht raportin vjetor të punës, në mënyrë që të keni hapësirën dhe kohën edhe ju si anëtarë të Kuvendit Komunal për të marrë informacione shtesë për punën dhe aktivitetet që kemi realizuar gjatë kësaj periudhe dhe mund t'i referoheni të dhënave të prezantuara më gjerësisht në këtë raport.

Ju falënderoj të gjithëve për punën, angazhimin, dhe kontributin tuaj në të mirë të Komunës sonë dhe qytetarëve tanë. Për çfarëdo pyetje shtesë që mund të keni, ju lutem t'i adresoni ato tek ne dhe drejtoritë përkatëse për përgjigje ose shpjegime shtesë.

I. DREJTORIA E ADMINISTRAËS SË PËRGJITHSHME

Ky raport vjetor i Drejtorisë për Administratën e Përgjithshme përmban një pasqyrë të aktiviteteve dhe punëve të realizuara gjatë vitit 2019 në harmoni me planin e punës si dhe legjislacionin në fuqi. Edhe për vitin 2019, DAP-i, synim dhe fokus kryesor ka pasur ofrimin e shërbimeve sa më cilësore, profesionale, efikase dhe transparente për të gjithë qytetarët pa dallim të cilët frekuentojnë për realizimin e kërkesave të tyre si dhe ngritjen e mëtutjeshme të përgjegjshmërisë në punë.

Në këtë raport do të prezantojmë të arriturat dhe aktivitetet e realizuara në tri sektorët si shtylla bazike të kësaj drejtorie.

Drejtoria e Administratës së Përgjithshme ofron shërbime permanente dhe zhvillon procedura administrative sipas kërkesave të palëve. Numri dhe shumëllojshmëria e disa nga parashtrësive të paraqitura dhe të zgjidhura janë të pasqyruara në tabela . Më poshtë i referohemi statistikave sipas llojit dhe natyrës së dokumentit.

Sektori i Gjendjes Civile :

Sektori i Gjendjes Civile ofron shërbime të gjendjes civile siç janë: plotësimi, përditësimi dhe administrimi i regjistrave të gjendjes civile, zhvillimi i procedurave administrative, mbajtja e akteve të gjendjes civile, lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile si dhe veprimeve tjera juridike administrative në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Dokumentet e lëshuara nga Sektori i Gjendjes Civile			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2019	31.12.2019
Lloji i dokumentit :			
Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile			54647
Certifikatë lindje			28822
Certifikatë martese			13058
Certifikatë vdekje			3726
Aktvdekje			332
Certifikatë vendbanimi			3757
Certifikatë të bashkësisë familjare			12915

Certifikatë të gjendje martesore	3049
Certifikatë shtetësie	1817
Lëshimi i vërtetimeve të gjendjes civile nga arkivi	5349
Lëshimi i dokumenteve nga arkivi i Komunës	247
Aplikim për fitim të shtetësisë	77
Aplikim për lirim të shtetësisë	115
Totali	127911

Vërejtje : në këtë pjesë të raportit, përpos lëshimit të dokumenteve të gjendjes civile, numerikisht evidentohen – hyjnë në sistemin elektronik edhe verifikimet e dokumenteve të ndryshme personale sipas kërkesave të qytetarëve – palëve.

Numri i qytetarëve që kanë kaluar në regjistrin qendror të gjendjes civile :	6663
--	------

Veprimet – Procedurat e zhvilluara administrative : lindjet, martesat dhe vdekjet			
Komuna		Data prej	Data deri
Gjilan		01.01.2019	31.12.2019
Lloji i dokumentit :			
Lindjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë, brenda dhe jashtë vendit :			2051
Martesat e lidhura dhe rishkrim martesë :			1734
Shkurorëzimet :			101
Martesat me element të huaj :			211
Vdekjet e regjistruara të rregullta dhe me vonesë brenda dhe jashtë vendit :			567
Totali			4664

Siç shihet nga ky raport, sektori i gjendjes civile ka qenë mjaft efikas dhe funksional në lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe zhvillimin e procedurave administrative për rregullimin e çështjeve të gjendjes civile sipas kërkesave të palëve.

Qendra për Shërbim me Qytetarë:

Është pjesë e strukturës organizative të administratës. Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ si: bëjnë pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet tjera. Këto kërkesa/parashtresa, të kompletuara përcillen në drejtoritë e administratës komunale, varësisht ku pala parashtron për shqyrtim dhe vendosje. Pasi që drejtoria përkatëse ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me kërkesën/parashtresën e palës, të njëjtat kthehen në QSHQ-ë. Zyrtarët e QSHQ-së, janë të obliguar të njoftojnë qytetarët dhe subjektet e tjera për përgjigjen në kërkesa/parashtresa.

Raporti sipas drejtorive dhe statusit të zgjidhjes së lëndëve

01/01/2019 - 31/12/2019

Drejtoritë	Pranuar	Në Proces	Miratuar	Refuzuar	Hedhur Poshtë	Pezulluar	Ceduar	Anuluar	Përfunduar	Totali
DAP	0	0	11,605	16	0	0	0	22	86,905	98,548
DKA	79	0	4,547	10	1	0	0	2	0	4,639
DGJKP	532	367	17,487	11	0	0	0	34	0	18,431
DBF	0	15	136	81	0	0	0	2	0	234
DMSH	0	0	152	1	0	0	0	0	0	153
DUPMM	6	519	729	0	0	0	0	3	0	1,257
DSHPIB	28	553	22,527	0	0	0	0	9	0	23,117
DSHMS	5	335	3,726	218	2	0	0	4	0	4,290
DBP	0	0	2,339	465	0	0	0	1	0	2,805
DZHE	0	1	113	4	0	0	0	0	0	118
Kuvendi i Komunës	0	260	88	0	0	0	0	0	0	348
Kryetari i Komunës	13	1,326	2,142	2	0	0	0	5	0	3,488
DI	0	77	978	4	0	0	0	7	0	1,066
DKRS	0	93	109	11	0	2	0	0	0	215
I Institucionet Qendrore	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Totali	663	3,546	66,680	823	3	2	0	89	86,905	158,711

Siç shihet nga kjo pjesë e raportit, Drejtoria e Administratë së Përgjithshme nëpërmjet Qendrës për Shërbim me Qytetarë, ka qenë mjaft efikase dhe shumë funksionale në realizimin lëndëve si të përfunduara me kohë dhe brenda afateve ligjore prej: 86.905 lëndë, me çka konkludohet se shërbimi ndaj qytetarëve ka qenë në nivelin e kënaqshëm. Gjithashtu, niveli i kënaqshëm i shërbimeve ndaj qytetarëve ka qenë edhe në drejtoritë e tjera të Administratës Komunale, që me kohë kanë përfunduar – vendosur lëndët sipas kërkesave/parashtresave të qytetarëve.

Sipas raportit të intranetit, ku edhe MAPL-ja, raporton për Komunat, në këtë periudhë një vjeçare , përmes QSHQ-së, janë pranuar: 158711 kërkesa nga palët, adresuar organeve komunale për shqyrtim dhe vendosje, të përfunduara janë : 154502, ndërsa në proces janë : 4209.

Shikuar në përqindje del se Komuna e Gjilanit, i ka kryer lëndët sipas Ligjit të Procedurës Administrative me një përqindje të kënaqshme prej : 97.3%.

Shërbimi i Autoparkut :

Kujdeset për automjetet zyrtare të Komunës. Ky shërbim ka detyra dhe obligime permanente, por edhe procedurat për shfrytëzimin e automjeteve të Komunës janë të njohura.

Kërkesat për shfrytëzim javor të automjeteve bëhen nga drejtoritë komunale ku përfshihet transporti lokal dhe fshatrat e komunës, kjo kërkesë nënshkruhet nga drejtori i drejtorisë apo i autorizuari i tij/saj, ndërsa kërkesat për shfrytëzim të automjeteve jashtë komunës , aprovohen nga Kryetari i Komunës.

Gjashtë mujori i vitit	Numri i automjeteve që posedon Komuna	Kilometra të kaluara	Sasia e derivateve të shpenzuara	%
2018	32	231780	20.398.91	9
2019	32	208994	17.797.39	8.61
Dallimi	1	-22786	-2601.52	0.39

Siç shihet nga kjo pjesë e raportit, gjatë vitit 2019, krahasuar me vitin 2018, kemi rënie të kilometrave të kaluara dhe shpenzimeve të derivateve.

Vlen të theksohet se Komuna i ndihmon organizatat e ndryshme në regjistrimin si dhe servisimin e automjeteve sipas kërkesave të tyre si : Hendikosi dhe Shoqata e të Verbërve.

Komuna ka kontratë për furnizim me derivate dhe sigurim të automjeteve, ndërsa janë në procedurë tenderuese servisimi i automjeteve.

Aktivite tjera të kryera :

I kemi bërë të gjitha përgatitjet e duhura pronësore juridike sa i përket ndërtimit të zyrës së gjendjes civile në lagjen “Arbëria” në Gjilan. Ky Projekt do të fillohet dhe pretendojmë të finalizohet gjatë vitit 2020.

Kemi arritur që përmes procedurave të prokurimit të sigurojmë – lidhim kontratë me operatorin ekonomik për rregullimin dhe mirëmbajtjen e katër E - kioskave të cilat deri më tani nuk kanë qenë funksionale si rezultat i defekteve. E-kisokat janë rregulluar dhe janë funksionale.

Kemi përfunduar kontratën lidhur me aktivitetin për sa i përket riparimit fizik të librave të gjendjes civile me qëllim që të krijojmë lehtësira teknike administrative për zyrtarët e Gjendjes Civile për të siguruar objektivitet, efikasitet dhe transparencë gjatë kryerjes së shërbimeve administrative në raport me qytetarët.

Kemi përfunduar projektin sa i përket aktivitetit që ka të bëjë me organizimin e punëve të arkivit Komunal. I tërë dokumentacioni i drejtorive, Njësi Administrative dhe Organeve të tjera të Komunës, është regjistruar dhe sistemuar sipas standardeve ligjore në kuadër të Arkivit të Komunës, proces i cili ka krijuar kushte më të mira dhe të shpejta për menaxhimin sa më efikas të lëndëve në raport me institucionin komunal dhe qytetarët.

Gjatë vitit 2019, kemi arritur të sigurojmë kapacitete të mjaftueshme si ato: materiale – infrastrukturën teknologjike e po ashtu edhe burimet njerëzore për t’i mbuluar nevojat e qytetarëve gjatë procesit të marrjes së shërbimeve.

Është me rëndësi të potencojmë se Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, ka filluar me projektin: digjitalizimi i Arkivit të Komunës, që fillimisht projekti përfshinë tri drejtori: Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim si dhe Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, për të vazhduar më tutje edhe me disa drejtori të tjera.

Projekti i digjitalizimit të arkivit, mundëson qasje të shpejta dhe më të lehta të qytetarëve në kërkesat e tyre arkivore e njëkohësisht është i mirëpritur edhe për vetë zyrtarët e Komunës gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të tyre.

Shërbimet e TI-së

Edhe në vitin 2019, nga menaxheri i TI-së është organizuar edicioni i dytë i konferencës Regjionale “ICT Conference 2019 – second edition”, e cila konferencë mbledhi përfaqësues të institucioneve shtetërore si agjencitë dhe ministritë e ndryshme jo vetëm nga Kosova por edhe shteti fqinjë Mali i Zi, ku në këtë konferencë janë prezantuar projekte të ndryshme si dhe sfidat e institucioneve shtetërore në fushën e Teknologjisë Informativë.

Si detyrë e përditshme është monitorimi i rrjetit qeveritar shtetërorë si dhe evitimi i prishjeve eventuale që janë paraqitur. Gjithashtu kemi monitoruar dhe mirëmbajtur rrjetin mikrovalorë në 5.x GHz duke përfshirë këtu edhe riparimet e defekteve.

Në kohë të vazhdueshme janë dhënë përkrahjen zyrtarëve/shërbyesve civil për të gjitha çështjet e Teknologjisë Informativë (instalime të kompjuterëve, printerëve, tonerëve, antivirusëve, kabllimeve të ndryshme, ndërrimin e lokacioneve, përdorimin e softuerëve të ndryshëm etj), këtu përfshihen të gjitha objektet komunale pra edhe ato nëpër fshatra.

Në kohë të vazhdueshme janë bërë mirëmbajtjet e WEB faqes zyrtare komunale dhe bëjmë përkrahje direkt zyrtarëve të ngarkuar me furnizimin me shënime në WEB faqen zyrtare. Të gjitha nevojat që paraqiten në rrjetin telefonik dhe centralet telefonike mirëmbahen nga ne e gjithashtu edhe të rrjetit të telefonave VOIP.

Sikurse edhe një vit më parë edhe në fund të këtij viti, janë dhënë përkrahje teknike në organizimin e gala mbrëmjes të organizuar nga Zyra e Kryetarit, duke përfshirë këtu kabllimet dhe instalimet e duhura të aparateve dhe rrjetit telefonik VoIP në bashkëpunim me PTK-në.

Aty ku kemi pasur mundësi, kemi futur kompjuterët në “Domain” me çka fitohet siguria e shënimeve, mbrojtja nga viruset, përdorimi i kompjuterëve për punët zyrtare, instalohen vetëm programet e licencuara dhe nuk do të ketë vend për programe “pirate” etj. Po ashtu sipas mundësive kemi aktivizuar email adresat zyrtare. Aty ku kanë lejuar mundësitë teknike të pajisjeve, janë instaluar sistemet operative Windows 10.

Si sfidë e vitit 2019 ka qenë instalimi i sistemit operativ të ri Windows 10 nëpër kompjuterët të cilët kanë karakteristika të mjaftueshme teknike për instalimin e këtij sistemi operativ, meqë sistemi operativ Windows 7 më nuk do të përkrahët nga prodhuesi nga mesi i muajit Janar i vitit 2020.

Në vazhdimësi kemi qenë në kontakt me zyrën e prokurimit. Kemi marrë pjesë në përpilimin e tenderëve lidhur me furnizimet për fushën e TI-së dhe po ashtu i këshillojmë rreth këtyre çështjeve. Po ashtu kemi qenë edhe pjesë e komisioneve të ndryshme për menaxhim të kontratës si dhe për pranime të pajisjeve

Është dhënë përkrahje teknike gjatë mbajtjes së mbledhjeve/seancave të Kuvendit Komunal duke kyçur pajisjet për përcjelljen e seancave përmes kanalit zyrtar Komunal të Youtube-s.

Në kohë të vazhdueshme është bashkëpunuar me Ministrinë e Administratës Publike – ASHI të cilët e bëjnë mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e serverëve dhe rrjetit qeveritar në përgjithësi.

Kemi dhënë përkrahje teknike edhe organizatave tjera si p.sh: QKMF, ambulancave, çerdheve, shollave fillore dhe të mesme, agjencionit të statistikave, shërbimit të emergjencës (112) etj.

Gjendja Civile dhe Intraneti:

Në vazhdimësi ndihmojmë ofiqarët dhe zyrtarët e GJC në shfrytëzimin e sistemit të GJC duke mos kursyer fare kohën dhe dijen tonë.

Vazhdimisht kemi pasur kontakte me kompaninë për mirëmbajtjen e “Intranetit” – “Cactus” dhe Ministrinë e cila implementon këtë sistem (sa për informatë, sistemi i ‘Intranetit’ përdoret nga të gjitha Drejtoritë Komunale).

Është bërë ndërrimi i tonerëve (sipas nevojës) në gjithë printerët e gjendjes civile si në qendër e po ashtu edhe nëpër fshatra.

Meremetimi i zyrave të kuvendit:

Nuk është kursyer fare në këshillimin në vend të ngjarjes me kompaninë e cila ka bërë meremetimin e zyrave të kuvendit në të cilat hapësira ka pasur nevojë për eliminimin e lidhjeve të vdekura e po ashtu në ruajtjen dhe ri-lokimin e lidhjeve aktive të rrjetit LAN si dhe linjave telefonike, gjithashtu kemi bërë kyçje e të gjithë kompjuterëve, printerëve dhe instalimin e rrjetit në gjithë kompjuterët në këto hapësira të meremetuara.

II. DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË

Në harmoni me planin e punës për vitin 2019, investimet i kemi orientuar në bazë të prioriteteve strategjike të sektorëve. Kemi ndërtuar partneritete me organizata vendore e ndërkombëtare si: Komisionin Evropian, IADK, Shkollën e mesme e agrobiznesit ARBËRIA, Hib Petrol, Shell Kosova si dhe së fundmi me OZHR mëshqerra.

Kemi subvencionuar në plotëni mbjelljet pranverore dhe vjeshtore me qëllim të punimit maksimal të tokës bujqësore.

Kujdesshëm po e trajtojmë prodhimtarinë në ambiente të mbyllura, duke e maksimalizuar shfrytëzimin e sipërfaqes tokësore, si dhe pajisjen e fermerëve me mekanizim bujqësor me qëllim të përgatitjes sa më cilësore të tokës.

Sektori i blegtorisë është trajtuar me prioritet të lartë duke mbështetur fermerët me 10 krerë gjedhe të racës Simental për përmirësim racor, si dhe 35 krerë gjedhe të racës së pastër Hollshtajn, makina mjelëse dhe mbështetjen e bletarëve me shtëpiza tre katërshe të tipit L & R.

Në sektorin e pemëtarisë, me kërkesë të pemëtarëve kemi ngritur 15 ha me arrë të var. chandler.

Edhe këtë vit kemi trajtuar rrugët fushore me qëllim të qasjes sa më të lehtë dhe rritjes së efijencës në punë, si dhe vëmendje të veçantë i kemi kushtua gjelbërimit të hapësirave publike.

Në mënyrë intensive jemi marr me vendgjetitë dhe i kemi dhënë epilog. Kemi trajtuar qentë endacak, në harmoni me ligjin. Një angazhim i madh është bërë në sektorin e pylltarisë duke mbrojtur pyjet nga prerja ilegale dhe vlerësojmë se gjendja është plotësisht e kontrollueshme.

Nga data: 01.01.2019 deri më datën 20.12.2019, kemi pranuar 2805 kërkesa për mbështetje dhe subvencione. Pozitivisht ju kemi përgjigjur 2339 kërkesave ose 83.39 %, ndërsa janë refuzuar 466 kërkesa ose 16.61 %.

Paraqitja tabelare e aktiviteteve

Nr.	Emërtimi i projektit	Donacion	Investimi komunal	Nr. i përfituesve	Kostoja e projektit / €
1.	Mbështetja e të rinjve në agrobiznes	Komisioni evropian	MM	162	
2.	Përmirësimi racor	Shkolla e mesme ARBËRIA	MM	5	
3.	Dhënia e vendgjuetive në menaxhim		ANKAND	3 Shoqatat e gjahtarëve	
4.	Rritja e vlerës së shtuar dhe mbështetja e të rinjve në agrobiznes	IADK	MM	50	
5.	Subvencionimi i mbjelljeve pranverore me farë misri		Komuna	572	16,400.00
6.	Subvencionimi i naftës për fermerë	Hib Petrol dhe Shell Kosova	MM		
7.	Furnizim i bletarëve me shtëpiza tre katëshe L & R		Komuna	70	8,600.00
8.	Makina mjelëse		Komuna	40	9,985.00
9.	Serra të zinguar		Komuna	20	33,670.00
10.	Përmirësim racor	Shkolla e mesme ARBËRIA	MM	5	
11.	Mekanizim bujqësor		Komuna	70	53,000.00
12.	Trajtimi i rrugëve fushore		Komuna		38,127.00
13.	Trajtimi i qenve pa pronar		Komuna		9,975.00
14.	Subvencionimi i mbjelljeve vjeshtore me farë gruri		Komuna	941	48,200.00
15.	Darka e Lamës		Komuna		1,000.00
16.	Gjelbërimi i hapësirave publike		Komuna		13,389.00
17.	Gjedhe të racës Hollshtajn	OZHR Mëshqerra	Komuna	35	28,000.00
18.	Ngritja e 15 ha me arra		Komuna	22	9,924.00
Totali					270,270.00

Implementimi i projekteve :

1. Këtë vit e kemi filluar me implementimin e projektit të komisionit Evropian, ku përfituesit kryesor janë të rinjtë në agrobiznes. Projekti u mundëson 100 studentëve apo sapo të diplomuarve të kryejnë praktikë tre mujore me pagesë, do të mbështetën 10 ndërmarrje që zhvillojnë turizmin rural dhe 52 biznese fillestare „ Start up “do të fitojnë grante të vogla në vlerë prej 2.000 deri 4.000 € dhe bizneset ekzistuese nga 5.000 deri 10.000 €. Jemi në proces të implementimit.

2. Në kuadër të mbështetjes së fermave blegtorale, me qëllim të mbarështimit dhe përmirësimit racor, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit të SHMAT „ ARBËRIA “ dhe komunës së Gjilanit nr.1042, të datës 05.11.2018, kjo shkollë ka ofruar në dispozicion pesë krerë gjedhe:

Nr.	Nr. Identifikues	Lloji	Data e lindjes
1.	RKS-11389715	Lopë	11.02.2012
2.	RKS-10789400	Lopë	27.07.2016
3.	RKS-11467888	Viç – mashkull	25.02.2018
4.	RKS-11471725	Viç – mashkull	13.09.2018
5.	RKS-11471681	Viç – mashkull	23.10.2018

Me date: 08.01.2019, kemi publikuar thirrjen për aplikim, ku kemi pranuar 32 aplikacione dhe komisioni ka përzgjedhur 5 fermerët më meritor për kultivim dhe përmirësim racor. Shpërndarja e gjedheve është bërë me 07.02.2019.

3. Nga data 04.02.2019, kemi publikuar ankandin për dhënien e vendgjuetive në menaxhim dhe bashkë me komisionin e ankandeve kemi proceduar të gjitha aktivitetet e kërkuara me ligjin e Gjetisë nr.02/ L-53 dhe Udhëzimit Administrativ nr.06/2009.

Me date: 07.03.2019, komisioni pas leximit të ofertave konstatoi se:

1.Vendgjuetia „ Maja e gjelbër ”oferta ekonomikisht më e favorshme ishte e SHGJ „ PETRITI ”

2.Vendgjuetia „ Karadaku ” oferta ekonomikisht më e favorshme ishte e SHGJ „ AGIM RAMADANI ” . dhe

3.Vendgjuetia „ Zhegoci ” oferta ekonomikisht më e favorshme ishte e SHGJ „UJKU ”.

Pas marrjes së pëlqimit nga MBPZHR, me datën: 03.05.2019 është nënshkruar kontrata 10 vjeçare e dhënies në menaxhim të tri vendgjuetive të përbashkëta.

4. Me datë 05.02.2019 kemi pasur edhe një sesion bashkëpunues me IADK-ën për kultivimin e bimëve mjekësore aromatike, mbajtjen e trajnimeve dhe mbajtjen e praktikës me pagesë të 4

Agronomëve të rinjë për periudhë tre mujore. Nga ky bashkëpunim përpos 4 Agronomëve të sapo diplomuar kanë përfituar edhe 3 fermerë tharëse 100 m², fidane të bimëve aromatike, mekanizim (moto kultivator) dhe sisteme të ujitjes. Nga ky bashkëpunim janë trajnuar dhe certifikuar edhe 30 të rinjë.

5. Subvencionimi i mbjelljeve pranverore, si masë e përhershme është bërë me farë misri. Ky projekt është implementuar me datë: 11.04.2019 dhe kanë përfituar 572 fermerë. Janë shpërndarë 800 thasë farë misri të institutit të Osjekut, në vlerë prej 16.400.00 €.

6. Me datën 20.05.2019, është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit me kompaninë „ Shell Kosova “ për subvencionimin e naftës për fermerë për 5 cent / litër. Gjithashtu, kemi vazhduar kontratën edhe me „ Hib Petrolin “ e cila ka shprehur gatishmërinë për subvencionimin e naftës për fermerë në vlerë prej 6 cent / litër.

7. Nga fillimi i muajit qershor ka nisur aplikimi i fermerëve për skemën e subvencioneve dhe granteve të MBPZHR. Pasi që ky aplikim ka filluar me shumë vonesë, jemi mobilizuar me të gjitha kapacitetet duke punuar edhe pas orarit të punës, si dhe ditëve të shtune dhe kemi arritur t’ju ofrojmë asistencë 1116 fermerëve.

Aplikacionet për subvencione në MBPZHR - 2019			
Nr.	Lloji i kulturës dhe kafshëve	Nr. i aplikuesve	Sipërfaqja në Ha – krerë kafshë
1	Grurë	266	892.54
2	Misër	192	512.36
3	Elb	6	9.71
4	Thekër	4	7.83
5	Tërshërë	12	18.99
6	Pemë	111	279.37
7	Perime	57	143.48
8	Lopë qumështore	247	2777
9	Dele	42	5115
10	Dhi	20	1869
11	Derra	14	97
12	Bletë	123	7146

13	Pula vojse	4	40300
14	Qumësht	22	496500
Gjithsejtë:		1116	

8. Me datë 11.06.2019, në vigjilje të ditës së çlirimit kemi implementuar dy projekte:, Furnizim i bletarëve me shtëpiza tre katëshe të tipit L&R”. Në këtë projekt kemi pranuar 70 aplikacione dhe të gjithë kanë qenë përfitues. Janë shpërndarë 250 shtëpiza tre katëshe dhe vlera e këtij projekti është 8,600.00 €. dhe „ Furnizim i blektorëve me makina mjelëse “. Në këtë projekt kanë përfituar 40 fermerë që kultivojnë mbi pesë krerë lopë qumështore dhe nuk kanë qenë përfitues asnjëherë më parë. Vlera e këtij projekti është 9,985.00 €.

9. Me datë 17.06.2019, është përmbyllur projekti i „ Serrave të zinguar “ me foli dhe montim. Në këtë projekt kemi pasur 90 aplikacione dhe kemi përzgjedhur 20 perimtarët më meritor. Kryesisht janë trajtuar fermerët në zonat e rrafshëta dhe që kanë përvojë të mjaftueshme në kultivim të perimeve. Vlera e këtij projekti është 33,670.00 €.

10. Me vendim të Kryetarit të Komunës z.Lutfi Haziri me nr.të protokollit 02/438 të datës 21.06.2019 formohet komisioni komunal për korrje-shirje në përbërje prej pesë anëtarëve.

Komisioni komunal për korrje-shirje në takimin e mbajtur më 28.06.2019, ku ka përpiluar planin dinamik të aktiviteteve. Me datën 04.07.2019, është mbajtur takimi i komisionit me kombajnerë, ku jemi njoftuar me përgatitjet e kombajnerëve si dhe kemi përcjellë rekomandimet për çmimin e korrjes prej 100 € / ha dhe kushtet e korrjes.

Me datë 12.07.2019, në fshatin Livoq i ulët, hapet zyrtarisht fushata e korrje-shirje, në ngastrën e fermerit Xhelal Elezi me kombajnerin Nuhi Ahmeti.

Që nga kjo ditë komisioni fillon intenzivishtë vizitat në terren dhe monitoron nga afër mbarëvajtjen e korrje-shirjeve në të gjitha fshatrat e komunës së Gjilanit. Gjatë krejt kësaj periudhe komisioni ka marr mostra nga gjithë terreni për të bërë një vlerësim sa më të saktë mbi rendimentin mesatar. Janë marr 111 mostra, prej të cilave 103 mostra te gruri, 6 mostra te elbi dhe 2 mostra te tërshëra.

Rendimenti mesatar për kulturat e grurit, elbit dhe tërshërës:

Kultura e korrur	Sipërfaqja e korrur/ha	Rendimenti mesatarë kg/ha.
Grurë	2100	4118.37
Elb	70	3760.00
Tërshërë	30	2220.00

Për shkak të kushteve klimatike të pa favorshme në vjeshtë dhe vonesës në mbjellje pritet tona ishin për rendimente të ulëta, por falë pranverës shumë të favorshme u arritën rendimente mesatare. Me këtë rendiment sigurohen 8.648 ton grurë dhe plotësohen nevojat bazike për banorët e komunës rreth 48.09 %.

11. Me datë 15.07.2019, SHMAT "ARBËRIA" ka ofruar 5 krerë gjedhe donacion për fermerët e komunës së Gjilanit.

Nr.	Nr. Identifikues	Lloji	Data e lindjes
1.	CZ000262747	Lopë	01.12.2011
2.	ZC000172437	Lopë	08.07.2012
3.	RKS1147/1904	Viç – mashkull	29.12.2018
4.	RKS1147/1903	Viç – mashkull	11.01.2019
5.	RKS	Viç – mashkull	08.03.2019

Kemi publikuar ftesën dhe pas shqyrtimit të aplikacioneve kemi përzgjedhur pesë fermerët më meritor përfitues. Ky projekt është implementuar me datë: 03.09.2019.

12. Me datë 23.09.2019, kemi përmbyllur projektin e „Mekanizmit bujqësor“ ku kanë përfituar 70 fermerë. 20 fermerë kanë përfituar Spërkatëse 440 litërshë, 10 fermerë kanë përfituar Rotofrezë, 10 fermerë kanë përfituar Kosa rotative, 10 fermerë kanë përfituar Piatore me 24 disqe dhe 10 fermerë kanë përfituar Mbjellësve të misrit. Vlera e këtij projekti është 53,000.00 €

13. Me datë 09.07.2019, kemi filluar me punimet në projektin e „Rrugëve fushore“, ku janë përfunduar 1.8 km në rrugën Gumnishtë – Cërrnicë, janë përfunduar 2.0 km në Llashticë, është përfunduar rruga në gjatësi prej 1.1 km në Livoq të ulët janë përfunduar 1.4 km në Malishevë të epërme. Vlera e projektit të realizuar është 38,127.00 €.

14. Nga data 25.09.2019 deri më datën 11.10.2019 janë trajtuar 133 qenë endacak, nga kompania „Fauna group“. Trajtimi i qenve është bërë në harmoni me ligjin dhe në mënyrë profesionale duke i kapur qenët e pa trajtuar rrugëve, transportuar deri te klinika veterinare, duke i identifikuar, regjistruar, kastruar-sterilizuar, vaksinuar, dehelmetizuar si dhe kthimin në vendin e kapjes. Vlera e projektit 9,975.00 €.

15. Me datë 15.10.2019, kemi subvencionuar mbjelljet vjeshtore me farë gruri, ku kanë përfituar 941 fermerë. Kanë përfituar fermerët e vegjël, që nuk i arrijnë kriteret e Ministrisë për skemën e subvencioneve. Janë shpërndarë 140.000 kg farë gruri, prej tyre 80.000 kg varieteti hungareze Tuborzo, dhe 60.000 kg varieteti hungarez Suba. Vlera e këtij projekti 48,200.00 €.

16. Me datë 25.10.2019, në një ceremoni të veçantë të promovimit të produkteve gjilanasë është shtruar sofa e falënderimit, “Darka e Lamës”. Kryetari Haziri në Darkën e Lamës: Bujqit i dhanë dimension zhvillimit ekonomik të Gjilanit.

17. Nga data 21.11.2019, kemi filluar me gjelbërimin e hapësirave publike, ku janë trajtuar hapësirat: Te drejtoria e Bujqësisë, hapësirat përreth ambulantes në Llashticë, hapësirat para shtëpisë së kulturës në Përlepticë, hapësirat në të dy anë e rrugës Gjon Serreçi, hapësirat e parkut të qytetit dhe platoja e kodrës së dëshmorëve. Janë mbjell 600 drunjë dhe vlera e këtij projekti është 13,389.00 €.

18. Me datë 06.12.2019, 35 familje të Gjilanit kanë përfituar nga një krerë lopë qumështore të racës „Hollishtajn-Frizes ”, si pjesë e bashkëpunimit të Komunës dhe organizatës për zhvillim rural „Mëshqerra”.

Kategoria e fermerëve që janë mbështetur kultivojnë nga një deri në katër krerë lopësh, të cilët nuk kanë përfituar nga Ministria e Bujqësisë. Vlera e donacionit është 59.500 €, ndërsa komuna ka participuar me 28.000 €, dhe fermerët kanë participuar me 14.000 €.

19. Me datë 11.12.2019, Komuna e Gjilanit shpërndan 3570 fidane të arrës, varieteti chandler për 22 fermerë. Me këto fidane janë ngritur 15 ha dhe kanë përfituar pemëtarët që kanë poseduar ngastra kompakte nga 0.40 deri 1.0 ha. Vlera e këtij projekti është 9,924.00 €.

Sektori i Pylltarisë

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi ngritur 517 fletëparaqitje prej të cilave 432 për kundërvajtje, 40 penale dhe 55 për transport. Për këtë periudhë kohore kemi pasur 51 raste të konfiskimit të druve në sasi prej 112.66 m³.

Në bazë të planifikimeve vjetore të shfrytëzimit të masës drurore për vitin 2019 nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, janë planifikuar prerja e masës drurore me vëllim prej 1.768 m³ në njësinë menaxhuese në Zhegoc.

Shitje me pakicë të masës drurore kemi pasur në njësinë menaxhuese „ Karadaku “ – zona kadastrale Zhegër, në sasi prej 81 m³ si dhe në njësinë menaxhuese „ Maja e gjelbër “ – zona kadastrale Përlepticë, në sasi prej 235.20 m³.

Gjithashtu, kemi pasur pyllëzim në fshatin Cërrnicë 15 Ha me pishë të zezë dhe hartinë në shumë prej 37500 fidanë. Ndërsa në Llashticë kemi pasur ripyllëzim në sipërfaqe prej 2 Ha.

III. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE, INFRASTRUKTURË DHE BANIM

Bazuar në obligimet e drejtorisë dhe kompetencat e saj, Ligjet e Kosovës, rregulloret dhe udhëzimet e ndryshme administrative si dhe në dispozitat ligjore të aplikueshme të cilat i përkasin fushë veprimtarisë së vet - Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, komform buxhetit të projektuar për vitin 2019 - objektiv të vetin ka pasur arritjen e këtyre objektivave:

- ngritja e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve;
- kompletimi dhe harmonizimin i infrastrukturës ligjore-akteve normative nga fushëveprimi i drejtorisë, me Ligjet dhe Rregulloret në fuqi;
- realizimin e sa më tepër projekteve me interes për qytetarët dhe Komunën në përgjithësi;
- mirëmbajtja e projekteve të realizuara që kanë të bëjnë me shërbimet publike-infrastrukturën;
- identifikimi i problemeve të infrastrukturës në përgjithësi dhe inicimin, ofrimin e zgjidhjeve të mundshme;
- krijimi i një ambienti më të sigurt dhe më të shëndoshë për qytetarët.

Që nga fillimi i këtij viti DSHPIB, e ka angazhuar stafin e saj në realizimin e detyrave me prioritet për qytetarët e komunës tonë, siç është angazhimi në vazhdimin e punëve në:

- **“Mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në qytet dhe fshatrat të komunës sonë”**, projekt i cili është vazhdim i mirëmbajtjes nga viti paraprak, që ka zgjatë deri me 15.03.2019, ashtu siç është paraparë me kontratë. Tani sipas të njëjtës kontratë ka filluar mirëmbajtja dimërore nga data 15.11.2019, për sezonin dimërore 2019/2020.

- Projekt tjetër është **“Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra të komunës”** e që për këtë qëllim janë kontraktuar dy OE, njëra për mirëmbajtje të ndriçimit në qytet e tjetra për fshatra të komunës tonë. Të dy OE, janë në nivel të detyrës dhe shërbimet i kryejnë sipas porosisë që e marrin nga menaxheri i këtyre projekteve.

- **“Shërbimet e varrimit në komunën tonë”**, është projekt tjetër i DSHPIB së, të cilin projekt përmes menaxherit të kësaj kontrate e realizojmë dhe e mbikëqyrim me sukses të plotë duke verifikuar saktë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e obligimeve që ka drejtoria jonë për pagesën e këtyre shërbimeve e cila për vitin 2019, kap shumën prej rreth **160,630.00 euro**

- **“Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve”**, është projekt më të cilin kujdesemi të mirëmbajmë dhe të shenjëzojmë me vija të bardha dhe me shenja të trafikut, rrugë të reja të cilat bëhen në komunën tonë.

Tani para pak ditësh është nënshkruar edhe kontrata me Operator dhe jemi duke punuar në vendosjen e shenjëzimit vertikal, pasi që shenjëzimi horizontal (vijat e bardha) në këtë periudhë nuk mund të kryhet.

- **“Mirëmbajtja verore e rrugëve në qytet dhe fshatra të komunës tonë”**, është një projekt me të cilën drejtoria jonë merret shumë seriozisht për çdo vit dhe këtë vit me fillimin e përmirësimit të kushteve të motit kemi mbushur gropat me shtresa asfalti rreth 13,904.07m²,

Ndërsa shtresa të reja nëpër rrugë ku kanë qenë krejtësisht të degraduara janë rreth 12,121.48m.

Lëndët e ndryshme (sipas protokollit) që kanë arritur në drejtorinë tonë e që kanë të bëjnë me kërkesa të ndryshme dhe aktivitete tjera nga qytetarët për vitin 2019 janë 1272 lëndë, prej të cilave mbi 1091, janë kthyer përgjigje, leje, vendime dhe pëlqimet e duhura, ndërsa 23 janë në procedurë dhe 158, akte janë të dal nga DSHPIB-ja për organet tjera.

Të hyrat vjetore në drejtorinë tonë për vitin 2019 janë rreth: **416,244.68€**.

Buxheti i planifikuar për vitin 2019 ka qenë **3,357.964.10€**, prej tyre janë shpenzuar **3,286.830.38€**.

Drejtoria jonë për periudhën raportuese (viti 2019) ju ka vazhduar lejen mbi 360 taksive që operojnë në Komunën tonë.

Nga stafi i drejtorisë tonë është përgatitur materiali i nevojshëm për shpalljen e ankandit publik për dhënien me qira të banesave, lokaleve të reja si dhe të vend parkingjeve të cilat janë pronë publike. Pas përfundimit të procedurave të ankandit për dhënien me qira të këtyre objekteve dhe parkingjeve, drejtoria jonë do të merret me menaxhimin e këtyre kontratave.

Sa i përket kontratës për “Mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe parqeve”, edhe këtë vit nuk kemi ende një kontratë të rregullt, por shërbehemi me kontratë emergjente me të cilën bëjmë pastrimin e disa rrugëve dhe parqeve të cilat janë të domosdoshme.

Një projekt tjetër me të cilin merret drejtoria jonë është “Bartja e automjeteve me merimangë,” ku gjatë kësaj periudhe raportuese janë tërhequr mbi 813 vetura të parkuara ilegalisht.

Me projektin “Hapja e rrugëve të rendit të tretë, pastrimi i deponive dhe i lumenjve”, me fillimin e pranverës kemi intervenuar në disa lokalitete në shtrimin e rrugëve të rendit të tretë, pastrim të lumenjve dhe të deponive të egra siç është në Karadakë, pastaj në malësinë e Zhegovcit, Pogragjë, Arbëri, pastrimin e lumit në Livoq të Ulët, pastrimin e një pjese të lumit Stanishorka, pastrimin e lumit në Malishevë, pastrimi i lumit në Cërrnicë, pastrimin e përroskës në drejtim të Kufcës së Epërme si dhe shtrirja e gypave të ujërave fekale Livoq-Cërrnicë me gjatësi 800m, pastrim të deponive, mirëmbajtje të deponisë së materialeve inerte e tjera.

Me projektin e “Mirëmbajtjes së projekteve në infrastrukturë projekte të vogla”, kemi intervenuar në shumë pjesë të qytetit dhe të fshatrave sipas kërkesës së banorëve.

Me këtë projekt janë punuar disa segmente të kanalizimit si:

Në rrugët: Hysen Tërpeza, Velekincë, lagja e KFOR-it në Zhegër, lagja e Jasharëve rreth 1300m, lagje afër deponisë rreth 540m-Kanalizim, shkolla fillore “Avdullah Tahiri” në Malishevë 200m, pastaj intervenimi në Velekincën e vjetër ku kemi eliminuar daljen e ujërave të zeza në arat e asaj zone, në lagjen e Zabelit, rrjeti i kanalizimit në fshatin Uglarë në gjatësi prej 200m, kanalizim në lagjen e Shasivarëve në Bresalc, lagjen e Karadakut në Zhegër, në rr. Mulla Idrizi, pastaj në lagjen Dheu i Bardhë,

Ndërsa trotuaret, janë punuar në Velekincë, te Lipovicët dhe rrugën “Bedri Deda, Cërrnicë, pastaj oborri i shkollës në Llashticë, rrugën “Skifter Arifi”, pastaj oborri në Kishën Ortodokse në Shillovë, etj.

Sa i përket infrastrukturës rrugore për periudhën që po raportojmë do të përmendim projektet që janë kryer dhe ato të cilat kanë filluar të punohen deri më sot:

Rrugët lidhëse me rrugën e Prishtinës;

- Rrugët në lagjen “Femi Agani”;
- Rrugët në lagjen e dytë “Pajazit Ahmeti”;
- Ndërtimi i disa rrugëve në Llashticë dhe Velekincë;
- Ndërtimi i rrugës “M.Idrizi” që lidhet me rrugën e Malishevës ;
- Ndërtimi i rrugëve në lagjen e “Arbërisë;”
- Ndërtimi i rrugëve lidhëse me rrugën “Hysen Tërpeza;”
- Ndërtimi i rrugës në fshatin Zhegër (kah tregu);
- Ndërtimi i rrugës Livoq i Ulët – Cërrnicë;
- Ndërtimi i rrugës kryesore nga rruga e Ferizajt deri në qendër të Cërrnicës;
- Ndërtimi i rrugës së Perlepnics;
- Ndërtimi i platosë së sheshit mbi Mirushë - Jugu;
- Ndërtimi i rrugës te Kombinati i duhanit;

- Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në lagjen “Dheu i Bardhë (në proces).
- Ndërtimi i urave në malësinë e Karadakut(në proces);
- Instalimi i ujësjellësit në lagjen Porodin,
- Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe asfaltimi i rrugëve në lagjen Porodin (në proces);
- Mbulimi i lumit Mirusha “Jugu”;
- Zgjerimi i rrugës nga ”DRINI Market” deri te bunari i Përlepticës (në proces).

Ndërsa projektet që janë kontraktuar dhe kanë filluar punimet janë:

- Ndërtimi i rrugëve në Livoq të Epërm dhe në lagjen e Jabuqve;
- Ndërtimi i rrugëve në Livoq të Ulët;
- Ndërtimi i rrugëve në Malishevë të Epërme;
- Ndërtimi i rrugëve në Përlepticë deri te Penda;
- Vazhdon zgjerimi i rrugës kryesore në drejtim të rrugës së Ferizajt,.
- Trotuaret në lagjen Dardania;
- Ndërtimi i rrugës Zabel-Uglar;
- Rruga Dobërzan -Stublinë, Dobërzan - Pogragjë;
- Kanalizimi në lagjen 28 Nëntori;
- Dhe projekti më madhore për këtë vit është rregullimi i pllatosë së lumit Mirusha-Veri, në gjatësi deri në 1183m nga rr. “Rexhep Dajkovci” deri në lagjen Dardania, konkretisht deri te butiku ”Menakon”, vlera e të cilit arrin afër 1 milion euro. Do të bëhet një shesh-shëtitore shumë e bukur dhe shumë funksionale.

Gjithashtu janë kontraktuar edhe rrugët :“Enver Miftari”, Rruga e Kumanovës, Ura në fshatin Dobërzan, rruga “7 Shtatori”, rruga “Skifter Arifi”.

IV. DREJTORIA PËR ARSIM

Drejtorja e Arsimit gjatë periudhës një vjeçare ka arritur me sukses t’i realizojë të gjitha përgjegjësitë dhe kompetencat e planifikuara, sipas planit të punës si dhe angazhime të shtuara në përmbushjen e kërkesave dhe obligimeve të paparashikuara.

Aktivitetet e planifikuara në Sektorin e Arsimit :

Në sektorin e arsimit aktivitetet e planifikuara kanë derivuar nga politikat zhvillimore, strategjike të arsimit në Komunën e Gjilanit si dhe Plani i Punës së DKA për vitin shkollor 2018/19

Objektivat zhvillimore strategjike të planifikuara në sektorin e arsimit janë: Menaxhimi efikas i arsimit; Krijimi i mekanizmave për ngritjen e cilësisë në arsim; Zbatimi i suksesshëm i kurrikulës së re ; Krijimi i kushteve për mësim cilësor; Zhvillimi i arsimit profesional për t’iu përshtatur tregut të punës; dhe Zbatimi i reformave për një sistem shkollor bashkëkohor.

Bazuar në shtatë objektivat janë planifikuar edhe aktivitetet si në vijim:

1. Mbikëqyrja e vazhdueshme e Institucioneve edukative arsimore, nga zyrtarët e niveleve të arsimit para universitar
2. Funksionimi dhe fuqizimi i këshillave drejtuese të shkollave,

3. Fuqizimi i aktiveve profesionale si dhe mbikëqyrja dhe mentorimi i aktiveve profesionale
4. Përzgjedhja e personelit në kuadër të Institucioneve Arsimore Para universitare
5. Rritja e numrit të fëmijëve në edukimin parashkollor,
6. Analiza e gjendjes dhe nevojave në arsimin parauniversitar
7. Hartimi i planit për zhvillimin profesional të mësimeve në arsimin parauniversitar
8. Zhvillimi profesional dhe trajnimet e mësimeve
9. Rishikimi i planeve zhvillimore të shkollave
10. Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta, në Institucionet e arsimit parauniversitar
11. Trajnimet e personelit profesional parauniversitar për zbatimin e Kurrikulës Kombëtare,
12. Nënshkrimi i marrëveshjeve për punë praktike
13. Planifikimi dhe shpallja e konkursit për pranimin e fëmijëve në Institucionet Parashkollore me qëndrim ditor, fëmijëve në klasat përgatitore, nxënës në klasa të para dhe klasa të dhjeta.
14. Identifikimi i nevojave të shkollave për punëtorë, kabinete, laboratorë dhe material shpenzues
15. Përgatitja e raportit për Garat e Diturisë të organizuar nga koordinatori Nacional, Rini dhe Sport.
16. Hartimi i planit dinamik për vlerësimin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta.
17. Përkrahja e nxënësve me nevoja të veçanta përmes mekanizmave mbështetës
18. Furnizimi me shujta ditore për nxënës të tri SHFMU nga zonat e thella rurale.
19. Organizimi dhe realizimi i garave të diturisë
20. Analizat e gjendjes dhe nevojave në arsimin parauniversitar
21. Mbështetje në krijimin e ambienteve afirmative për të nxënësit efektiv
22. Koordinimi i planit të veprimit me Organizatën Qeveritare Turke “TIKA” për fillimin e punimeve në hapësirat e SHFMU “Musa Zajmi” për tri klasë përgatitore me hapësirat përcjellëse.
23. Bashkërendimi i aktiviteteve me udhëheqësin e SHFMU “Musa Zajmi” për hapjen e klasës parapërgatitore me mësim në gjuhën turke dhe regjistrimin e fëmijëve
24. Monitorimi i zbatimit të kurrikulës.
25. Nevoja për rishikimin e menyve ekzistuese, në pesë Institucione Parashkollore, hartimi i një menyje të bazuar shkencërisht mbi nevojat e vlerave standarde ushqyese, për të gjithë fëmijët e përfshirë në institucione parashkollore.
26. Takime me të gjithë Koordinatorët e Cilësisë në shkolla.
27. Organizimi i takimeve me organet e sigurisë
28. Furnizimi i institucioneve me: inventar, rekuizita sportive, printerë, fotokopje – makinë, laptopë, tabela të mençura etj.
29. Furnizimi i institucioneve me lëndë djegëse (dru, pelet dhe naftë)
30. Zbatimi i planit dinamik për përmirësimin e infrastrukturës në institucionet e arsimit parauniversitar
31. Evidentimi i të hyrave vetanake
32. Pranimi i lëndëve për aprovim
33. Shpenzimet komunale për institucionet

Aktivitetet e implementuara:

Mbikëqyrja e vazhdueshme e Institucioneve edukative arsimore – është realizuar dhe në vazhdimësi bëhet mbikëqyrja dhe monitorimi sipas planit dinamik të Drejtorisë Komunale të Arsimit. Zyrtarët e niveleve të arsimit parauniversitar kanë operuar duke e përcjellë nga afër

ecurinë e zhvillimeve në sistemin arsimor dhe njëkohësisht kanë realizuar mentorim dhe mbështetje për: udhëheqësin, personelin, KDSH, aktivet profesionale dhe gjithë komunitetin e shkollave. Sipas dinamikës së planifikuar zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues si: vizita informuese, mentoruese, të veçanta dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit parauniversitar. Në kuadër të vizitave në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar në Komunën e Gjilanit, zyrtarët e niveleve të arsimit për periudhën kohore janar – nëntor 2019 janë realizuar gjithsej: 93 vizita sipas planit dinamik të planifikuar dhe të pa parashikuar; Gjatë vizitave me qëllim kontrollues nga ana e zyrtarëve në Institucionet e Arsimit, autoriteteve dhe edukatoreve të shkollës ju janë ofruar rekomandime dhe mbështetje mentoruese profesionale për (plotësimin e drejtë të ditarëve për klasat përgatitore, instrumenteve për vlerësimin e fëmijëve, planifikimin sipas kurrikulës bërthamë, përdorimin e teksteve të reja (pakot didaktike). Me autoritetet e shkollës janë diskutuar dhe evidentuar edhe masat e duhura për adresimin e nevojave dhe sfidave për klasë përgatitore në kuadër të shkollave; gjithashtu zyrtarët kanë realizuar monitorim dhe mentorim për vlerësimin e nxënësve sipas UA 08/2016 për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës. DA në funksion të zhvillimeve dhe përmirësimit të cilësisë dhe avancimeve në arsim, në kuadër të saj ka zgjedhur koordinatorin e cilësisë si dhe 27 koordinatorë të cilësisë në kuadër të shkollave. Në ambientet e DA, janë realizuar takime të përbashkëta me të gjithë Koordinatorët e Cilësisë në kuadër të shkollave. Përveç njoftimit të drejtorit me KC qëllimi i këtij takimi ishte të njoftohemi për detyrat dhe aktivitetet që janë duke i kryer KC. Për vlerësimin e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta, ekipi vlerësues ka realizuar vlerësimin sipas planifikimeve të parapara dhe nevojave për vlerësim për tri nivelet e arsimit. Janë realizuar takime me palë të interesit dhe zyrtarë nga drejtoritë e ndryshme në nivel të komunës. Shqyrtimi dhe kthimi pas përgjigjeve të të gjitha llojeve të shkresave zyrtare nga Institucionet e arsimit parauniversitar MASHT, dikasterët e ndryshëm të R. Së Kosovës dhe palëve të ndryshme të interesit. Përgatitja e vendimeve për transferimin e nxënësve në Komunitet tjera (vendimet për shqiptimin e masave disiplinore për nxënësit e SHML); Monitorimi i punimeve në renovimin e SHFMU “Vehbi Ibrahim” në fshatin Ugarë, financuar nga donatori z. Mark Brum; Monitorimi i fillimit të punimeve në projektin e ndërtimit të palestrës së jashtme sportive në SHFMU “Ibrahim Uruqi”- fshatin Bresalc.

Pajisja e shkollave me mekanizëm digjital - Këtë vit shkollor për herë të parë, në 35 Institucionet e arsimit parauniversitar janë vendosur mekanizmat digjitalë me të cilat përmes programit softwerik do të monitorohet dhe evidentohet vijueshmëria e mësimdhënësve sipas orarit mësimor në baza ditore, përmes kartelave individuale, furnizimi i dhjetë shkollave me dhjetë tabela të mençura

Furnizimi i shkollave me kamera të sigurisë dhe donacione të ndryshme -Pajisja me kamerat e sigurisë në dy SHFMU “Ibrahim Uruqi”- Bresalc dhe Ramiz Cërnica”- Cërnica, donacion nga organizata-OSBE. Donacion nga z. Liridon Byqmeti, 50 kompjuterë-laptopë për Institucionet arsimore. Furnizimi në SHFMU Agim Ramadani – Zhegër me 15 kompjuterë nga KFOR-i Italian. Furnizimi i shkollës fillore “Vuk Karaxhiq” në Shillovë me banka dhe karrika nga KFOR-Amerikan. Mbështetje me material didaktik në vlerë financiare prej 8000 € për dy IP: Ardhmëria 1 dhe IP Integj, nga organizata Save the Children në kuadër të projektit “Zhvillimi i Fëmijërisë së

Hershme”. Pajisja me mjete të konkretizimit për hapjen e qendrave mediatike për SHFMU “Thimi Mitko” dhe “Zija Shemsiu”, nga GIZ – Gjerman - projekti “Zhvillimi i kapaciteteve në arsim”. Projektet dhe bashkëpunimi me Qeverinë e Luksemburgut: Projekti mbështetja e performancës së arsimit dhe aftësisë profesionale, i mbështetur nga Qeveria e Luksemburgut, për SHMLT “Mehmet Isai”, ku përfshihen investime në kurrikulë, kornizë ligjore, sistem të informacionit dhe zhvillim i kualifikimeve të reja, implementimi i projektit “Orientimi në karrierë” për 33 shkolla nga Basic Check AG me seli në Basel e financuar nga qeveria e Luksemburgut. Projekti “Shkollat e shekullit 21” me Qeverinë e Luksemburgut. Grupi i Rotarian Klub- Gjilan, ka shpërndarë lodra të buta në klasë përgatitore në kuadër të shkollave dhe në dy Institucione Parashkollore.

Inovacionet dhe pilot projektet si nxitës dhe mbështetës të progresit në ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar. - Duke marrë parasysh nevojat globale të kohës, për ndryshime në qasjen ndaj të nxënësve dhe mësimdhënies, dhe sipas planit të veprimit të DKA-së në SHFMU “Selami Hallaqi” ka filluar realizimi i projektit, “ME MË SHUMË MËSIMDHËNËS PËR KLASAT E (3, 4 DHE 5) Në bazë të rezultateve të nxjerra nga hulumtimet e bëra për pilot projektin e lartcekur nga GIZ – gjerman, Universiteti Kadri Zeka dhe SHFMU “Selami Hallaqi” rezultoi si projekt i suksesshëm si në ngritjen e rezultateve të suksesit, nivelit të kënaqësisë së nxënësve dhe lehtësisë të punës së mësimdhënësve. Si i tillë, ky model nga muaji shtator është duke u pilotuar edhe në SHFMU “Abaz Ajeti” , SHFMU ”Musa Zajmi”. SHFMU ”Rexhep Elmazi”. Ligji për Edukimin Parashkollor, nuk përcakton përgjegjësitë për krijimin e menysë dhe ofrimin e ushqimit të shëndetshëm për moshat e fëmijëve, i cili na siguron një mirë rritje dhe zhvillim të fëmijëve, prandaj pas konsultimeve dhe përpjekjeve të shumta që kjo fushë të rregullohet në përputhje të plotë me standardet e zhvillimit të fëmijëve dhe me standardet ndërkombëtare të zhvillimit të fëmijëve në moshën e hershme. Drejtoria e Arsimit ka arritur të gjejë mirëkuptim me Universitetin i Prishtinës " Hasan Prishtina, gjegjësisht Departamentin e Teknologjisë Ushqimore me Bioteknologji, për ta zbatuar Projektin Hulamtues pa implikime financiare i cili ka konsistuar në studimin e të ushqyerit të fëmijëve të përfshirë në Institucionet Parashkollore, Projekti hulamtues ka përfshirë tri faza: 1. studimi antropometrik 2. analiza e menysë aktuale dhe 3. dalje me rekomandime e një menyje të standardizuar, e cila është realizuar nga studentët e departamentit nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e Prof.Ass.Dr.Arbenita Hasani Rexhepi, hulumtimi ka përfunduar dhe rekomandimet për menynë standarde Drejtoria e Arsimit e disponon si të gatshme .

Riorganizimi dhe realizimi i kthimit të procesit mësimor nga tre në dy ndërrime në SHFMU”ThimiMitko”; Realizimi i panairit të studimeve me Universitetet publike dhe Kolegjet private për nxënës të maturant, ku morën pjesë mbi 12 Kolegje Private dhe një Universitet “K.Zeka “ Gjilan nga të cilët prezantuan produktet e tyre si një mundësi e jashtëzakonshme për maturantët e Gjilanit në orientimin e tyre në karrierë; Hapja e Zyrës së Këshillit të nxënësve në hapësirat e DA; Zbatimi i projektit “Orientimi në Karrierë” Busolla.com për trajnimin e mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave të mesme të larta profesionale nga fusha e TIK dhe jeta dhe puna.

Projekte të realizuara me mbështetjen e Komunës dhe MASHT - sigurimi i shujtave ditore për nxënës në shkollat “Afërdita” – Kishnapolë, “Fetah Qerimi” – Vërbicë e Zhegocit dhe “Bajram Curri” – Shurdhan; Furnizimi i dymbëdhjetë shkollave fillore dhe një shkolle të mesme të lartë me inventar, karrige e banka; Ndarja e Bursave të rregullta për studentë, miratuar në Kuvendin Komunal; Furnizimi me fotokopje dhe printerë i të gjitha Institucioneve të arsimit parauniversitar. Realizimi i 100 bursave nga Ar- Katana, për studentet e komunës sonë në vlerë prej - 13800 €; Furnizimi me kamera të sigurisë në shkollat të cilat nuk kanë qenë të pajisura me kamera të sigurisë; Ndërtimi dhe furnizimi me rekuizita sportive i palestrës sportive në SHFMU “Rexhep Elmazi”; Zgjerimi i hapësirave shkollore; Ndërtimi i aneksit me katër klasë dhe lokalet përcjellëse për fëmijët parashkollorë në SHFMU “Rexhep Elmazi”; Furnizimi i shtatë palestrave sportive në SHFMU dhe SHML me rekuizitat e nevojshme sportive; Realizimi i programit dy javorë i shkëmbimit të nxënësve, me projektin e titulluar ‘Si në shtëpinë tënde’, e realizuar në bashkëpunim me MASHT me qëllim të integritit të nxënësve të Republikës së Kosovës dhe atyre të Republikës së Shqipërisë në sistemin arsimor, atij të qytetarisë dhe forcimit të bashkëpunimit mes dy vendeve. Në këtë projekt janë përfshirë pesë nxënës të gjimnazit natyror “Xhavit Ahmeti”. Në Kuadër të projektit “Përmirësimi i qasjes dhe cilësisë në kujdesin dhe zhvillimin gjatë FH Save the Children ka pasur tirazh të mjaftueshëm të dokumenteve për vlerësimin e fëmijëve, gjegjësisht protokollin e vëzhgimit për dy Institucione Parashkollore.

Drejtoria e Arsimit në koordinim me drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar - ka arritur t’i furnizojë dhe vendos në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar kutitë e ankesave dhe lëvdatave të cilat do t’ju mundësojnë prindërve dhe nxënësve që ta adresojnë çdo shqetësim apo lëvdatë të tyre përmes ankesës anonime e cila ju paraqitet gjatë periudhës shkollore. Drejtoria e Arsimit, po ashtu ka inkurajuar nxënësit dhe gjithë komunitetin e shkollave që t’i adresojnë ankesat dhe lëvdatat në kuti; Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me drejtuesit e Institucioneve Parashkollore me qëndrim ditor ka realizuar rishikimin e pastaj edhe modifikimin e kontratës ekzistuese në mes Institucionit Parashkollor dhe prindërve të fëmijëve të përfshirë në Institucione Parashkollore. Kontrata e rishikuar “Për të Drejtat dhe Obligimet e Qëndrimit të Fëmijës në Institucion Parashkollor “ka hyrë në fuqi në muajin shtator 2019; Drejtoria e Arsimit në koordinim me drejtuesit e shkollave dhe MASHT, ka realizuar planifikimin e nevojave për tekstet shkollore dhe shpërndarjen e tyre për nxënësit e niveleve të arsimit 0,1,2; Drejtoria e Arsimit ka formuar Komisionin për reformat e arsimit parauniversitar në nivelin lokal për vitin 2020-2021; Rizgjedhja e Këshillit të nxënësve të SHML; Planifikimi për shpalljen e tenderit të uniformave të nxënësve; Planifikimi për pajisjen e nxënësve të klasës së X-të, me kartela identifikuese; Sistemimi i nxënësve nga Republika e Shqipërisë në Institucionet e Arsimit parauniversitar të Komunës së Gjilanit.

Planifikimi dhe plotësimi i normave mësimore - zyrtarët e arsimit kanë analizuar normat e mësimdhënësve të cilët nuk e kanë fondin e plotë të orëve duke i plotësuar ato sipas kualifikimit dhe kontratës së punës. Gjatë periudhës nëntë mujore, janar – shtator, 2019 janë proceduar gjithsej katër konkurse për mësimdhënësit e arsimit parauniversitar, një konkurs për drejtor dhe tre për punëtorë teknikë; Drejtoria e Arsimit pas përfundimit të vitit shkolror 2018-19 bazuar në kërkesat e drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore për vendet e lira të punës dhe pas analizës së

gjendjes së normave të mësimdhënësve me kontratë të rregullt me datë 26.07.2019, ka shpallur konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës

Testi i Arritshmërisë dhe Testi i Maturës Shtetërore - Testi i arritshmërisë u realizua në nivel vendi me datë 31 maj 2019, në autoritetin e MASHT dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit në Komunën e Gjilanit për nxënësit e klasave të nënta (IX) këtij testi ju nënshtruan gjithsej 1333 nxënës, prej tyre 74% të nxënësve kanë kaluar testin. Për një proces të dinjitetshëm dhe të standardizuar Drejtoria e Arsimit ka ndërmarr të gjitha masat e domosdoshme për mbarëvajtjen e testit duke krijuar kushte të mira për zbatueshmërinë e testit më 13.06.2019, u realizua testi i maturës shtetërore pjesa e parë e më datë 20.06.2019, pjesa e dytë. Testin e kaluan 1336 apo 78.96%, nxënës, ndërsa 356 apo 21.04 %, nxënës nuk e kaluan testin. Në afatin e gushtit, numri i nxënësve që i'u janë nënshtruar testit ka qenë gjithsej: 416 nxënës. Pjesa e parë u mbajt më datë 30.08.2019, dhe pjesa e dytë më datë 07.09.2019. Në afatin e gushtit, testin e kaluan gjithsej 205 ose 59.08%, nxënës, ndërsa gjithsej 142 ose 40.92% nxënës nuk e kaluan testin.

Konkurset për regjistrimin e fëmijëve parashkollorë, nxënësve në klasat e para dhe në klasat e dhjeta i cili është realizuar në dy afate: në muajin qershor dhe muajin gusht për vitin shkollor 2019/2020 - konkurset janë shpallur sipas Udhëzimeve Administrative në fuqi, regjistrimi ka vazhduar deri në fillim të muajit shtator, për klasat përgatitore të moshës (5-6) vjeç ku janë regjistruar gjithsej: 1120 fëmijë dhe për klasat e para në afatin e shtatorit janë regjistruar gjithsej: 1119 për regjistrimin e klasave të dhjeta konkursi është shpallur në dy afate: ai i qershorit dhe afati i gushtit i cili ka rezultuar me regjistrimin e gjithsej: 1532 nxënës. Në Institucionet Parashkollore me qëndrim ditor në afatin e qershorit janë regjistruar gjithsej: 502 fëmijë të moshës (9 muaj – 5 vjeç) vendet e lira janë plotësuar në afatin e parë.

Hapja e dy paraleleve shtesë për vitin shkollor 2019-2020, në Shkollën e Mesme të Lartë të Mjekësisë “Dr. Asllan Elezi” , për shkak të numrit të madh të nxënësve konkurrues me sukses të shkëlqyeshëm, veçanërisht në profilin-infermier i përgjithshëm, pas një presioni të vazhdueshëm nga ana e prindërve dhe nxënësve si dhe analizës së raportit mbi numrin e nxënësve të peregjistruar i cili arrinte shifrën prej gjithsej 177-252 nxënës, dhe me qëllim të normalizimit të procesit mësimor si dhe interesimit të nxënësve me sukses të shkëlqyeshëm, DKA ka shqyrtuar kërkesën e Shkollës së Mesme të Lartë të Mjekësisë “Dr.Asllan Elezi” për hapjen e dy paraleleve shtesë të profilit-Infermier i përgjithshëm dhe ka adresuar kërkesën në MASHT. Pas aprovimit të kërkesës nga MASHT për hapjen e dy paraleleve, komisioni i shkollës ka vazhduar regjistrimin e nxënësve kandidatë sipas listës së ranguar duke vazhduar me përfshirjen edhe të 70 nxënësve nga 35 nxënës në 2 paralelet e lartcekura në profilin përkatës.

Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat qeveritare/joqeveritare – memorandumet e mirëkuptimit – nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të DA dhe Organizatës QSHHZH (Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim) me të cilën palët janë pajtuar të bashkëpunojnë, për të përmirësuar më tutje jetën e fëmijëve dhe të familjeve të tyre, përmes implementimit të programit për ZHFH (Zhvillimin në Fëmijëri të Hershme) arsim gjithëpërfshirës dhe mbrojtje të fëmijëve, shëndetin e ushqyerjen, fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të: prindërve, edukatorëve, mësimdhënësve, zyrtarëve dhe akterëve të tjerë në fushën e kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme për hapjen dhe funksionalizimin e QBK (Qendrës me Bazë në Komunitet) në hapësirat fizike të klasave përgatitore në kuadër të shkollës “ Abaz Ajeti”; Me organizatën Save the Children, është bërë nënshkrimi i raporteve finale rreth ecurisë së implementimit të projekteve mbështetëse për dy Institucione Parashkollore; Marrëveshje Bashkëpunimit me “Play2EDUCATE Programi” – Gjilan 2019 është organizatë që kultivon

zhvillimin e relacioneve pozitive mes të rinjve për të promovuar tolerancë dhe për të nxitur qëndrueshmëri të fokusuar në parandalimin e ekstremizmit fetar, politik, etnik, konfliktet dhe dhunën; Marrëveshje Bashkëpunimi me organizatën ALLED 2-Projekti “Harmonizimi i Arsimit dhe Aftësimit me Nevojat e Tregut të Punës” i financuar nga BE me bashkëfinancim dhe realizim nga ADD (Bashkëpunim Austriak për Zhvillim) për SHMLAT “Arbëria” dhe SHMLT “Mehmet Isai”; Implementimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me American Advising Center (AAC)- është implementuar Program Trajnimi për mësimdhënësit e SHML: "Këshillim për Studime në SHBA dhe mundësisë së përfitimit të bursave"; Memorandumi i bashkëpunimit me Komunën e Bursës të Turqisë për binjakëzimin e 3 SHML të Gjilanit me 3 shkollat e Komunës së Bursës; Bashkëpunimi me Institutin e Shëndetit Publik (analiza me rezultatet e raporteve higjienike – sanitare nga ambientet e Institucioneve Parashkolllore); Bashkëpunimi me Institutin Pedagogjik (Planifikimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve të ndërsjella për realizimin e trajnimeve për personelin profesional si dhe zbatimin e hulumtimeve; Bashkëpunimi permanent me Policinë e Kosovës – (Njësi për Komunitet) – lidhur me sigurinë e nxënësve në të gjithat Institucionet e arsimit parauniversitar; Bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit dhe Drejtorinë për Kadastër (Kompletimi i dosjeve për hapësira publike të destinuara për Institucione Parashkolllore dhe shkolla); Bashkërendimi dhe zbatimi i aktiviteteve në bashkëpunim me Drejtorinë për Urbanizëm dhe MASHT në kompletimin e dosjeve për ndërtimin e Objektivit të ri të çerdhes në lagjen Zabeli i Sahit Agës në parcelën me nr: 01494-2 zonë Katastrale si donatorë potencialë, EU (Unioni Evropian) Bashkëpunimi me QMF (ekzaminimet mjekësore si kriter gjatë aplikimit të fëmijëve në nivelin e arsimit para fillor); Bashkëpunimi me Caritas Kosova; Bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Bujqësisë (hulumtimi i menyve/shujtave të fëmijëve); Implementimi i Memorandumit të bashkëpunimit me Komunën e Bursës për binjakëzimin e shtatë shkollave të Gjilanit me shtatë shkollat e Komunës së Bursës; Realizimi i aktiviteteve javor me nxënësit e Gjimnazit Natyror “Xhavit Ahmeti”- Java e Psikologjisë - përfshirë organizimin e aktiviteteve të ndryshme me karakter humanitare; Bashkëpunimi me FSK për pjesëmarrjen e gjashtë nxënësve të klasave (XI dhe XII) në kampin veror 2019 “Adem Jashari” në Ferizaj; Bashkërendimi i aktiviteteve me Organizatën QSHHZH (Qendra Humane për Zhvillimin); Bashkërendimi i aktiviteteve me organizatën RTM dhe Aleanca për Zhvillimin e Edukimit Parashkollor në Kosovë; Takim pune me z.Tony Janky dhe z. Matt Duncan për koordinimin në zbatimin projekteve që kanë të bëjnë me parandalimin dhe eliminimin e dukurive negative në shkolla; Takim pune me zv. drejtorin për marrëdhënie me jashtë pranë Ambasadës së SHBA në Kosove z.Ray Nayler.

Organizimi dhe realizimi i eventeve për nderë të shënimit të datave të rëndësishme- Organizimi, monitorimi dhe realizimi i aksionit ”Ta pastrojmë Gjilanin” në të cilin morën pjesë: fëmijët, nxënësit dhe personeli i institucioneve arsimore parauniversitare; Organizimi, menaxhimi, monitorimi dhe shënimi i ditës së Mësuesit 7 Marsi”; Organizimi, menaxhimi, monitorimi dhe shënimi i ditës së fëmijëve ”1 Qershori” me fëmijët e moshës (5-6) vjeç; Organizimi, menaxhimi, monitorimi dhe shënimi i Ditës së çlirimit të Gjilanit.

Drejtoria e Arsimit në Bashkëpunim me partnerët e saj ka realizuar trajnime të ndryshme për personelin profesional në shkolla dhe personelin në DA: MASHT, - Trajnime Kurikula e Re, për mësimdhënës; Instituti Pedagogjik, trajnime me temën (Bashkëpunimi efektiv edukator-

prind) në institucione parashkollore); Save the Children, - me temën Indeksi për gjithë përfshirjen; SBASHK, Edukimi Medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik; Organizimi dhe trajnimi për udhëheqje dhe menaxhim për arsim; Pjesëmarrje në punëtorinë 2 ditore mbi “Integrimin e Perspektivës Gjimore në Shërbime Sociale”, që organizohet nga Projekti i GIZ-it; Trajnim Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve në Arsimin Gjithëpërfshirës, kemi filluar me modulën e dytë të trajnimit në shkollën “Agim Ramadani” në Gjilan; Takim me Save the Children organizon punëtori për Arsimin gjithëpërfshirës; Trajnimi – lidhur me procedurat dhe standardet e operimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe mekanizmat kundër dhunës në familje të Regjionit të Gjilanit. Drejtorja e Arsimit, ka iniciuar nevojat për trajnime në përputhshmëri me reformat në arsim për edukatorët e pesë institucioneve parashkollore me qëndrim tërë ditor. Me këtë rast organizata ndërkombëtare Save the Children ka reflektuar, në kuadër të projektit “Përmirësimi i Qasjes dhe Cilësisë në Kujdesin dhe Zhvillimin gjatë Fëmijërisë së Hershme në Kosovë” me pakon e trajnimeve dy ditore me temat: aktivitetet stimuluese për fëmijët e moshës 0-3 vjeç dhe Të ushqyerit e fëmijëve të moshës 0-3 vjeç, me përmbajtje për ndikimin e të ushqyerit në shëndet, sigurinë dhe ruajtjen e ushqimit, higjienën e ushqimit dhe parandalimin dhe menaxhimin e diarresë/etheve. Pjesëmarrës/e kanë qenë të gjitha edukatorët e katër Institucioneve parashkollore me qëndrim tërë ditor; Përmes aplikimit në projekte të ndryshme për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme si DA kemi marrë dritën e gjelbër si përfitues të projektit nga organizata RTM – Italiane me projektin “Reggio Emilia Approach në kuadër të projektit PEDAKOS - Aleanca për Zhvillimin e Edukimit Parashkollor në Kosovë për dy Institucionet Parashkollore me qëndrim ditor. Ky projekt konsiderohet i një rëndësie të veçantë meqë për herë të parë në Kosovë i nivelit të arsimit parashkollor do t’u ofrohet një qasje/metodologji e re e quajtur - Rexhio Milia nga Loris Malaguzzi; Si rezultat i përpjekjeve dhe angazhimeve për ngritjen e cilësisë në arsim, në nivelin e arsimit parashkollor, DKA ka arritur të jetë përfituese edhe e projektit “Qendrat komunitare me bazë në komunitet për moshën 0-5 vjeç” në klasat përgatitore nga OJQ “Qendra për Shërbime Humane dhe Zhvillim “në këtë projekt të targetuar janë fëmijët nga mosha (0-6) vjeç të cilët do të përfitojnë nga shërbimet e zhvillimit të fëmijërisë së hershme, ndërsa edukatorët do të mbështeten në ndërtimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve.

Drejtorja e Arsimit në bashkëpunim me akterët e fushës së cilësisë – ka bërë Identifikimin dhe klasifikimin e dokumentacionit të emërimeve të koordinatorëve të cilësisë në shkolla: Përcaktimi i orëve të KC (Koordinatorët e Cilësisë) nëpër shkolla, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi; Takim njoftues me Koordinatorin e Cilësisë në nivel të MASHT; Kompletimi i emërimit të KC në të gjitha shkollat e komunës nga ana e drejtorëve të shkollave; Organizimi i një takimi me të gjithë koordinatorët e cilësisë në shkolla; Kompletimi i të gjitha dosjeve të KC; Takim pune me shkollat pilot dhe zyrtaret e MASHT-it, reflektim vlerësues për përmbajtjen e teksteve të reja shkollore në arsimin para universitar; Pjesëmarrje në Konferencën Ndërkombëtare për ZHFH (Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme) organizuar nga Save the Children; Pjesëmarrje në punëtorinë dy ditore për hartimin e rregullores “Draft Rregulloret Komunale për kutinë e ankesave në institucionet e arsimit para-universitar në Komunën e Gjilanit; Pjesëmarrje në takimin informues një ditor në projektin “Qasja e re Reggio Millio” me organizatën RTM – Italiane. DA merr pjesë në cilësinë e prezantuesit si model suksesi me Ekipin vlerësues Pedagogjik, me mbështetje të Bashkëpunimit Gjerman për Zhvillim me temën “Menaxhimi i Arsimit në Nivel Komunal; Pjesëmarrëse në punëtorinë- “Fuqizimi i Kujdesit, Zhvillimit dhe Edukimit në Fëmijërinë e Hershme në Kosovë”; Ligjërata në dy SHML” Arbëria” dhe “Mehmet Isai” mbi Syndrome Down; Takimi me forumin

për Aftësi të kufizuar mbi përdorimin e manualit “Të mbështesim Arsimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara në Kosovë”; Pjesëmarrëse në Lansimin e Instrumenteve për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve në Kosovë; Takime me Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuara.

Drejtoria e Arsimit ka themeluar Komisionin për Grumbullimin e të dhënave për shtëpitë shkollë janë mbajtur disa takime dhe janë ftuar personalitete relevante të cilët kanë ofruar dokumente dhe materiale faktike për familjet kontribut-dhënëse.

Drejtoria e Arsimit ka organizuar aksionin për grumbullimin e mjeteve për vendet e prekura nga tërmeti në Shqipëri dhe familjen Abazi nga Livoqi i Epërm. Mjetet e grumbulluara në vlerë **15.691,95** do të dorëzohen nga ana e Komisionit më **21.12.2019** në fondin e dedikuar nga ana e Komunës për familjen Abazi si dhe të prekurit nga tërmeti në Shqipëri. Në të njëjtën datë është planifikuar edhe Gala mbrëmja për grumbullimin e mjeteve për të prekurit nga tërmeti.

Zyra e personelit

Përgatitja e kontratave të punëtorëve të rinj; Përgatitja e ndryshimeve në listat e pagave në baza mujore; Përgjigje në ankesat; Përgatitja e lëndëve për gjykatë; Përgatitja e kontratave të mësimdhënësve dhe punëtorëve teknikë të cilëve i'u ka skaduar kontrata e punës; Përpilimi i vendimeve, aktvendimeve, vërtetimeve të ndryshme; Përgatitja e dëshmimeve për auditorin gjeneral; Regjistrimi i lëndëve në sistemin intranet të komunës; Protokollimi i lëndëve të ndryshme; Përcjellja e lëndëve tek Qendra për shërbime me qytetarë.

Sektori i Financave

Aprovimi i kërkesave për shpenzime; Përgatitja e lëndëve për pagesë; Mbajtja e kontabilitetit dhe e programit e-financa; Barazimi i shpenzimeve dhe të hyrave me Free balance; Përgatitja e buxhetit për vitet 2020-22; Përgatitjet për vitin e ri shkollor 2019-20; Furnizimi me ditarë; Përgatitja e kërkesave për zyrën e prokurimit dhe pjesëmarrja në vlerësimin e tenderëve; Furnizim me ushqim për Institucionet parashkollë dhe tri shkolla fillore shujta ditore; Përgatitjet për vitin e ri shkollor 2019-20; furnizimi me lëndë djegëse; mirëmbajtja e objekteve shkollë; Transporti i nxënësve; ndërtimi i objektit të ri shkollor në fshatin Haxhaj; Mirëmbajtja e kontabilitetit dhe e programit e-financa; Barazimi i shpenzimeve dhe të hyrave me Free balance; mirëmbajtja e objekteve shkollë.

Aktivitetet në implementim e sipër :

Monitorimi, kontrolli dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e ecurisë së procesit edukativo-arsimor

Analiza e raporteve mujore të dërguara nga udhëheqësit e Institucioneve të arsimit parauniversitar; Monitorimi i dinamikës së pushimeve mjekësore dhe zëvendësimeve të personelit profesional dhe teknik, në gjitha nivelet e arsimit; Shqyrtimi i kërkesave të pranuar përmes Qendrës për Shërbim me Qytetarë; Shqyrtimi i kërkesave nga Institucionet Arsimore në gjitha nivelet e edukimit;

Koordinimi i planit të veprimit me Organizatën Qeveritare Turke TIKa dhe drejtorinë e SHFMU “Musa Zajmi” në zbatimin e punimeve në hapësirat e SHFMU “Musa Zajmi” për tri klasë përgatitore.; DKA në bashkëpunim me MASHT-it, janë në fazën e përgatitjes së organizimit të trajnimit të kurrikulën për mësime të rinj të pranuar; Vlerësimi i fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta; Shqyrtimi i ankesave të mësimeve të cilët nuk janë pranuar në marrëdhënie pune; Takime sipas dinamikës së agjendave të Drejtorisë së Arsimit me zyrtarët e saj dhe udhëheqësit e Institucioneve të arsimit parauniversitar; Aplikimi dhe Hartimi i kërkesës për OJQ-Caritas Kosova, në përkrahjen me inventarë dhe mjete didaktike për klasat përgatitore në pesë (5) SHFMU; Hartimi i Kërkesës për mbështetje me pakon e trajnimeve -“Qasje praktike me fëmijët në nivelin e arsimit parashkollor, për edukatorët e Institucioneve parashkollore dhe klasave përgatitore në kuadër të projektit SHPRESA Caritas Kosova; Monitorimi i të gjitha projekteve në nivelin e arsimit para-universitar, të cilat janë në fazën e implementimit deri në vitin 2020

Sfidat :

Gjendja demografike dhe rënia e vazhdueshme e numrit të nxënësve, e cila do të reflekton në zvogëlimin e normave dhe paraqitjen e tepër të teknologjive të personelit profesional në arsimin para-universitar; Hartimi i rregullores për nivelin e arsimit parauniversitar; Zbatimi i Kurrikulës së re; Mungesa e edukatoreve mbështetëse, mësimeve mbështetëse, si dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta; Zbatimi i Menysë si derivat i projektit hulumtues shkencor i rekomanduar për moshën (3-6) vjeç, në institucionet parashkollore me qëndrim ditor; Mungesa e trajnimeve për ” Zhvillimin, Kujdesin në Fëmijërinë e Hershme “ dhe Planin Individual të Arsimit; Mungesa e trajnimeve bazike për Koordinatorët e Cilësisë; Pengesa në futjen në listën e pagave të mësimeve të cilët zëvendësojnë pa procedura të rekrutimit.

V. DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Gjatë kësaj periudhe (Janar – Dhjetor 2019) në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete tjera si në vijim:

Janë pranuar : **6232** lëndë- kërkesa të ndryshme: regjistrime të pronave, hipoteka, masa të përkohshme, barra tatimore, oferta, vlerësime , kërkesa për matje, shënime për përmbaruesit privat, parcelime, vektor, identifikime, bashkim i ngastrave, korrigjime, azhurnime grafike, rilevim të objekteve, regjistrimin e të drejtës së servitutit, modifikime tëtributeve të parcelës ose të pronarit si dhe shumë punë tjera lidhur me çështje kadastrale dhe gjeodezike.

Janë kryer: **6103** lëndë, Në procedurë janë : **129** lëndë.

- Janë lëshuar 14.068 Certifikata të pronës
- Janë lëshuar 1991 Certifikata të gjendjes ekonomike
- Janë lëshuar 2594 Kopje Plani
- Gjithsej produkte të gatshme : 18653 kopje

Përpos aktiviteteve të paraqitura si më lartë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka kryer edhe punë tjera të përditshme dhe periodike sipas detyrës zyrtare dhe sipas kërkesave të subjekteve të ndryshme, komunale, të nivelit qendror etj. Gjithashtu sipas Planit të Punës dhe Programit të saj për vitin 2019, është në proces të realizimit të :

1. Vendimet Preliminare të shpronësimit për Planin Rregullues Urban “Livadhet e Arapit” dhe përgatitja e dokumentacionit për vlerësimin e pronave për infrastrukturën bazë (rrugë dhe trotuare) dërguar Zyrës për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme në MF Prishtinë.
2. Jemi në procesin e harmonizimit të pjesës tekstuale dhe grafike, të gjendjes kadastrale dhe të asaj të planifikuar sipas Elaboratit Shpronësues të PRRU “ Kampi Montith”. Sipas kërkesave të qytetarëve të adresuara tek Zyra e Kryetarit, e që kanë të bëjnë me procedurat e shpronësimeve sipas projekteve Zhvillimore Komunale, i udhëheqim procedurat e shpronësimit, i adresojmë në Zyrën e Kryetarit për vlerësim dhe miratim.
3. Jemi në procedim të përditshëm të kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve qeveritare dhe komunale lidhur me çështjet pronësore dhe kadastrale në realizimin e projekteve kapitale siç janë: Autoudha Prishtinë – Gjilan-Dheu i Bardh, të projektit të zgjerimit të hyrje-daljeve në qytet: Gjilan-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj, Fabrikës së Trajtimit të Ujërave të Zeza në fshatin Uglar.
4. Përgatitja e lëndëve për shqyrtim në Kuvendin Komunal, si :
 - Shpallja e Interesit të përgjithshëm në pronat për nevojat e Impiantit të Ujërave të Zeza ZK Uglar;
 - Vendimi për lokacionin e Zyrave të Gjendjes Civile ;
 - Vendimi për krijimin e drejtës së ndërtimit në parcelat pronë komunale;
 - Vendimi për këmbimin e pronës private me pronën komunale “Rruga e Kumanovës”;
 - Zgjerimi i varrezave në fsh.Ponesh.,
 - Dhënia në shfrytëzim e pronës komunale (Don Bosko).
- 5.Regjistrimi i Vendimeve përfundimtare për shpronësim për nevoja të zgjerimit të rrugës me katër korsi: Gjilan-Prishtinë (ZK Gjilan dhe ZK Livoq i Epërm)
6. Regjistrimi i Vendimeve përfundimtare për shpronësim për nevoja të zgjerimit të rrugës me katër korsi: Gjilan-Kllokot (ZK Gjilan , ZK Livoq i Ulët, ZK Cërrnicë)
7. Parcelizimi i sipërfaqeve të shpronësuara sipas vendimeve të vitit 1975 për rrugën magjistrale Gjilan-Prishtinë , ZK Brealc (14 ngastra kadastrale).
8. 6 pronar të tokave në dy zona të ndryshme të qytetit (njëra në qendër e tjetra te vendi poredin) i kanë falur komunës pronat e veta me qëllim që të njëjtat të shfrytëzohen për nevoja publike (infrastrukturë). Sipërfaqja e tyre është: 2778 m². Regjistrimi i këtyre pronave në emër të Komunës është kryer në bazë të deklaratave të pronareve.
9. Janë nxjerr 16 Vendime Përfundimtare për Shpronësim të pronave për interes publik : Për nevoja të shkollës fillore (Livadhet e Arapit), Çerdhes së fëmijëve (Fidanishte) dhe infrastrukturës (Qarku 2002).
10. Jemi në komunikim të rregullt me Zyrën Rajonale të AKP-së në Gjilan dhe Zyrën Qendrore të AKP-së në Prishtinë, lidhur me kërkesat e komunës për pronat me interes publik e të cilat administrohen nga AKP-ja.
11. Gjatë vitit 2019 fondit të tokave komunale i janë shtuar edhe 29 ngastra kadastrale të shpronësuara për nevoja të projekteve komunale si: infrastrukturë, institucion arsimor dhe institucion parashkollor, rregullimi i shtratit të lumit Mirusha, parkut etj. me sipërfaqe të përgjithshme prej 20144 m² (02.01.44 ha) me një vlerë të përgjithshme prej 1,162, 240.00 € .

Për fund, vlen të theksohet se Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë gjatë kësaj periudhe ka pasur bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë dhe zyrat tjera komunale, me institucionet dhe agjencitë qeveritare: MAPL-në, Ministrinë e Financave, Agjencinë Kadastral të Kosovës, Agjencionin Kosovar të Privatizimit, Agjencionin Kosovar të Pronave, Agjencinë Pyjore të Kosovës, Arkivin Ndërkomunal, Gjykatat e rangut të ndryshëm, etj. si dhe me Organizatat Ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë : OSCE, USAID, KFOR etj.

VI. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale tërë aktivitetin në kuadër të përgjegjësisë dhe kompetencave të cilat janë të përcaktuara me Ligj dhe akte të tjera nënligjore (LVL), Statuti i Komunës, Ligji për Shëndetësi etj...) për këtë vit e ka bazuar në Planin e Punës për vitin 2019.

Krahas aktiviteteve të cilat zhvillohen në baza ditore në kuadër të zyrave që funksionojnë brenda DSHMS^{së}, si dhe aktiviteteve në dy institucione të rëndësishme siç është QKMF Dr.Nagip Rexhepi dhe Qendra për Punë Sociale, vëmendje e posaçme në këtë vit i është kushtuar realizimit të disa Projekteve Kapitale.

Në kuadër të investimeve në infrastrukturën shëndetësore, në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë, pas zhvillimit të procedurave të ri tenderimit kemi vazhduar me ndërtimin e objektit të QKMF-së, dhe tani punimet po zhvillohen sipas planit dinamik. Ndërtimi i AMF-së në fshatin Llashticë ka qenë projekt që është financuar me mjete vetanake të komunës dhe projekti i ndërtimit të AMF-së ka përfunduar dhe tani është funksional për qytetarët e Llashticës. Vlera e këtij projekti ka qenë 72,500.00€ Gjithashtu gjatë këtij vitit është bërë Renovimi i QMF-së Dardania i cili ka përfunduar.

Investime nga viti paraprak në pajisje speciale shëndetësore, e kanë mundësuar që në fillim të këtij viti ka filluar me ofrimin e shërbimeve të laboratorit në QMF Arbëria. Gjithashtu është realizuar kontrata për blerjen e shërbimeve shëndetësore profesionale, si dhe furnizim me dy auto-ambulanca për nevojat të shërbimit të urgjencës.

Ndërtimi i Sos Fshatit është projekt i cili realizohet në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit të Komunës së Gjilanit dhe qeverisë së Kuvajtit të cilin e përfaqëson Organizata Ekonomiko – Kulturore “Qëndresa Kosovare”. Sipas marrëveshjes Komuna i ka kryer të gjitha obligimet që nga ndarja e parcelës së tokës në sipërfaqe prej 3.5 Ha me vendim të Kuvendit Komunal, e deri tek pajisja me leje ndërtimore. Ky projekt ka filluar së implementuari me 10 Korrik dhe përfundimi i tij pritet të bëhet brenda 24 muajsh. Jemi në monitorim të vazhdueshëm të implementimit të projektit sipas Planit Dinamik të Punës.

Në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar përmes kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit e shoqatës bamirëse “Jetimet e Ballkanit” është realizuar projekti për ndërtimin e 20 shtëpive për rastet sociale të cilat janë përfunduar dhe përfituesit (Familjet) e këtij projektit tani

më janë të vendosur në këto shtëpi. Komuna në këtë projekt ka participuar me mjete financiare në vlerë prej 100,000.00€. Në vitin 2019 në koordinim me Komunën e Gjilanit donatori “ BUQAJ COMPANY ” ka ndërtuar 2 shtëpi të tjera për familjet e pa strehë krahas 20 shtëpive tjera.

Gjithashtu gjatë vitit 2019 kemi bërë renovimin e 6 shtëpive të familjeve me gjendje të rëndë sociale, me prioritet familjet të cilat kanë fëmijë me nevoja të veçanta, vlera e kësaj kontrate ka qenë 38,250.00€.

Në vitin 2019 në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal në Gjilan, është rinovuar gjithashtu edhe shtëpia e Familjes Shabanit nga fshati Përlepnice.

Përmes zyrës për mirëqenie sociale ka vazhduar implementimi i skemës sociale. Pagesa e qirasë për 51 familje me gjendje të rëndë sociale. Ky aktivitet është zhvilluar në baza mujore, në bazë të kontratave të lidhura në mes të komunës dhe 51 familjeve me gjendje të rëndë sociale të cilat janë përzgjedhur nga komisioni AD-HOC.

Meqenëse kontratat për pagesën e qirasë kanë skaduar në fund të vitit 2018, në këtë vit pas pranimit të kërkesave kemi lidhur kontrata të reja për pagën e qirave me 51 familje me kosto 41,500.00€

Gjithashtu kemi monitoruar edhe kontratat e shfrytëzuesve të banesave të banimit social.

Aktivitet tjetër në prioritet i DSHMS^{-së} në këtë vit ka qenë edhe realizimi i Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ^{-ve}, subvencionimi i OJQ^{-ve} përmes Thirrjes Publike realizohet për herë të parë këtë vit si pasojë e implementimit të Rregullores së Ministrisë së Financave 04/2017 mbi subvencionimin e projekteve të OJQ^{-ve}.

Gjithashtu edhe realizimi i Projektit të DDD^{-së} (Dezinfektim, Dezinsektim dhe Deratizim) ka qenë me prioritet për Drejtorinë tonë.

Procedurat e Prokurimit kanë filluar në muajin janar dhe Projekti si i tillë ka filluar të implementohet në fund të muajit qershor dhe do të vazhdojë edhe muajin korrik dhe gusht.

Të bashkangjitur gjeni Raportin e punës sipas zyrave të organizuara në kuadër të DSHMS^{-së} si dhe raportin e punës të QKMF Dr. Nagip Rexhepi dhe Qendrës për Punë Sociale.

Zyra për Shëndet Publik

Zyra e shëndetit publik që vepron në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale veprimtarin e vet e kryen duke u bazuar në planin e punës objektivi i së cilës është përmirësimi i gjendjes shëndetësore të popullatës, promovimi dhe edukimi shëndetësorë, ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës, kontrolli dhe monitorimi sëmundjeve ngjitëse, marrja e masave kundër epidemive si dhe parandalimit të sëmundjeve, çrregullimeve dhe të lëndimeve, duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat kompetente në të gjitha nivelet.

Aktivitetet e gjithmbarshme të mbrojtjes shëndetësore janë të kthyer drejt përkrahjes së mbrojtjes primare shëndetësore e në kuadër të së cilës në mënyrë prioritare sigurohet: mbrojtja e grupacioneve të rrezikuara të popullatës, sëmundjes apo dëmtimit të shëndetit siç janë fëmijët parashkollorë, shkollorë, rinia, femrat e sidomos gjatë periudhës së shtatzënisë, punëtorët, të moshuarit apo të sëmurët nga sëmundjet me karakter socialo-medicinal siç janë: sëmundjet malinje, diabeti, ethet reumatike, sëmundjet kardiovaskulare, pirja e duhanit, alkoolizmi narkomania prostitucioni, delikuenca etj.

Gjatë periudhës kohore Janar-Dhjetor 2019, në kuadër të zyrës për Shëndet publik, janë zhvilluar një sërë aktivitetesh që kanë pasur për qëllim monitorimin dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse në bashkëpunim me Institutin Rajonal të Shëndetit publik është mbajtur takim me komunitet lidhur me vaksinimin e fëmijëve si dhe roli i vaksinimit në mbrojtjen e shëndetit të popullatës, janë shpërndarë fletushka popullatës me përmbajtje edukative lidhur me vaksinimin. Për shkak të paraqitjes të gripit A H1N1 Instituti Kombëtar i Shëndetësisë së Kosovës ka rritur vigjilencën për t'u përballur me raste eventuale të gripit A H1N1. Instituti Kombëtar ka apeluar te të gjithë Drejtorët Rajonal të Shëndetësisë Publike të ngritët niveli i vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë ku ne si Drejtori i kemi marrë të gjitha masat e duhura preventive në bashkëpunim me QKMF-n dhe të gjithë organet relevante duke rritur vigjilencën për t'u përballur me raste eventuale të gripit A H1N1 dhe ishim në gjendje gatishmërie të përcjellë situatën epidemiologjike për mbrojtje nga gripi. dhe edukimin e popullatës përmes seminareve që për qëllim kanë pasur ruajtjen e shëndetit nga faktorë të ndryshëm të ambientit si dhe mbajtja e ligjëratave nëpër shkolla të mesme të Komunës lidhur me abuzimin e substancave psikoaktive. Aktivitete të tilla në sferën e propagimit të shëndetësisë, monitorimit të sëmundjeve janë zhvilluar si në viset rurale po ashtu edhe në Komunën tonë. Monitorimi i sëmundjeve ngjitëse është bërë te banorët e fshatrave Bresalc, Livoq i Poshtëm, Pogradjë, Zhegër, Nasalë, Mireshe, Shurdhan, ku po ashtu janë vizituar qendrat dhe punktet e mjekësisë familjare dhe janë bërë konsultimet me stafin mjekësorë. Për ditën botërore të ujit është vizituar penda Përlepnicës ku për së afërmi jemi njoftuar lidhur me gjendjen e ujit të pijshëm si dhe analizat kimiko bakteriologjike. Po ashtu janë shpërndarë broshura nxënësve dhe popullatës që për temë ka pasur ruajtjen e ujit të pijshëm si resurs natyrorë.

Në bashkëpunim me Institutin Rajonal të Shëndetësisë Publike më 31 maj shënohet Dita Botërore kundër duhanit duke shpërndarë fletushka nëpër rrugët e qytetit që të sensibilizojmë opinionin mbi dëmet dhe rreziqet e duhanit dhe të inkurajojmë reduktimin e prodhimit dhe konsumimit të duhanit. Po ashtu me 26 qershor është mbajtur dita botërore kundër Abuzimit dhe Trafikimit të Drogave, është shfaqur një dokumentar në teatrin e qytetit lidhur me dëmet që sjell droga, si dhe janë shpërndarë broshura me përmbajtje rreth substancave narkotike, varësisë që ato krijojnë tek përdoruesit dhe pasojat shëndetësore dhe sociale.

Me datë 21.06.2019, ka filluar projekti i Dezinfektimit hapësinor i qytetit i cili është zhvilluar në tri etapa kohore, këtë vit kanë qenë të parapara për dezinfektim edhe zonat rurale ku ka potencial të lartë të zhvillimit të këtyre insekteve sidomos rreth lumenjve këto fshatra janë: Malisheva,

Uglari, Pogragja, Dobërqani, Përlepnica, Livoqi i Epërm, Livoqi i Poshtëm Cërrnica, Lladova, Zhegra, Llashtica dhe Velekinca, trajtimi i sipërfaqeve për dezinfektim hapësinor është bërë nga toka me mjete të posaçme të cilat krijojnë aerosole të imta në formë të mjegullës së ftohët mjete të sofistikuara në bazë të principit ULV(Ultra Low Volume), dy kamioneta dhe pompa dore në ato vende ku nuk mund të depërtoj kamioneta. Principi themelor i spërkatjes hapësinore është arritja e kontaktit maksimal në mes të insektit dhe insekticidit.

Angazhimi ynë ekipor si dhe i kompanise për të arrit suksesin e duhur ka qenë në nivel, me qëllim që ky proces shumë i domosdoshëm dhe i mirëpritur të ketë rezultatin e kënaqshëm dezinfektimi hapësinor prej 1300 hektarësh, ka përfunduar me 18.08.2019.

Gjithashtu gjatë muajit gusht-shtator është bërë dezinfektimi dhe deraztizimi i të gjitha objekteve shkollore dhe institucioneve parashkollore të parapara sipas Drejtorisë së Arsimit.

Në bashkëpunim me institutin e shëndetit publik në Gjilan, është zhvilluar kampanjë vetëdijesuse në komunitet lidhur me sëmundjen e diabetit, janë shpërndarë fletushka si dhe është bërë matja e sheqerit në gjak te një pjesë e komunitetit. Po ashtu është mbajtur debat me qytetar lidhur me kancerin e gjirit si dhe shpërndarja e broshurave lidhur me këtë sëmundje si dhe janë dhënë rekomandime nga personeli profesional shëndetësor nga QKUK-ë.

Në bazë të kërkesës së banorëve të lagjes „Idriz Seferi” Gjilan, për shkak të prezencës së shtuar të insekteve fluturuese të cilat përmes thumbimit që shkaktojnë reaksione alergjike, njëherit lëvizja e insekteve dhe qëndrimi i tyre në vende të ndotura mundë të shkaktojnë bartjen e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit prej një vendi në vendin tjetër(vektor bartës), është bërë dezinfektimi i kësaj zone nga kompania N.T.SH. “FAUNA” me datën 05.11.2019 dhe 06.11.2019.

Për ditën botërore të HIV-ADS, në muajin dhjetor është mbajtur takim në Institutin Kombëtar të Shëndetit publik në Prishtinë lidhur me masat mbrojtëse nga kjo sëmundje si dhe trajtimi i pacienteve të infektuar nga kjo sëmundje.

Në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës është mbajtur tryezë diskutimi tema e se cilës ishte Cilësia e ujit në shkollat e Komunës së Gjilanit.

Është bërë shqyrtimi i kërkesave të palëve me sëmundje të ndryshme të cilët ekonomikisht nuk kanë mundësi ta marrin terapinë complete mjekësore të dhënë nga mjekët e lamive përkatëse nga komisioni i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe janë dhënë këshilla lidhur me sëmundjet përkatëse.

Zyra për Shërbime Shëndetësore

Në vazhdim do të përmenden shkurtimisht disa nga punët e kryera dhe aktivitetet e zhvilluara nga ZSHSH gjatë vitit 2019.

Punë periodike me kërkesat e palëve në skemën e subvencionimit të qytetarëve për qëllime shëndetësore. Brenda periudhës për të cilën po raportojmë në DSHMS janë pranuar 1009 kërkesa,

prej të cilave 676 janë kërkesa që dëshmojnë probleme shëndetësore të palëve prandaj për të njëjtat është akorduar ndihmë në ndonjërin prej muajve të vitit 2019.

Nga numri prej 1009 kërkesash komisioni vlerësues ka rekomanduar ndihmë për 676 prej tyre dhe për të njëjtat është bërë shpenzim në vlerë prej 85.225 euro, të tjera për arsye të caktuara i ka refuzuar. Pasqyrimi mbi periodat dhe nivelin e shpenzimit të bërë mbi ndihmat e akorduara për kërkesat sipas muajve, mundet të vërehet nga tabela në vazhdim:

Tabela, Nr. 1

Nr.	Muaji kur është bërë pagesa.	Nr, i kërkesave të aprovuara	Shuma e paguar (€)	Data e shpenzimit	Vërejtje!
1	Shkurt	7	2295	13;25,27 dhe 28.02.2019	(12/18-01/19).
2	Mars-I-	38	4950	12.03.2019	
2A	Mars-II	48	5050	18.03.2019	
3	Prill-I-	8	1020	12.04.2019	Kompl.me vonesë!
3A	Prill-II-	83	8510	11.04.2019	
4	Maj	61	7290	16.05.2019	
5	Qershor	56	6720	20.06.2019	
6	Korrik	50	6580	10.07.2019	
7	Gusht	70	8960	08.08.2019	
8	Shtator	67	10660	12.09.2019	
9	Tetor	69	9840	11.10.2019	
10	Nëntor	71	7690	13.11.2019	
11	Dhjetor	48	5660	Dhjetor 2019	
	Totali:	676	85.225		

Për qëllim krahasimi të kërkesave që kanë përfituar ndihmë në vitin 2019 në raport me vitet paraprake shërben tabela e radhës:

Tabela, Nr.2

Viti	Aprovim ndihme për barëra sipas viteve	Mjete të shpenzuara shprehur në euro!	Kër. të apr. më tepër ose më pak se në vitin paraprak.	Shpenzim më tepër ose më pak (euro).
2019	676	85225	+51	+8178
2018	625	77047	+310	+46851
2017	315	30196	-182	-21714
2016	497	51910	+21	+3940
2015	476	47970	+49	-2868
2014	427	50838	-32	+6283

2013	459	44555	-	
------	-----	-------	---	--

Kryesisht vërehet një trendë i rritjes së numrit të kërkesave nga viti në vit, rrjedhimisht edhe i rritjes së shpenzimit nga fondi i subvencionit.

Evidentimi, kompletimi dhe përgatitja për shpenzim mbi lëndët e theksuara janë disa nga veprimet me të cilat përmyllen procedurat administrative në DSHMS. Kjo punë kërkon një kohë pasi që një numër i konsiderueshëm i kërkesave kalojnë përmes QSHQ dhe arrijnë në DSHMS të pa kompletuara me dokumentacionin adekuat.

Gjatë muajit Janar/2019 në DSHMS, por edhe në nivel komune është përmyllur procesi vjetor i regjistrimit të inventarit. Në këtë punë jam angazhuar si anëtar i komisionit komunal.

Në muajin mars përkatësisht më 11,12 dhe 13 isha pjesëmarrës në trajnimin mbi KSHQK (kujdesin shëndetësor të çastshëm dhe kualitativ). Organizuar nga MSHMS—Kosovë dhe SDC-Zvicër.

Në vazhdim nga e njëjta temë por mbi çështjen e përgatitjes së Planit të Veprimit Komunal në KPSH gjatë prillit dhe majit/2019 kam marr pjesë në tri raste në punëtoritë njëditore organizuar nga AQH dhe ARC si organizatë konsulente.

Në cilësi të anëtarit të komisionit komunal për tjetërsim dhe asgjësim të inventarit të pa përdorshëm me kolegët tjerë jam angazhuar që të gjejmë zgjidhje për problematikën në fjalë por kjo punë nuk ka vajtur si duhet,(ka tejkaluar mundësitë dhe angazhimin tanë).

Si anëtar i komisionit komunal për riintegrim kam marrë pjesë në katër seanca ku janë shqyrtuar kërkesa të palëve të kthyer nga emigracioni, ndërsa në një rast me anëtarët tjerë të komisionit kam marrë pjesë në hulumtimin e fakteve të cënueshmërisë për një individ të riatdhesuar.

Në ZSHSH në bazë ditore pranohen me dhjetëra palë (pacient ose familjar të tyre) për konsultime dhe sqarime që kanë të bëjnë me problemet dhe shërbimet shëndetësore si dhe mundësisë për përkrahje të tyre.

Zyra Administrativo – Juridike në vitin kalendarik 2019 ka filluar me zbatimin e planit të punës të aprovuar për vitin :2019. Kjo zyrë gjatë periudhën: JANAR- DHJETOR ka zhvilluar këto aktivitete në sfera të ndryshme:

Nga fusha legjislative:

Ka bërë zbatimin e të gjitha ligjeve në fuqi nga lëmi i shëndetësisë, Rregulloreve, Udhëzimeve, Qarkoreve dhe Vendimeve të ndryshme, si: Udhëzimi Administrativ i Shëndetësisë,08/ 2017, mbi Organizimin, përcaktimin e shërbimeve dhe veprimtarisë së institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH)).

Ka publikuar Thirrjen Publike për subvencionimin e QJQ-ve, bazuar në Rregulloren: nr: 04/2017, në Republikën e Kosovës, janë hartuar shkresa, vendime, aktvendime, dhe procese të ndryshme për nevoja të Drejtorisë dhe shërbime tjera në kuadër të Komunes dhe QKMF-së.

Nga fusha tjera

Zyra Administrative ka kryer edhe punë tjera si: vizita të ndryshme në terren në cilësinë e anëtarit të komisionit, në këtë periudhë janë hartuar, vendime dhe aktvendime për ndihmë në barëra, qira, për zyrën e Kryetarit dhe raste të cilat po i japim në vazhdim:

- Zyra Juridike ka përfunduar me kompletimin gjerë në lejen ndërtimore të dokumentacionit lidhur me ndërtimin e objekteve të parapara me projekt të Qendrës S.O.S. për “Fëmijët e Braktisur, Fëmijët me Nevoja të Veçanta mbrojtjen e Nënës dhe Fëmijëve, Shtëpisë për të Moshuarit” në Gjilan si donacion i shtetit të Kuvajtit
- Pjesëmarrja në trajnimin e organizuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme.
- Së bashku me zyrën për shërbime shëndetësore ka zhvilluar monitorimin në institucionet e shëndetësisë primare i cili aktivitet është duke vazhduar gjerë në përfundimin e tij.
- Ka përgatit dhe ka monitoruar edhe procedurat lidhur me konkursin e publikuar nga ana e DSHMS-së, për nevoja të stafit për shëndetësinë primare.
- Zyrtari juridik ka kryesuar edhe komisionin për shqyrtimin e ankesave.

Paraqitja në mënyrë tabelare e vendimeve të hartuara

Lloji	Për barëra	aprovime	refuzime	Për shoqata	Për zyrën e Kryetarit	Të ndryshme	Totali
////////	831	590	241	14	26	94	1065

Zyra Administrative ka qenë e angazhuar edhe në komisione të ndryshme si në inspektimin e institucioneve shëndetësore në shëndetësinë primare, vizita të rasteve sociale, në komisione të ndryshme të formuara nga institucionet komunale.

Zyra juridike ka ofruar edhe këshilla profesionale për nevoja të shërbimeve të drejtorisë e më gjerë, si dhe shërbime tjera sipas nevojës.

Zyra për Mirëqenie Sociale

Zyra Financiare për Mirëqenie Sociale në periudhën 01.01- 18.12.2019, në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka punuar në kryerjen e të gjitha obligimeve për pagesa që dalin sipas marrëveshjeve dhe kërkesave për pagesë si dhe zbutjen e gjendjes së mendës sociale me të cilën po ballafaqohet pjesa më e madhe e popullatës si në Kosovë në përgjithësi dhe në komunën tonë në veçanti.

Pagesat për ndihmat në fushën sociale

Pagesat e qirasë për familjet me gjendje të rëndë Sociale të rekomanduara nga Komisioni ad hocc.

Përmes zyrës për mirëqenie sociale ka vazhduar implementimi i skemës sociale. Pagesa e qirasë për 51 familje me gjendje të rëndë sociale. Ky aktivitet është zhvilluar në baza mujore , në bazë të kontratave të lidhura në mes të komunës dhe 51 familjeve me gjendje të rëndë sociale të cilat janë përzgjedhur nga komisioni AD-HOC.

Meqenëse kontratat për pagesën e qirasë kanë skaduar në fund të vitit 2018, në këtë vit pas pranimit të kërkesave kemi lidhur kontrata të reja për pagesën e qirave për 51 familje me kosto 41,500.00€

Gjithashtu kemi monitoruar edhe kontratat e shfrytëzuesve të banesave të banimit social.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Gjilan, e mbështetur në nenin12, paragrafi 1-6, të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr.04/2017,mbi financimin publik të OJQ-ve, shpall THIRRJE PUBLIKE për mbështetje financiare publike të projekteve të OJQ-ve sipas thirrjes së datës 18.03.2019 me nr. të protokollit 04-180/01-0029847/19.

Fushat prioritare në këtë thirrje publike ishin:

- Promovimi dhe përkrahja e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes sociale të familjeve me gjendje të rëndë ekonomike-Sociale,
- Lehtësimin e gjendjes së kategorive të personave me nevoja të veçanta,
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e kategorive të personave në nevojë të cilët janë të organizuar në shoqata të ndryshme.

Organizata joqeveritare të cilat mund të aplikojnë ishin ato të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes sociale të qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike si:

- Projekte të dedikuara në organizimin e aftësimin profesional të kategorive të personave me nevoja të veçanta dhe risocializimi I tyre,

- Projektet të cilat parashohin mbrojtjen e kategorive të cilat iu kanë nënshtruar dhunës apo rreziqeve të ndryshme,

- Projekte të cilat parashohin ndihmë për krijimin e kushteve normale dhe rekreacion për persona të verbër, të shurdhër dhe persona me nevoja të veçanta.

Vlera totale financiare e planifikuar e thirrjes publike ka qenë: 32,000.00€.

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është 1,000.00€ ,ndërsa ajo maksimale 15,000.00€.

Në komision vlerësues dhe shqyrtues të aplikacioneve i nxjerrë nga Kryetari i Komunës me nr.02-281 të datës 14.04.2019 në përbërje ishin:

- 1.Sami Ahmeti, DSHMS
- 2.Fatlum Jashari. ekspert i jashtëm
- 3.Djellza Selishta, eksperte e jashtëm (OJQ)
- 4.Destan Maloku, DBF
- 5.Fadil Kajtazi, DMSH
- 6.Burim Elezi, rezervë në rast konflikt të interesit.

Me datë 19.04.2018, komisioni në fjalë ka bërë vlerësimin e aplikacioneve ku prej 8 aplikacioneve, ka nxjerrë 7 të kompletuara, një nuk ka pasur të bëjë me projektin dhe 6 përfitues.

OJQ të cilat kanë përfituar janë:

- 1.Qendra e Gruas “Liria” -4,000.00€
- 2 .Shoqata “Handikos” -12,000.00€
- 3.Shoqata e shurdhmemecëve “Anamorava”-1,000.00€

- 4.Shoqata e të Verbërve-4,000.00€
- 5.Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-s-2,000.00€
- 6.OJQ DOWN Sindrom Kosova-2,000.00€.

Shuma e përfituar nga OJQ është gjithsej: 25,000.00€

Bazuar në nenin 23, paragrafi 1,2,3 dhe 4, të Rregullores së Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës nr:04/2017, mbi kriteret, Standardet dhe Procedurat e financimit publik të OJQ-ve, drejtori i DSHMS-s nxjerr VENDIM nr.04-64857 të dt.11.06.2019 me të cilin ÇAKTOHET-Kosovare Gashi, zyrtare përgjegjëse për ndihmë financiare , monitorimin dhe implementimit të projekteve të OJQ-ve përfituese sipas thirrjes publike.

Të gjitha OJQ-të përfituese pas vlerësimit nga komisioni vlerësues kanë nënshkruar Kontratën e përkrahjes financiare në mes tyre dhe Kryetarit të Komunës dhe pastaj janë pajisur me vendimet për pagesë nga drejtori i DSHMS-s, ku gjithashtu u janë realizuar pagesat nga sektori financiar sipas kushteve të projektit dhe formave të raportimit në bashkëpunim me zyrtaren përgjegjëse të projektit

Përfitimet, shpenzimet dhe raportimet e OJQ-ve:

Nr.	OjQ-përfituese	Të hyrat nga K.K-Gjilan	Shpenzimi nga OJQ-t	Diferenca
1	Qendra e Gruas "Liria	4,000.00€	2,100.00	1,900.00 Barten 2020
2	Shoqata "Handikos"	12,000.00€	12,000.00	/
3	Shoqata e shurdhmemecëve "Anamorava"-	1,000.00€	1,000.00	/
4	Shoqata e të Verbërve	4,000.00€	6,683.00	Tejkalim 2,638
5	Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK	2,000.00€	1681.55	-318.45 Barten 2020
6	OJQ DOWN Sindrom Kosova	2,000.00€	2,000.00	/
7				
8				
10				
	Totali:	25,000.00€		

Bashkëpunimi me subjektet tjera

Zyra për Mirëqenie Sociale pranë Drejtorisë për Shëndetësi, ka bashkëpunuar edhe me organet tjera në nivel Komunal si dhe me shërbimet tjera në kuadër të drejtorisë si, me zyrën për Shëndet Publik, zyrën Adm. Juridike, Zyrën për Shërbime Shëndetësore në këtë kontest zyrtari për M.S. është edhe anëtar i komisionit intern për shqyrtimin e kërkesave të palëve pranë drejtorisë.

Punët tjera

Në kuadër të punëve tjera zyra për Mirëqenie Sociale ka zhvilluar edhe kontakte me palë ku të njëjtave iu ka ofruar këshilla sugjerime dhe sqarime nga sfera Sociale, ka pasur bashkëpunim të ngushtë edhe është ndihmuar dhe i ka ndihmuar edhe shërbimet tjera në suaza të mundësive.

Në pika të shkurtra është raporti i punës së kësaj zyre për periudhën e cekur më lartë.

Zyra e asistentit/sek. Teknik

Kërkesa të ndryshme të qytetarëve: për barëra, ndihmë financiare për mjekim, për syza mjekësore, kërkesa për vërtetime etj...

Vendime për barëra, për qira, vërtetime etj...te sistemuara në databazë.

Gjithsej 796 , të gjitha këto të sistemuara, përgjigjet e regjistruara dhe të plasura në databazë

Vendime të ndryshme të qytetarëve: të protokolluara 706Vendime për pagesa në emër të ndihmës së përkohshme për familjet për pagesa të qirasë në prot. unik të Komunës (elektronik d.bazë).

Të gjitha këto materiale: Vendime, Kërkesa të ndryshme dhe material të tjera arkivohen në hapësirat e DSHMS-së

Kontaktet dhe informatat me palë të ndryshme, shoqata etj, punë kjo e përditshme në Drejtori.

Numri i lendeve për shenja te klasifikimit sipas Departamenteve

Shenja	Përshkrimi	Numri
016/01	Në përgjithësi për institucionet publike, për sistemin komunal dhe të drejtat e qytetarëve(banorëve) të komunave.	52
111/01	Konkurset, shpalljet e vendeve të punës, lajmërimet, paraqitja në konkurs, zgjedhja e kandidatëve.	4
180/06	Shkresat dhe aktet administrative.	1
325/05	Procesverbalet dhe aktet administrative.	1
354/02	Raportet dhe procesverbalet dhe vendimet.	1
453/01	Financimi i OJQ-ve (odat ekonomike etj.)	2
530/01	Inspektimet sanitare dhe shëndetësorë ose format tjera të mbikëqyrjes për këtë çështje.	1
553/01	Ndihma sociale në të holla.	644
	Totali	706

Shenja	Shenja DSC	Numri
000/01	Rregullimi shtetëror dhe politik në përgjithësi.	2
016/01	Në përgjithësi për institucionet publike, për sistemin komunal dhe të drejtat e qytetarëve(banorëve) të komunave.	25
110/01	Marrëdhëniet e punës në përgjithësi dhe ndarja e të ardhurave personale.	1
111/01	Konkurset, shpalljet e vendeve të punës, lajmërimet, paraqitja në konkurs, zgjedhja e kandidatëve.	26
180/04	Kërkesa, pyetësor etj.	880
180/06	Shkresat dhe aktet administrative.	1
200/03	Librat amë të lindjes, evidencat dhe dublikatë.	1
320/01	Bujqësia.	1
325/05	Procesverbalet dhe aktet administrative.	1
343/04	Kërkesat dhe aktet tjera në lidhje me komunikacionin.	3
355/01	Inspeksioni i punëve komunale.	1
453/01	Financimi i OJQ-ve (odat ekonomike etj.)	2
530/01	Inspektimet sanitare dhe shëndetësore ose format tjera të mbikëqyrjes për këtë çështje.	1
553/01	Ndihma sociale në të holla.	796
610/01	Arsimi në përgjithësi .	1
	Totali	1,742

Gjatë vitit 2019, QKMF përveç ofrimit të shërbimeve shëndetësore ka realizuar edhe aktivitete tjera të poshtë shënuara.

Vitin 2019-të QKMF si gjithëherë ka filluar me ofrimin të shërbimeve, por edhe me aktivitete tjera duke u fokusuar në ;

- Ofrim të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët e Gjilanit
- Ngritjen e cilësisë në të gjitha shërbimet shëndetësore
- Plotësim i furnizimit me barna dhe material tjetër harxhues nga ana e QKMF-së përpos furnizimit nga lista esenciale
- Furnizim me aparaturë mjekësore dhe inventar për kushte më të mira të punës
- Trajnime dhe ligjërata (EVP) të stafit si të mjekëve ashtu edhe të infermiereve

Aktivitetet

- Janë mbajtur takime të rregullta të Këshillit Profesional të QKMF-së
- Është bërë monitorimi i vijueshmërisë dhe disiplinës së punëtorëve në QKMF, QMF dhe AMF.
- Konform nevojave të QMF-ve dhe shërbimeve brenda tyre në mënyrë të vazhdueshme është bërë furnizimi me aparaturë dhe material tjetër të nevojshëm për punë.
- Është bërë konsolidimi i shërbimeve në QKMF, QMF dhe AMF me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Puna në shërbimet shëndetësore

Mjekësia Familjare

- Ka ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë qytetarët e Komunës së Gjilanit të të gjitha moshave si në objektin e saj kryesor me shërbimet brenda saj, gjithashtu edhe në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare të shtrira në tërë territorin e Komunës së Gjilanit.
- Nga muaji Gusht është lidhur marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës së Gjilanit dhe CARITAS Kosova për pranimin e 35 punëtorëve shëndetësor për ofrim të shërbimeve shëndetësore në QKMF, QMF dhe AMF duke e mbuluar dhe punktun më të largët siç është Shurdhani dhe Verbica e Zhegovcit.

Stomatologjia

- Shërbimi i stomatologjisë i cili ofron shërbime shëndetësore me gjashtë ordianca brenda objektit kryesor QKMF, gjithashtu ka rrjetin e saj të karrigeve stomatologjike edhe nëpër qendrat e tjera si në qytet gjithashtu edhe nëpër disa fshatra. Shërbimet të cilat ofrohen janë :
 - Preventivë
 - Ortodonci
 - Protetikë
 - Kirurgji orale
 - Sëmundje të dhëmbit

Të gjitha këto ofrojnë shërbime shëndetësore për të gjitha moshat e qytetarëve të Komunës së Gjilanit.

Urgjenca

- Sikurse edhe në vitet tjera shërbimi i Urgjencës ofron shërbime shëndetësore 24 orë, 7 ditë në javë .
- Në këtë shërbim janë të organizuara edhe kujdestaritë gjatë natës , vikendeve dhe festave , ku puna ka shkuar mirë dhe pa probleme .
- Edhe gjatë këtij viti vazhdon ekipi në kuadër të kujdestarisë së natës për ofrim të shërbimeve shëndetësore më të shpejta dhe me cilësore .
- Autoambulanca është monitoruar në vazhdimësi në drejtim të funksionimit dhe furnizimit të saj me pajisje dhe mjete të nevojshme për punë në terren , rregullisht ka qenë e furnizuar me barëra dhe material tjetër harxhues për intervenime të shpejta në terren për të gjitha thirrjet nga ana e qytetarëve .
- Vlen të theksohet se pas shumë angazhimeve dhe planifikimit të mirëfilltë për këtë shërbim të ndjeshëm jemi furnizuar me dy Autoambulanca të reja të blera nga buxheti vetanak i Komunës së Gjilanit, të cilat janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme për intervenim urgjent në terren.
- Përpos sigurimit të automjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për punë gjithashtu ky shërbim është përforcuar edhe me kuadër profesional shëndetësor dhe janë shtuar ekipe shtesë të cilat do të japin shërbime 24 orë për qytetarët e Komunës së Gjilanit.

Laboratori

- Është bërë furnizimi me material të nevojshëm për funksionimin normal të Laboratorit.
- Kemi hapur laboratorin në QMF Arbëri për analiza laboratorike dhe është duke funksionuar normalisht për të gjithë pacientet e lagjes Arbëria dhe më gjerë .
- Janë ofruar shërbime shëndetësore për të gjithë pacientët të cilët janë paraqit në shërbimin e Laboratorit
- Është për të theksuar se këtë vit shërbimi i laboratorit ka përfituar edhe dy aparate shtesë nga Ministria e Shëndetësisë si donacion duke pas parasysh angazhimin e Menaxhmentit të QKMF-së .
- Këto dy aparate i kemi vendos në shërbimin e laboratorit të QMF Dardania dhe është teknologjia e fundit për analiza biokimike dhe hematologjike .
- Edhe ky shërbim i laboratorit është përforcuar me kuadër profesional adekuat.

Barnatorja

janë kryer në mënyrë të rregullt porositë mujore për furnizim me barna dhe material harxhues nga MSH

është bërë distribuimi i barnave dhe materialit harxhues nëpër QMF dhe AMF-ët duke i llogaritur edhe shërbimet brenda tyre

është bërë furnizimi i pacientëve me barna dhe insulinë

është bërë planifikimi gjashtëmujor për furnizim me barna dhe material harxhues për periudhën korrik –dhjetor 2019

gjatë kësaj periudhe kemi blerë mjete vetanake në raste specifike, terapi të domosdoshme për shërbimin e Urgjencës .

Sistemi informativ Shëndetësor

Janë raportuar me kohë të gjitha raportet në të gjitha institucionet relevante është përcjellë gjendja e sëmundjeve përmes formularëve të caktuar dhe është raportuar me kohë në IRSH. në muajin Maj ka filluar instalimi i digjitalizimit në QKMF ku jemi pajisur me kompjuterë dhe janë vendosur në të gjitha shërbimet shëndetësore .

Në QKMF pas instalimit të Sistemit Elektronik, 95% e pacientëve të vizituar kryhen në mënyrë digjitale, përpos atyre që nuk kanë dokument identifikimi. Është rritur kapaciteti i futjes së fletëzave kompjuterike me përforcimin e stafit nga punëtorët me projektin e bashkëpunimit mes Komunës dhe Caritas Kosova.

Kujdesi për nëna dhe fëmijë

Janë kryer vizitat e rregullta si për fëmijët e porsalindur ashtu edhe për lehonat dhe shtatzënat,

Raporti i shërbimeve shëndetësore shih tabelat në vijim

Tabela, nr.1

Nr	Shërbimet	Totali	Nr.referimeve dhe %
1	Vizita në mjekësinë familjare	171868	25655 14.92%
2	Vizitat në Emergjencë	43743	5146 11.74%
3	Vizitat shtëpiake -shër. Emergjent	4019	
4	Vizita Stomatologjike	18694	
5	Shërbime laboratorike	27877	
6	Kujdesi Paliativ	1615	3 0.318%
7	Kujdestaria e fëmijëve	7021	1041 14.82%
8	Qendra e diabetit	2803	132 4.70%

9	Participimi i përgjithshëm	50608	20.31%
10	Vizita Psikologjike	1211	17 1.40%
11	Evidentimi i fletëzave kompjuterike nga SESSH –i	104078	
12	Certifikata të lëshuara	1282	
13	Vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë	1035	
14	Pushime Mjekësore	3322	
15	Barnatorja –shërbime	66397	
15	Totali i Vizitave	252009	
16	Shërbimet tjera shëndetësore	442733	
17	Totali i ofrimit të shërbimeve nga QKMF për qytetarët e K.Gjilanit	694742	

Tabela, Nr.2 i sëmundjeve ngjitëse

RAPORTI I SËMUNDJEVEVE NGJITËSE							
Sipas Moshes	0-4 vjeç	5-14 vjeç	15-34 vjeç	35-49 vjeç	50-64 vjeç	mbi 65 vjeç	Totali
Pneumoni	107	91	57	104	104	64	527
Diarre Acute	612	778	973	652	317	136	3468
Variçella	90	125	50	33	23	9	330
Dyshimi në Influcë (Gripi)	125	301	332	813	171	51	1793

SARI (infeksionet acute respiratore të rënda	6	4	3	47	33	3	96
Dyshimi në parotitin epidemik							0
Sindroma e verdhëzës acute							0

LËSHIMI I CERTIFIKATAVE								
QMF dhe PMF	Certifikata për patentë shofer	Pushimet mjekësore	Certifikata të K.I	Certifikatë mjekësore	Certifikata e vdekjes	EKG	Participimi i certifikatave	Spirometri
Janar	0	268	24	53	26	7	39	2
Shkurt	0	290	33	40	32	10	25	1
Mars	0	308	15	44	41	0	28	1
Prill	0	332	9	38	33	15	25	1
Maj	0	280	22	39	29	42	17	0
Qershor	0	81	23	68	31	0	18	0
Korrik	0	299	18	55	32	60	35	1
Gusht	0	215	8	140	28	4	28	0
Shtator	0	242	10	64	30	20	10	0
Tetor	0	340	18	68	31	20	30	0
Nëntor	0	302	12	31	29	42	16	0
Dhjetor	0	365	12	60	36	62	42	0
	0	3322	204	700	378	282	313	6

Tabela, nr.4. Raporti i sëmundjeve malinje dhe masovike jo ngjitëse

Raporti i sëmundjeve malinje dhe masvike jo ngjitëse	
Sëmundjet e paraqitura	Rastet
Sëmundjet malinje	7
Sëmundjet masovike jo ngjitëse	1

Tabela Nr.5. Raporti i shërbimit të vaksinimit

Grup-moshat	Numri vjetor i fëmijëve të grupit të planifikuar	Numri i fëmijëve të grupit të planifikuar
o-11 muaj BCG, dtp -HepB –IPV	1150	100
12-23 muaj MMR, bOPV, DTPr	1500	
IPV, DTP, HepB, Hib	50	
12-59 muaj OPVr/DPTTr	50	
MMR	50	
Fëmijët e klasës së parë	1247	
Fëmijët e klasës gjashtë	1179	
Fëmijët e shkollës së mesme klasa XII-	1980	

RAPORTI MUJOR I SHËRBIMIT TË VAKSINIMIT									
Emri i Vaksinës	0-11 muaj	12-23 muaj	24-59 muaj	mbi 59 muaj	Totali	Emri i vaksinës	12-23 Muaj	Mbi 23 muaj	Totali
BCG ne maternitet					0	OPV R1 (12-18 m)	953		953
Hepatit B ne maternitet					0	DP R1 (12-18m)	953		953
OPV1	1060				1060	OPV R2 (6-7vj)	1233		1233
OPV2	1096				1096	DT (6-7vj)	1233		1233
OPV3	1070				1070	MMR r(6-7vj)	1247		1247
DPT1+Hib1+hep B1	1060				1060	OPV R3(12-13vj)	1179		1179
DPT2+Hib2+hep B	1096				1096	Td(12-13vj)	1179		1179
DPT3+Hib3+hep B3	1070				1070	Td(18vj)	1980		1980
Hep.B1 ne maternitet						Vaksinat tjera	0		
Eep.B2									
Hep.B3									
MMR		1124	4		1128				
MMMR II 15-18 Muaj		10			10				
Vaksina tjera					0				

Gjatë muajit dhjetor janë vaksinuar me vaksinë kundër gripit sezonal 6750 pacient, prej tyre; (punëtor shëndetësor, pacient me sëmundje kronike dhe 50 fëmijë)

Tabela, nr.6. Raporti i vizitave në shtëpi për shëndetin e nënës dhe fëmijës

Indikatori	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Numri i vizitave shtëpiake për fëmijë	52	9 2	6 8	6 2	7 8	7 4	10 4	4 5	81	92	67	6 1	876
Numri i vizitave shtëpiake për shtatzëna	10	2 3	1 4	1 0	1 6	1 7	5	1 7	8	10	13	1 6	159
Nr. total i vizitave shtëpiake të kryera (gjatë një muaji)	62	1 1 5	8 2	7 2	9 4	9 1	10 9	6 2	89	10 2	80	7 7	1035
Nr. i fëmijëve vajza të cilat kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0-3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	15	1 6	1 9	1 5	1 2	1 9	7	7	18	21	25	2 0	194
Nr. i fëmijëve djem të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0-3 vjet (Janë vizituar për herë të parë)	16	2 6	1 5	9	2 5	2 3	6	7	25	28	14	2 2	216
Nr. Total i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake 0-3 vjet (Janë vizituar për here te pare)	31	4 2	3 4	2 4	3 7	4 2	13	1 4	43	49	39	4 2	410
Nr. i shtatzënave që kanë pranuar 1 vizitë gjatë shtatzënisë (Janë vizituar për herë të parë)	9	1 7	1 0	5	1 6	1 2	2	1 4	8	7	3	9	112
Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	4	5	4	4	1 1	4	0	1	5	2	0	2	42
Numri i familjeve Romë, Ashkali dhe Egjiptian që kanë	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1

pranuar të paktën një vizitë shtëpiake														
Numri i fëmijëve të referuar tek specialistet mjekësorë nga ekipi i mjekësisë familjare	0	1	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0	4	
Numri i infermiereve që janë duke i zbatuar vizitat në shtëpi	17	17	14	11	11	8	14	7	11	16	11	10	157	

Tabela Nr.7. Shërbimet e ofruara nga shërbimi i barnatores

Nr	Shërbimet	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
1	Nr.Pac.te furnizuar me insuline	567	573	576	567	598	536	549	564	566	585	510	560	6751
2	Nr.i pacientëve të ri në të iniciuar në insulinë	10	10	9	8	10	9	3	9	8	14	11	8	109
3	Nr.i pac. Qe kanë kaluar nga një lloj insuline në llojin tjetër	17	20	8	13	9	6	4	5	5	4	10	8	109
4	Nr.i pacientëve që kanë rritur dozën e insulinës	18	12	12	8	8	2	9	4	5	6	5	7	96
5	Nr i përgjithshëm i insulinave të shpërndara	4085	394	3994	3885	4066	3706	3601	4061	3966	3996	3443	3784	46534

6	Nr.i pacientëve të furnizuar me barna	132	439	252	245	155	195	173	184	154	50	104	151	2234
7	Nr i recetave të ekzekutuar	932	1537	996	1064	1123	872	194	605	811	686	655	715	10190
8	Nr i faktuarve hyrëse	1	1	4	2	3	4	4	3	2	6	4	13	47
9	Nr i faturave dalëse - furnizimi i qendrave dhe shërbimeve	16	34	29	15	30	21	17	13	26	26	49	61	337

Tabela nr.8 .Futja e fletëve kompjuterike sipas operatoreve

Operatore t	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Admir Jashari	1298	3030	1122	2440	2276	90	0	670	1489	2167	392	0	14974
Burbuqe Krasniqi	1541	2284	1080	630	1517	170	0	0	0	1582	785	1705	11294
Mevlyde Brestovci	806	2602	2594	1900	1949	319	280	256	987	2317	1731	2248	17989
Endrit Osmani	0	0	0	1138	2150	921	1623	3028	2639	3267	344	347	15457
Selvete Mahmuti	804	2421	1855	1662	1063	0	0	0	786	1768	1629	850	12838
Dardan Murtezi	1370	1061	1340	1030	1880	880	1461	2420	1732	2076	1520	220	16990
Ali Musliu	1666	2025	0	0	0	0	121	577	325	1647	2046	958	9365
Safete Salihu	706	2466	1999	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5171
Totali	8191	15889	9990	8800	10835	2380	3485	6951	7958	14824	8447	6328	104078

Cilësia e shërbimeve shëndetësore:

- Po bëhet në vazhdimësi monitorimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore nga ana e Koordinatorit për cilësi në të gjitha QMF-ët dhe shërbimet shëndetësore.
- Në bazë të programit të punës së Koordinatorit të Cilësisë po punohet në drejtim të plotësimit të planprogramit të paraparë në drejtim të punimit të auditeve të ndryshme në kudër të shërbimeve shëndetësore brenda QKMF-së.

Oendra e trajnimit të Mjekësisë Familjare

- Janë mbajtur sesionet klinike për specializantët e Mjekësisë Familjare
- Ka vazhduar bashkëpunimi me Spitalin Përgjithshëm të Gjilanit dhe IKSHP në Gjilan me qëllim që specializantët tanë një pjesë të stazhit të tyre specialistik të kryejnë në këto institucione.
- Specializimin në Mjekësi Familjare janë duke e vijuar 3 Specializant nga QKMF
- Janë mbajtur 18 ligjërata të rregullta për rifreskim profesional nga Mjekët me temat:
 - SPOK (sëmundjet obstruktive pulmonale kronike)
 - Kokë dhembjet
 - ITU (Infeksionet e traktit urinar)
 - RKP (Reanimimi Kardio Pulmonal)
 - -Gastritet
 - Konvulzionet Febrile
 - Faringjitet
 - Përdorimi i Aspirinës
 - Përdorimi i Algoritmit në Menaxhimin Sindromik të SST-së
 - Mbrojtja antitetanike në rast të lëndimeve
 - Diarretë.
 - Tumoret e Prostatës
 - Dhembjet e shpinës
 - Helyobacter pylori
 - Kontracepsioni
 - HTA
 - Pneumonia

Edukimi i vazhdueshëm profesional

- Në baza të ngritjes shëndetësore janë mbajtur ligjërata të Edukimit të vazhdueshëm profesional për Infermierët e të gjitha Qendrave të Mjekësisë Familjare, ku gjatë këtij viti janë realizuar 18 ligjërata nga Infermierët, me temat si në vijim:
 - Administrimi i medikamenteve
 - Kujdesi infermieror në veset e këqija
 - Kujdesi infermieror tek sëmundjet seksuale transmesive
 - Menaxhimi infermieror të angina pectoris

- Menaxhimi infermieror tek çrregullimet e Tiroides
- Menaxhimi Infermieror tek pacientët me diabet
- Emergjencat në KPSH
- Depresioni menaxhimi Infermieror
- Sterelizimi dhe Dezinfektimi
- Etika Infermiere
- Kalendari i Vaksinit
- Shoku anafilaktik –llojet e Shokut
- Gjdhënia
- Shëndetin oral
- Aktiviteti fizik gjatë shtatzënisë
- Ushqyerja gjatë Shtatzënisë
- Roli i infermieror në sigurinë dhe kujdesin e pacientëve
- Kujdesi infermieror tek pacientët obez
- Për implementimin e programit “ **Klasat për nënat** “ gjatë muajit dhjetor në QMF Dardani janë përfshirë 13 gra, ku janë dhënë vitaminat **Prental** të cilat janë donacion nga ARC-ja , njërit këtyre grave iu është matë TA –ja, pesha trupore dhe ju kanë dhënë këshilla rreth shtatzënisë dhe përgatitjes për lindje .

Edukimi në Komunitet

Në **muajin Janar** është bërë këshillimi i pacientëve në komunitet gjegjësisht nëpër ambulanca, me temën Kanceri i qafës së mitrës dhe sëmundjeve kronike si: diabeti, hipertensioni .

Në **muajin Shkurt** është bërë këshillimi i pacientëve në komunitet gjegjësisht nëpër ambulanca, me tema të ndryshme për sëmundje kronike.

Në **muajin Mars** është bërë këshillimi i pacientëve në komunitet gjegjësisht nëpër Qendra të Mjekësisë Familjare me ;

1. Dita ndërkombëtare e shëndetit oral
2. Dita botërore e TBC –së

Në muajin Prill

1. është bërë këshillimi i pacientëve me diabet dhe hipertension dhe sëmundje tjera në komunitet gjegjësisht nëpër QMF dhe AMF.

2. është mbajtur ligjëratë në Qendrën Didaktike me temë 'Menaxhimi i dhembjes tek fëmijët me prindër dhe edukatorë të çerdheve të qytetit.

Në **muajin Maj** , është mbajtur manifestimi për nderë të 12 Majit “Ditës së Infermierisë” ku është bërë këshillimi i pacientëve në komunitet gjegjësisht nëpër ambulanta me temën” ***Për një shëndet më të mirë***”

Gjithashtu më 31 Maj është mbajtur edhe një aktivitet për nderë të Ditës Botërore Kundër Duhanit.

Në **muajin Qershor** është mbajtur aktivitet për nderë të Ditës Ndërkombëtare Kundër Abuzimit të Drogave dhe një aktivitet në Qendrën Didaktike në Gjilan me temë “Dhënia e ndihmës së parë” me edukatorët e çerdheve të Qytetit.

Në muajin Shtator është mbajtur aktiviteti për Ditën Botërore të Zëmrës , ky aktivitet është realizuar në Qendër të Qytetit dhe janë shpërndarë fletëpalosje mbi vetëdijesim për kujdesin ndaj problemeve kardiovaskulare .

Në muajin Tetor është mbajtur aktiviteti për nderë të “Ditës botërore i luftës kundër kancerit të Gjirit “ me moton “ kanceri i gjirit mund të kurohet mjafton të zbulohet herët” Aktiviteti është realizuar në qendër të qytetit të Gjilanit nga grupi i EVP-së në bashkëpunim me koordinatoren e edukimit për regjion të Gjilanit Dr.Igballe Qerimi nga Instituti Kombëtar Gjilan. **Është** bërë shpërndarja me fletë palosjeve dhe i është dhënë informata secilit për rëndësinë e mamografisë e cila gjendet edhe në qytetin ton për të bërë zbulimin e hershëm të kancerit.

Në muajin Nëntor është kryer aktiviteti mbi këshillimin e pacientëve në komunitet për nderë të “ Ditës Botërore të Diabetit”. Aktiviteti është realizuar në Qendrën Tregtare “ VIVA FRESH STORE “ të Gjilanit nga grupi i EVP-së në bashkëpunim me koordinatoren e edukimit për regjion të Gjilanit Dr.Igballe Qerimi nga Instituti Kombëtar Gjilan. **Ku iu është bërë matja** e glikemisë të çdo qytetari të rastit që ka kaluar pranë nesh, qëllimi ishte zbulimi i rasteve të reja dhe nga 40 matje janë zbuluar 4 raste të reja me diabet .

Në muajin Dhjetor është kryer aktiviteti mbi këshillimin e pacientëve në komunitet për nderë të “ Ditës Botërore kundër AIDS ” . Aktiviteti është realizuar në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe është realizuar nga grupi i EVP-së, **ku janë këshilluar klientët për mbrojtje nga STS dhe ju kanë shpërndarë fletëpalosje mbi informimin e STS .**

9.Stazhi dhe praktika profesionale

- Gjatë këtij viti në QKMF”Dr.Nagip Rexhepi” kanë kryer stazhin 1 mujor 26 mjek , 1 biokimist , 3 psikolog dhe stazhin gjashtë mujor 2 stomatolog , gjithashtu stazhin gjashtë mujor e kanë kryer edhe 27 Infermier/e dhe 43 Infermier/e kanë mbajtur stazhin 3 mujor.
- Praktikën profesionale kanë mbajtur student nga kolegji Fama **33** Infermier/e, Kolegji UBT **17** Infermier/e dhe Kolegji AAB **10** Infermier/e.
- Nga shkolla e Mesme e Mjekësisë kanë përfunduar praktikën feriale gjithsejtë **45** Infermier /e .

Infrastruktura dhe pajisjet nga buxheti

Është ndërtuar Qendra e RE e Mjekësisë Familjare në fshatin Llashticë , ku është lëshuar në punë dhe ofrim të shërbimeve shëndetësore. Tani janë krijuar kushtet për punë më cilësore si për punëtorët shëndetësor ashtu edhe për pacientët e kësaj rrethine .

Është rrënuar aneksi në QMF Dardania i cili ka qenë i pa mirëmbajtur dhe pas djegies nga ana e njerëzve të pa përgjegjshëm (piroman) është intervenuar dhe është rrënuar . Është përmirësuar komplet hapësira ku nga ana e jashtme është lyer i tërë objekti i kësaj Qendre dhe është gjelbëruar duke llogaritur edhe rregullimin e murit rrethues

Në disa nga QMF-ët dhe AMF-të është intervenuar dhe është përmirësuar rrjeti i rrymës elektrike lidhur me defekte të cilat kanë qenë në to.

Gjithashtu nga Shërbimi Teknik është intervenua dhe janë rregullua të gjitha ato kaldaja të cilat qenë në defekt dhe janë funksionalizuar për nxemje në sezonin e dimrit.

Është rregulluar furnizimi me ujë në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dobërçan

Është përmirësuar furnizimi i ujit në QMF Pogragjë dhe në QMF Uglarë përpos intervenimeve tjera të nevojshme.

RAPORTI VJETOR I SHËRBIMEVE SOCIALE PËR VITIN 2019

Nr.	Kategoria e shfryt.	Nr.i rast.		Llojet e intervenimit	Rezultatet e arritura	Vërejtje
		Të vjetra	Të reja			
1	Shërbimet Rezidenciale					
1.1.	Kujdestaria për rastet e veçanta.	3		Me kërkesë të Gjykatës, caktohet kujdestari i përkohshëm për prezantim në seance gjyqësorë.		
1.2	Strehimi në shtëpi me bazë në komunitet.					
1.3	Strehimi i viktimave të dhunës në familje.	1		Vendosje e viktimës së bashku me fëmijët e sajë.		Bashkim vullnetar me familjen-bashkshortin
1.4	Strehimi i viktimave të trafikimit.					
1.5	Vendosja në institucione të mbrojtjes sociale Shtëpi të Pleqve Prishtinë			.Kërkesa të reja, Vizitë shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar ,vlerësimi i kërkesës,	Përcjellja e gjendjes së mosmarrëveshjeve përmes vizitave dhe konsultimeve	
1.6	Të trajtuarit e shëndetit mendor të kategorive të ndryshme.					
2	Shërbimet familjare					
2.1	Fëmijët e	1		Vizitë përcjellëse të rasteve		

	braktisur të porsalindur			të vjetra të vendosura në strehim familjarë, sesion këshillues individual familjarë.		
2.2	Fëmijët me sjellje asociale	23		Vizite shtëpiake, sesione këshilluese individuale familjare-raste te reja	Janë udhëzuar te ushtrojnë mbikëqyrjen prindërore ndaj fëmijës se tyre.	
2.3	Abuzimi seksual i të miturve jashtë familjes-prostitucion.	5				
2.4	Kujdestaria për të mitur					
2.5	Kujdestaria për të rritur.	4		Vizite përcjellëse ,sesione këshilluese individuale familjare,	Konsultime me palë ,familjar, përgatitja e raporteve,	Referuar për vitin 2019 janë gjithsej 10 raste.
2.6	Bashkimi familjar	3		Fëmijë i braktisur, nga spitali bashkohet me nënën biologjike.		
2.7	Kërkesa për Birësimi me element vendor	3		Kërkesë e re ne procedure te vlerësimit adoptim vendor,	Ne procedure te vlerësimit	
2.8	Birësimi me element ndërkombëtar			//////////////////////////////////// ////		
2.9	Strehimi në familjet farefisnore.	5		Vizite përcjellëse rasteve te vjetra ne strehim,	Vizite përcjellëse rasteve, sesione këshilluese individuale ,familjar, konsultime për rastet	
2.1	Fëmijët nën	12		Vizita familjare, sesione	Vlerësimi i	

	Kujdestari			këshilluese individuale, familjare ,konsultime për rastet,	kërkesës-caktimi i kujdestarit te përkohshëm-fëmijë jetim.	.Pushim i kujdestaris ë-bashkim me prindin biologjik.
2.1	Strehimi në familjet alternative.	1		Si rast urgjent vendoset ne familje strehuese alternative.		Totali 7 raste
2.1	Shërbime për ri integrimin e viktimave të trafikimit.					
2.1	Shërbime për viktima të dhunës në familje.	100		Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar, ndihme e përgjithshme për klientin,	Vazhdim i bashkëpunim it dhe kontakteve lidhur me rastin.	Përcjellja e rastit
2.1	Ndihmë në rregullimi e marrëdhënieve e bashkëshortor e.	13		Vizite shtëpiake-sesione këshilluese individuale, familjare, konsultime për rastin-rast ne procedure te vlerësimit	Vazhdimi i bashkëpunim it-procedure te shkurorëzimit -ndarjes.	Ne procedure
2.2	Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve.	9		Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar, dhënia e mendimit për besimin e fëmijës dhe lejimin e kontaktit prind fëmijë.	Ne pritje te aktvendimit.	
2.2	Dhënia e mendimit për martesë të të miturve.					
2.2	Persona me nevoja të veçanta.	8		I rritur me aftësi të kufizuar-referuar nga Gjykata		
2.2	Ndihmë në realizimin e kontakteve prind-fëmijë.					
2.2	Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer.					

2.2	Fëmijët me aftësi të kufizuara.	26		Pranimi, paraditja e dosjes për Komisioni Mjekësor.		
3	Shërbimet e komunitetit					
3.1	Fëmijët në punë	3		Vizite shtëpiake, sesion këshillues individual, familjar	Sesione këshilluese individuale, familjare, në procedure të tërheqjes së fëmijëve nga punët e rrezikshme,	
4	Bashkëpunim me institucionet Publike.					
4.1	Shërbime për fëmijë në konflikt me Ligjin.	74		Vizitë shtëpiake, sesion këshillues individual, familjarë	Sesion këshillues individual, familjar ,udhëzime për mos kryerjen e veprave dhe mbikëqyrjes prindërore, dërgimi i raportit social gjykatës	Raport për Gjykatë-Kundërvajtje, si dhe Masa Ok.
4.2	Prezantim në seanca Gjyqësore-Prokurori	89		.Prezantim në seance gjyqësore, për të mitur, dhunë në familje si dhe adoptime.		
4.3	Prezantim në Polici.	88		Pjesëmarrje në seance-intervistim në polici, të mitur,		
5	Shërbimet Tjera					
5.1.	Konsultim me palë	3693		Konsultime të ndryshme lidhur me rastet në QPS ,rastet e reja dhe atyre nën përcjellje-monitorim.		
5.2.	Vizita-familje, spital,	630		Vizitat shtëpiake, në institucione për rastet e reja, të vjetra dhe me kolege.		

	QSHM, OJQ- ët etj				
5.3	Vizita institucionale	6		Shtëpi të Pleqve Prishtine, SHI Kamenicë, Strehimore Liria ne Gjilan.	
6	Shërbimet Administrativ e				
6.1	Klient tjerë: Vërtetimet konstatimet zyrtare etj:	911		Klient tjerë, vërtetime, konstatime zyrtare etj.	
6.2	Shkollat- DKA	22		Raste të referimit- bashkëpunimit me shkollat.	
6.3	Futja e rasteve në bazën e të dhënave	1866		Futja e rasteve te reja ne bazën e të dhënave dhe shërbimeve e intervenimeve në rastet e vjetra.	Mbyllja e lendeve te vjetra që ka pushu arsyeja për të qenë aktivë.
6.4	DPSF- Prishtinë	124		Njoftime -Bashkëpunime	
6.5	Bashkëpunim me QSHM- QKMF, Psikiatrinë	20		Referim të rasteve me çrregullime mendore për trajtim.	
6.6	Bashkëpunim me Familjet strehuese	56		Bashkëpunim me familjet strehuese, konsultim për gjendjen e fëmijëve, pagesat etj.	
6.7	Bashkëpunim e me OJQ “Liria”-	9		Bashkëpunime	
6.8	Bashkëpunim me QPS	33		Kontaktime për çështje te adoptimit fëmijë-familje, referime problemet bashkëshortore.	
6.9	MVPT- Prishtinë			Konsultime lidhur me rastin social	
6.1	SOS Fshati Prishtinë	18		Vizite bashkëpunuese me SOS Fshatin e fëmijëve Prishtinë lidhur me dy familjet e vendosura .	
6.1	Takime ekipi vlerësues i DKA	3		Takime vlerësuese neper shkolla	

6.1	Furnizim i familjes Ilazi me ushqim	7		Furnizime		Kujdestari a bartet tek familjaret.
6.1	HHCH-Prishtine	3		Bashkëpunime.3 fëmijë te strehuar dhe është bërë bashkimi familjar.		
6.1	Komision mjekësor	2		Totali 24 raste, prej tyre 12 të refuzuara,3 me plotësim,7 të aprovuara.		
6.2	Seminar	14		1Modeli Kosovar i trajtimit të rasteve të fëmijëve në rrezik dhe atyre që kanë rënë ndesh me ligjin” 2. Identifikimi dhe trajtimi i rasteve të përfshira në konflikte në Siri dhe Irak		
6.2	TMR	2				
6.2	Bashkëpunim e me Gjykatën	4		Shkresa gjykatës për rastet pa adrese.		
0	Bashkëpunim e me Prokurorinë	25		Raporte prokurorisë sipas kërkesës së Prokurorisë për VDH		
1	Transferi i lëndëve të Skender Halimit 48 raste			48 lende janë transferuar te Z.SH.S tjerë, pasi i njëjti ka dal në pension.		

VII. DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2019, DUPMM ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë duke u bazuar në përshkrimin e punëve dhe detyrave punuese të secilit sektorë duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi si dhe rregulloret komunale.

Duhet potencuar se gatishmëria dhe kërkesa e qytetarëve ka pësuar një ngritje të lehtë për t’u pajisur me kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Interesimi në aspektin e ndërtimit dhe planifikimit nga ana e qytetarëve të Gjilanit prapë nuk ka munguar duke iu nënshtruar procedurave për t’u pajisur me marrjen dokumentacion të ndërtimit. Ky aktivitetet reflekton në të hyrat e Drejtorisë por edhe në ruajtjen e hapësirave të planifikuara. Po ashtu në bashkëpunim me MMPH ka filluar edhe faza e legalizimit të objekteve të të gjitha kategorive në tërë zonën e qytetit.

Shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve të cilat drejtohen e parashtrihen në këtë institucion publik bëhet konform ligjit dhe me efikasitet të plotë në afatin ligjor të përcaktuar.

Përkushtimi i punës në DUPMM nga ana e zyrtarëve përgjegjës në kuadër të sektorëve sipas përshkrimit të detyrave të tyre është në nivelin e kërkuar.

DUPMM-ja është në fazën e përfundimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) si dhe ka përfunduar draftin final të PZhK-së. Pas përfundimit edhe të punëtorisë së organizuar me të gjithë sektorët e brendshëm, kompanitë publike, shoqërinë civile, ndërtuesit dhe ekspertët e jashtëm kemi arrit të bëjmë draftin final dhe tani procedurat e mëtutjeshme me MMPH dhe aprovimin në kuvend. Gjatë kësaj kohe janë organizuar debate në të gjitha zonat e qytetit së bashku me fshatrat. Janë mbajtur mbi 23 debate dhe shumë takime me njerëz profesionistë të fushave të ndryshme. Vlen të ceket që pjesëmarrja masive në debate ka reflektuar dukshëm në përpilimin e kësaj strategjie duke na ofruar ide dhe eksperiencë nga më të ndryshmet. Për herë të parë PZhK është hartuar në bashkëpunim edhe me komunitetet si pjesë integruese e qytetit.

Në vazhdimësi të punës së kësaj strategjie jemi përkujdesur për punët paralele të hartimit të zonave të komunës- është zhvilluar prokurimi dhe punimi i VSM-së, diskutimi publik i mbajtur etj.. HZK është pjesa detajuese ku në të cilën do të jenë në mënyrë specifike kushtet për zhvillimin e mëtutjeshëm si për ndërtim, infrastrukturë, ekonomi, kulturë, trashëgimi dhe në të gjitha sferat përkatëse të komunës dhe rrethinës së KK Gjilan. Vlen të theksohet që kushtet ndërtimore do të jepen edhe në zonat rurale dhe në këtë mënyrë do të përkujdesemi për ndërtimet ekzistuese dhe ndërtimin e mëtutjeshëm. Po ashtu edhe për këtë strategji është hapur tenderi i VSM-së.

Sipas analizave, parametrave ekzistues, trendi të ndërtimit dhe hapësirës së territorit të komunës sonë kapacitetet janë deri në arritjen e 240 mijë banorëve.

Stafi përgjegjës për Legalizimin e objekteve ka filluar punën pas aprovimit të udhëzimeve administrative të cilat janë në mbështetje të ligjit për legalizim të objekteve pa leje. Tani kemi edhe lejet e para të lëshuara për legalizim dhe certifikatat e tyre.

Aktivitetet e ndërmarra gjatë kësaj periudhe kohore:

SEKTORI I PLANIFIKIMIT

Aktivitetet e sektorit janë të listuara si më poshtë

Në bashkëpunim me zyrën e prokurimit kemi arritur të shpallim konkurset për projektet e tri parqeve që në total kapin sipërfaqe prej 14 hektarë.

Hartimi i projektit për parkun e qytetit “Parku i Paqes, Parku Baja dhe Parku i Pajtimit” në Gllamë të Bresalcit– përfunduar. Menjëherë fillon implementimi i tyre.

Implementimi i Projektit të gjelbërimit të “Kodra e Dëshmorëve “- i përfunduar. Tani ka mbetur faza finale si parkingjet dhe ndriçimi. Projekti në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë.

Hartimi i projektit ideor për objektin e Administratës së përgjithshme të drejtorive Komunale dhe kuvendit. Projekti kryesor do të vazhdojë me kompaninë e kontraktuar për projektim.

Përpilimi i detyrës projektues për “Hartimi i projekteve ideore dhe kryesore për nevoja të Komunës së Gjilanit“– i përfunduar

Projekti i “Palestrës së Sporteve” në Zhegër- faza në implementim e sipër- përcjella e punimeve. Shenjëzimi te “Varrezat e qytetit sipas përkatësisë së besimit”- vendosja e gurëve sipas modelit të propozuar.

Projekti i “Shenjzimit të rrugëve” në KK Gjilan- Përfunduar po ashtu edhe komisioni për shqyrtimin e ankesave. Projekti i përbashkët me Agjencionin Kadastral të Kosovës dhe Autoritetin Norvegjez të Hartave.

Projekti i instalimit të “Citylights dhe Billboardeve” në rrugët e qytetit- Dizajni i përfunduar dhe pritet të shpallet në ankand publik.

Përcjellja e punimeve dhe mbledhja e raporteve gjatë implementimit të masave të “Eficiencës së Energjisë” dhe përcjellja e strategjisë për Energji të Qëndrueshme në bashkëpunim me DZhE. Në bashkëpunim me këtë drejtori është duke u bërë auditimi i pesë objekteve arsimore.

Hartimi i planit të studimit të fizibilitetit për “Instalimin e gazit natyror” në qytet. Kompania konsulente e përzgjedhur dhe studimi në përpunim e sipër. Projekti i parë në territorin e Kosovës dhe bëhet në bashkëpunim me DZhE.

Zona e lirë ekonomike- lokacioni i përcaktuar- në hapësirën në mes Stanishorit dhe Kufcës dhe ka sipërfaqe prej 52 ha. Zona ka karakter ndër komunal dhe ndërshtetëror prej 13 komunave apo tri shteteve. Procedim në dy kuvendet përkatëse.

Revidimi i projektit të varrezave të qytetit i përfunduar- Pritet fillimi i hapjes së rrugëve brenda kompleksit. Në projekt janë paraparë edhe objektet për rite të ndryshme me të gjitha pjesët përcjellëse. Zgjidhja e problemit të varrezave është bërë së paku 70 vjet.

Tregu i kafshëve- lokacioni i përcaktuar në Velekincë në pjesën kah Livoqi i Poshtëm. Projekti kryesor i përfunduar. Granti i siguruar në bashkëpunim me DZhE dhe DBP.

Salla e kulturës në Përlepnicë- projekti i përfunduar dhe rinovuar në tërësi. Janë bërë renovime thelbësore dhe është rinovuar në masën më të mirë duke përfshirë edhe ulëset në sallën e auditoriumit. Lëvizja e pllakës përkujtimore në murin e objektit- të zanafillës së rezistencës së madhe.

Caktimi i lokacionit për objektin e agjencisë së ushqimit dhe veterinarisë- AUV, ndërsa ky objekt parashihet të implementohet nga Komisioni Evropian. Ky objekt do të ketë karakter rajonal dhe do të shërbejë për tërë zonën. Lokacioni i ri është përcaktuar në pronën që është në shfrytëzim nga konvikti turk. Nga kjo parcelë do të ndahen 15 ari për këtë qëllim.

Përfundimi i punimeve rreth shtatoreve të Mulla Idriz Gjilanit dhe Agim Ramadanit (rregullimi i platosë para teatrit në bashkëpunim me këshillin e fshatit Zhegër, OVL dhe MM. Inaugurimi i tyre i bërë me rastin e festës së 28 Nëntorit.

Po ashtu është ndarë edhe lokacioni për shtatoren e heroit të kombit “Abdullah Tahirit” si dhe prokurimi është kryer. Është caktuar edhe përfituesi dhe punimet do të përfundojnë të përcjellura me inaugurim më 17 Shkurt 2020. Më herët janë ndarë lokacionet edhe për bustet e Ibrahim Rugovës, Sylë Zarbincës e Tefik & Hanumshahe Zymberi.

Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për intervenim në shtratin e lumit në Cërrnicë dhe mbrojtja e tokave bujqësore. Granti i siguruar nga BE në bashkëpunim me zyrën konsulentë të KK.

Hartimi i projektit ideor dhe kryesor për intervenim në objektin e shkollës së muzikës dhe ridestnimi i saj në muzeun etnografik. Granti i siguruar nga BE në bashkëpunim me zyrën konsulentë të KK.

Hartimi i planit të studimit për strategjinë e “Mbrojtjes së ajrit nga ndotja” në territorin e qytetit dhe regjionit. Përgatitja e termave të referencës.

Planifikimi/ krijimi i qendrës për “Shërbim në një vend” për pajisje me dokumentacion ndërtimi. Projekti i përbashkët me drejtorinë e Administratës dhe kompanive publike në Gjilan. Pasi të bëhet elektronizimi i dokumentacionit/ hartave dhe PRrU- ve krijohet mundësia për funksionalizimin e kësaj qendre.

Vlerësimi i punimeve të kryera në disa objekte, prerja e punimeve apo procese përfundimtare.

Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale e Komunës

Takime konsultative me drejtorët e Drejtorive lidhur me hapat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë gjatë procesit të hartimit të PZhK-së

Takime konsultative me Ekipin Bazë (EB) dhe Ekipin Komunal të Planifikimit (EP) lidhur me hapat, rolin, detyrat dhe përgjegjësitë gjatë hartimit të procesit të PZhK-së

Takime konsultative të Ekipit Bazë (EB) dhe Kompanisë INSI- Prishtinë me drejtoritë Komunale dhe Kompanitë Publike të Komunës së Gjilanit

Shpërndarja e dokumentacionit të Raportit Sektorial të bazuar në Udhëzimin Administrativ për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës nëpër drejtoritë Komunale dhe Kompanive Publike të Komunës së Gjilanit

Përmbledhja e Raporteve Sektoriale nga drejtoritë Komunale dhe Kompanive Publike si dhe shqyrtimi dhe analizimi i tyre nga Ekipi Bazë (EB)

Mbajtja e takimit me Ekipin Bazë (EB) dhe Ekipin Komunal të Planifikimit (EKP) lidhur me të arriturat, sfidat e paraqitura dhe paqartësitë lidhur me dokumentin e pranuar "Raporti dhe strategjia sektoriale" për drejtoritë dhe Kompanitë e Huaja.

Takim i përbashkët me Ekipin Bazë (EB), përfaqësuesin e Kompanisë konsulente INSI dhe GIZ lidhur me harmonizimin e aktiviteteve punuese bazuar në Planet e Veprimeve të dy dokumenteve gjatë procesit për hartimin e tyre Planin Zhvillimor Komunal (PZhK) dhe Hartën Zonale të Komunës (HZK).

Mbikëqyrjet, Menaxhimet, Komisionet dhe Pranimet Teknike

Mbikëqyrje e punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës

Menaxhimi i punëve sipas projekteve kapitale në kuadër të komunës

Mbikëqyrje e procesit të Planeve Rregulluese të Hollësishme

Komisionit Ad hoc për zhvillimin e procedurave të emërimit me afat të caktuar– marrëveshje për shërbime të veçanta

Pranim teknik të projekteve të implementuara nga KK Gjilan.

Aktivitete tjera

Shqyrtimi i pikave grumbulluese të mbeturinave në KK Gjilan

Azhurnimi dhe mirëmbajtja e platformes GIS.

SEKTORI I LEJEVE TË NDËRTIMIT

Aktivitet të cilat janë kryer deri më Dhjetor 2019

Llojet e kërkesave:

Kërkesa për Ekstrakt nga Plani, kërkesa për parcelim të truallit, kërkesa për objekt të karakterit të përkohshëm të tipit montues, kërkesa për kushte ndërtimi, kërkesa për rekonstruim, aneks ndërtim, shtim, mbindërtim, e forma të tjera të ndërhyrjeve në ndërtesat ekzistuese

Kërkesa për leje paraprake, kërkesa për leje ndërtimi, kërkesa për kontrollim teknik- leje të përdorimit, kërkesa për ndërtim të objekteve të përkohshme– ndihmëse, në vend ndërtim. (Objektet e përkohshme– ndihmëse në vend ndërtim kërkojnë leje të veçantë nëse e cenojnë shëndetin e njerëzve, trafikun– qarkullimin dhe mjedisin si në rastet e mëposhtme): kërkesa për leje rrënimi- demolime të objekteve, kërkesa për vlerësim dhe konstatim të gjendjes së objektit.

Kërkesa për ndërtim të objekteve të Infrastrukturës komunale (rrugë, ura, hapësira gjelbëruese, hapësira për sport dhe rekreacion, rrjet të energjisë, ujësjellësit, kanalizimit, ndriçimit publik, PTK dhe përçuesve tjerë;

Pranimi i kërkesave: Kushtet e Ndërtimit 153, Leje Ndërtimi 153, Parcelime të truallit 318, Lajmërimet 31, Pranime teknike 9, Leje Rrënimi 32, Leje mjedisore __, Ankesa 45, Raportet periodike, Gjithsejtë 817

Prej tyre janë shqyrtuar mbi 700 lëndë ndërsa janë në shqyrtim e sipër 117 lëndë.

Të dhënat financiare për DUPMM (në këtë periudhë janë inkasuar), nga lejet ndërtimore 700,713.40 euro, të hyrat nga Taksat- Kërkesat 3,935.00 euro, të hyrat nga Lejet mjedisore 57,041.00 euro dhe të hyrat nga legalizimi 44,012.92 euro. Gjithsejtë të hyrat deri në këtë periudhë arrijnë vlerën prej 805,702.32 euro.

VIII. DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Inspektorët dhe zyrtarët e Drejtorisë së Inspeksionit përveç që kanë detyrat e përditshme si në sektorin juridik, sektorin e ndërtimit dhe ambientit, sektorin e shërbimeve publike dhe komunikacionit si dhe në sektorin e veterinarisë, sanitarisë dhe bujqësisë janë marrë edhe me rastet e natyrës urgjente. Këtë vit duke pasur parasysh gjendjen e ujit të pijshëm si dhe në bazë të urdhërësë së lëshuar nga Kryetari i Komunës z. Lutfi Haziri janë organizuar edhe kujdestaritë nga fundi i muajit qershor 2019 e deri në fillim të muajit nëntor 2019 ku kanë marrë pjesë të gjithë inspektorët. Kujdestaritë janë mbajtur çdo ditë të punës prej orës 17 deri në ora 23 si dhe ditëve të vikendit (e shtune dhe e diele) dhe ditëve të festave duke filluar nga ora 7 deri në 24. Gjatë këtyre kujdestarive përveç me parandalimin e keq përdorimit të ujit të pijshëm inspektorët janë marrë edhe me parandalimin e zhurmës si dhe janë marrë me inspektimin e rasteve urgjente pa marrë parasysh se cilës sferë i përkasin.

Në sferën e ndërtimit është bërë: inspektimi i rasteve në proces të ndërtimit, ndërprerja e punimeve ndërtimore, shiritimi i objekteve, dorëzimi i vendimeve për ndërprerje të punëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve, iniciimi i procedurave gjyqësore për kundërvajtje, nxjerrja e vendimeve për rrënim, etj..

Në sferën e tregut është bërë: identifikimi i bizneseve të cilat nuk janë të rexhustruara në M.T.I-së, identifikimi i bizneseve të cilat nuk kanë pranim teknik të lokalit, zbatimi i udhëzimit për vendosje të flamujve të shteteve që tregon origjinën e çdo produkti, etj..

Në sferën e shërbimeve publike, komunikacionit dhe ambientit është bërë: inspektimi i hapësirave publike, inspektimi i trotuareve, inspektimi i auto larjeve, inspektimi i hedhjeve të mbeturinave jashtë kontejnerëve, inspektimi i bartjes publike të udhëtarëve me autobus, me taksi, inspektimi i transportit të mallrave, inspektimi i sinjalizimit, inspektimin e parkimeve të veturave taksi, inspektimi dhe vëzhgimi i problemeve që kanë me hedhjen e mbeturinave, inspektimi dhe djegia e mbeturinave, inspektimi dhe djegia e thëngjillit, inspektimi i pikave grumbulluese të metaleve, inspektimi i ndotjes akustike, etj.

Në sferën e veterinës, bujqësisë dhe sanitarisë është bërë: kontrollimi i therjeve të kafshëve në thertore të licencuara, inspektimi i mishtoreve, fabrikave për përpunimin e mishit, thertoreve të shpezëve, industrive të përpunimit të qumështit, inspektimi i subjekteve afariste ushqimore, inspektimi i afatshmërisë së artikujve ushqimor me prejardhje bimore dhe shtazore, inspektimi i kushteve higjieniko-sanitare, inspektimi i furrave të bukës, inspektimi i restoranteve, hoteleve, qebaptoreve, gjellëtoreve dhe lokalet e ushqimeve të shpejta, inspektimi i institucioneve parashkollore dhe shkollore (*kushtet higjieniko-sanitare*), etj..

Inspeksioni i ndërtimit

Bazuar në Ligjin Nr.04/L-175 për Inspektoratin Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit; Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor; Ligjin Nr.04/L-110 të Ndërtimit; si dhe udhëzimeve administrative Nr.18/2013; Nr.20/2013 si dhe udhëzimeve tjera, sektori i inspeksionit Ndërtimor gjatë kësaj faze ka kryer këto detyra pune:

Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e sektorit të inspeksionit të Ndërtimit, gjatë kësaj faze (12 mujori-2019), janë kryer këto punë: Inspektim të rasteve në proces të ndërtimit, hartim të procesverbaleve-ndërprerje të punimeve ndërtimore, hartim të procesverbaleve – shiritim të objekteve, dorëzim të vendimeve për ndërprerje të punëve, pranim-shqyrtim të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, shqiptim i gjobave ndaj kundërvajtësve, inicim te procedurave gjyqësore për kundërvajtje, vendime për rrënim si dhe pranimin-evidencimin dhe kontrollimin e Lejeve Ndërtimore të pranuar nga sektori i lejeve.

Gjatë kësaj faze - (12 mujori/2019), në sektorin e inspeksionit janë kryer këto punë:

Nr.	Përshkrimi i punës	Numri
1.	Procesverbale	137
2.	Procesverbale për ndërprerje të punimeve	50
3.	Aktvendime për ndërprerje të punëve	48
4.	Inspektim i objekteve me leje ndërtimi	23
5.	Procesverbale për ndërprerje të punëve tejkalim i Lejeve Ndërtimore	46
6.	Përgjigje ndaj kërkesave për insp të punimeve ndërtimore	293

7.	Përgjigje ndaj ankesave të qytetarëve	23
8.	Gjoha mandatore	33 (€)
9.	Vendime për Rrënim	9
10.	Konkluzione për Rrënim	2
11.	Numri i Lejeve Ndërtimore të pranuar nga DUPMM	123
12.	Rrënimi i ish objektit të "Hidromoravës" afër lumit "Stanishorka"	1
13.	Rrënimi i shtëpive mbi lumin "Stanishorka"	1
14.	Rrënimi i shtëpive të ndërtuara në hapësirë publike në Zabelin e Sahit Agës	2
15.	Rrënimi i dy objekteve publike të vjetruara në fshatin Zhegër	1

Inspeksioni i tregut

Nga Janari i vitit 2019 jemi marrë me bizneset të cilat nuk janë të rexhistruara në M.T.I-së, po ashtu biznese të cilat nuk kanë pranim teknik të lokalit.

Po ashtu e kemi zbatuar udhëzimin të ardhur nga Ministria e Tregëtisë për vendosje të flamujve të shteteve që tregon origjinën e çdo produkti, ku kemi vizituar biznese dhe kemi hartuar procesverbale secilit biznes për zbatimin e urdhëresës nga Ministria e Tregëtisë.

Kemi mbajtur kujdestari gjatë verës për zbatimin e urdhëresës së Kryetarit për mos keqpërdorim të ujit të pijshëm në hapësira publike dhe kundër zhurmave të natës të shkaktuara nga kafiteritë.

Ju kemi përgjigjur policisë së Kosovës kur kanë pas nevojë për bashkpunim me inspektorët e Tregëtisë.

Nr.	Numri i:	
1.	Inspektime pa procesverbale	800
2.	Inspektim me Procesverbale	671
3.	Aksion me Policien e Kosovës	0
4.	Shuma e parave nga pranimet teknike	19,560.00 €
5.	Shuma e parave nga gjobat mandatore të paguara	0
6.	Kërkesave të refuzime te pranimeve teknike	0
7.	Shuma e refuzime të pranimeve teknike	0
8.	Numri i gjobave mandatore	0
9.	Aksioneve me Policinë e Kosovës	7
10.	Procesverbaleve të pranimeve teknike	205
11.	Lëndë për Gjykat	0
12.	Lokaleve të mbyllura	0

13.	Përgjigje në kërkes	7
14.	Kërkesave për vazhdim të orarit të punës	0
15.	Aktvendime të pranimeve teknike	205

Inspeksioni i Shërbimeve Publike, Komunikacionit dhe i Ambientit

Inspektorët e shërbimeve publike- në këtë periudhë një vjeçare janë marrë me inspektimin e hapësirave publike, inspektimin e trotuareve, inspektimin e auto larjeve, inspektimin e hedhjeve të mbeturinave jashtë kontejnerëve, etj. Kemi bashkëpunuar me kompanitë siç janë “Hidromorava”, “Ecohigjiena”, “PTK”, “KEDS” etj. Kanë qenë pjesë e komisioneve për projekte të vogla, kanë qenë pjesë e komisioneve për vlerësimin e tenderëve, e komisioneve për mbikëqyrje të punimeve, etj. Është bërë largimi i tavolinave nga sheshi, largimi i frigoriferëve, largimi i reklamave politike, etj..

Inspektorët e komunikacionit -në këtë periudhë një vjeçare janë marrë me inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve me autobus, me taksì, me inspektimin e transportit të mallrave, me inspektimin e sinjalizimit si dhe me inspektimin e parkimeve të veturave taksì. Kanë bashkëpunuar me Njësinë e Policisë së Trafikut Regjional për të organizuar inspektime për kontrollin e bartjes publike të udhëtarëve nga operatorët legal dhe ilegal si dhe për transport të mallrave. Po ashtu kanë bashkëpunuar edhe me inspektorët e tregut për inspektimin e transportit të mallrave. Kanë qenë pjesë e komisioneve për projekte të vogla, pjesë e komisionit për performancë komunale, pjesë e komisionit për vlerësime të tenderëve, pjesë e komisioneve për mbikëqyrje të punimeve, pjesë e komisionit për PZHU, pjesë e komisionit për vendosjen e tabelave për emërimin e rrugëve (Agjensioni Kadastral i Kosovës), pjesë e komisionit për riorganizimin e rrugëve në Komunën e Gjilanit, etj.

Inspeksioni i Mbrojtjes së Mjedisit - gjatë periudhës Tetor – Dhjetor (01.10.2019-13.12.2019), Inspektorët e Mbrojtjes së Mjedisit janë marrë me inspektimin dhe vëzhgimin e problemeve që kanë me hedhjen e mbeturinave, djegia e mbeturinave, djegia e thëngjillit, pikat grumbulluese të metaleve, ndotja akustike, etj. për të cilat pas inspektimit në terren kemi lëshuar edhe aktet e nevojshme normative (përgjigje, vendime, gjoba etj), si dhe identifikimin e objekteve për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale. Është bërë monitorimi i deponisë regjionale në fshatin Velekincë dhe asaj inerte në fshatin Kmetoc. Konstatim mbi shfrytëzimin e lëndës djegëse për ngrohje në institucionet edukativo-arsimore dhe institucioneve tjera publike. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi qenë të angazhuar edhe në orët shtesë – kujdestaritë për arsye të ndotjes akustike (zhurmës). Përveç inspektimeve, vëzhgimeve dhe shqyrtimeve të ankesave janë organizuar takime dhe aktivitete të tjera: Takim me përfaqësuesit e kompanisë regjionale të mbeturinave “Eco Higjiena”, Policisë së Kosovës, me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Monitorim i deponisë për hedhje të mbeturinave inerte në fshatin Kmetoc.

Të gjithë inspektorët kanë bashkëpunuar:

- në inspektimin e hapësirave publike
- në inspektimin e bartjes publike të udhëtarëve dhe të transportit

- në inspektimin e objekteve të cilat duhet të pajisen me Leje Mjedisore,
- në inspektim e lokalet afariste për përmbushjen e kushteve teknike
- në shqyrtimin e kërkesave të palëve

Raporti detal për inspeksionin e shërbimeve publike, komunikacionit dhe për ambient është:

Nr.	Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre	
1.	Numri i inspektimeve	
2.	Numri i procesverbaleve	329
3.	Numri i kundërvajtjeve	08
4.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara	27 (1,840.00 €)
5.	Numri i automjeteve të përjashtuara nga komunikacioni	09
6.	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	21
7.	Numri i taksive që janë pajisur me leje pas vërejtjes së dhënë	06
8.	Numri i lejeve për shfrytëzim të hapësirës publike	42
9.	Numri i lejeve mjedisore	21
10.	Numri i kërkesave të pranuar	64
11.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	61
12.	Numri i kërkesave të cilat janë në shqyrtim	03

Inspeksioni i veterinarisë, sanitarisë dhe bujqësisë

Duke u bazuar në planin e hartuar për vitin 2019 në fokus kemi pasur :inspektimin e subjekteve afariste ushqimore, afatshmërinë e artikujve ushqimor me prejardhje bimore dhe shtazore, kushtet higjieniko-sanitare, kushtet e ruajtjes së artikujve për konsum të përditshëm, kontrollimi i therjeve të kafshëve në thertore të licencuara, e më pas është bërë damkosja e mishit dhe lejimi i tij për konsum publik, inspektimi i mishtoreve, fabrikave për përpunimin e mishit, thertoreve të shpezëve, industrive të përpunimit të qumështit, pikat shitëse të vezëve të freskëta, inspektimi i furrave të bukës, pjekurinave dhe ëmbëltoveve, inspektimi i restoranteve, hoteleve, qebaptoreve, gjellëtove dhe lokalet e ushqimeve të shpejta, inspektimi i institucioneve parashkollore dhe shkollore (*kushtet higjienike-sanitare*). Me kërkesë të institucioneve shëndetësore private,

barnatoreve, institucioneve shkollore private janë inspektuar dhe lëshuar pëlqimet sanitare nga ky sektor për licencim nga Ministria e Shëndetësisë përkatësisht Ministrisë së Arsimit.

Stafi ynë ka marrë pjesë në komisione të ndryshme: monitorimi i procesit të dezinfektimit hapësinor si dhe dezinfektimi i institucioneve arsimore (parashkollore dhe shkollore), komisione për vlerësimin e ofertave, monitorimin e shpërndarjes së derivateve të naftës për institucione publike dhe aktivitete të tjera në interes të Komunës.

Në vijim është bërë paraqitja tabelare e aktiviteteve të realizuara:

Natyra e punës	Numri	Vërejtje
Kontrollime-Inspektime	291	
Procesverbale	247	
Dënime	/	
Therje të kafshëve	1397	6,131.00 €
Transport të kafshëve	118	118.00 €
Përgjigje kërkesave të qytetarëve	40	
Asistencë-pjesëmarrje me Insp.e Tregut. Inspektorët AUV-it dhe Shërbimeve Publike	79	
Pëlqime sanitare	65	650.00 €
Pjesëmarrje në pranime teknike të lokaleve afariste	131	
Kujdestari	82	
Shuma e taksa të grumbulluara	Totali:	6,899.00 €

Taksat e grumbulluara nga transporti i kafshëve shkojnë në xhirollogarinë e Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinës.

Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit

Në këtë periudhë një vjeçare (janar -15 dhjetor 2019) zyrtari për mbrojtjen e konsumatorit është marrë me ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme si për dëmtim të gomave të automjeteve, dëmtim të aparateve të ndryshme shtëpiake (friz, lavatriçe), dëmtim të telefonit mobil, për mos funksionim të pjesës rezervë të inkubatorit, ankesa për gjëra ushqimore të prishura por të cilat kanë qenë me afat (supa, sallame, file pule, reçel, jogurt, suxhuk, etj.), ankesë për çmime, ankesë ndaj bankës për pagesa të mirëmbajtjes, ankesë ndaj një operatori të TV kabllorike dhe internetit për mos largim nga para pagimi edhe pas ç' lajmërimit, etj..

Zyrtari për mbrojtjen e konsumatorit në bashkëpunim me inspektorët komunal të tregut dhe sanitar, Ju kanë përgjigjur ankesave të palëve me shkrim dhe verbalisht.

Raporti detal për zyrën e konsumatorit është:

Nr.	Aktiviteti, masat e ndërmarra dhe numri i tyre	
1.	Numri i inspektimeve	41
2.	Numri i procesverbaleve	13
3.	Numri i kërkesave të pranuar	15
4.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	15
5.	Numri i kërkesave të cilat janë në shqyrtim	0
6.	Numri i gjobave mandatore	1

Nr.	Aktiviteti	Numri	Shuma €
1.	Numri i procesverbaleve	1348	
2.	Numri i kundërvajtjeve	08	
3.	Numri i gjobave mandatore të shqiptuara	60	
4.	Numri i automjeteve të përjashtuara nga komunikacioni	09	
5.	Numri i aksioneve me Policinë e Kosovës	28	
6.	Numri i kërkesave të pranuar	1042	
7.	Numri i kërkesave të shqyrtuara	1023	
8.	Numri i kërkesave të në shqyrtim	19	
9.	Numri i kërkesave të refuzuara	4	
10.	Numri i kujdestarive të mbajtura - ditë kalendarike	135	
11.	Numri i aktvendimeve të lëshuara nga Drejtoria e Inspeksionit	244	
12.	Numri i vendimeve të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit	40	
13.	Numri i konkluzave të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit- rrënimi i objekteve publike	13	
14.	Numri i autorizimeve të nxjerra nga Drejtoria e Inspeksionit	12	
15.	Numri i kërkesave të Drejtorisë së Inspeksionit	42	
16.	Numri i lejeve ndërtimore	123	
17.	Totali i të hyrave në Drejtorinë e Inspeksionit		28,299.00 €

IX. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës dymbëdhjetë mujore ka kryer këto punë:

- Pasqyrat vjetore 2018 për MF,
- Raportin final financiar 2018 për Kuvend ,
- Raportin financiar tremujorit të parë për Kuvend
- Raporti financiar gjashtë mujor për kuvend
- Kornizën afatmesme buxhetore 2020-2022
- Rrjedhën e parasë (plani i keshit) për të gjitha njësit buxhetore dhe gjitha kategoritë ekonomike
- Shpërndarja e mjeteve të bartura nga viti 2018
- Formimi i dokumentacioni për kode të projekteve dhe alokimin e tyre nga MF
- Analiza e alokimeve buxhetore si p.sh. raporti i alokimeve për Paga& Mëditje, Mallra & Shërbime, Komunali, Investime Kapitale dhe Subvencione.
- Kemi punua nënlokimet mujore për Paga& Mëditje ,Mallra& Shërbime dhe Komunali për çerdhet, arsimin fillor dhe të mesëm (analitikë për çdo çerdhe, konvikt dhe shkollë).
- Analiza e Paga& Mëditje për të gjitha programet buxhetore.
- Formimin e dokumentacionit nga participimet dhe donacionet për rritje të buxhetit dhe alokimin e mjeteve.
- Bashkëpunimi i ngushtë me auditorët si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm
- Pranimi i të gjitha raporteve të të hyrave nga BQK
- Përpunimi i të gjitha të hyrat sipas kodeve dhe drejtorive.
- Regjistrimi i te gjitha të hyrat në akses.
- Regjistrimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve në SIMFK.
- Përgatisim për të gjitha drejtoritë informata mujore si për hyra ashtu edhe për shpenzime
- Bëjmë barazime ditore me BQK dhe bankat komerciale.
- Barazime mujore me MF-Thesar
- Barazime tre mujore me MF, zyrën e alokimeve.
- Përgatisim në baza ditore raporte për të hyrat për secilën drejtori.
- Përgatisim UNIREF-at për të gjitha faturat e drejtorive
- Mbajmë evidencë analitike për çdo lloj të hyre .
- Mbajmë evidencë analitike për të gjitha shpenzimet me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i mbajnë vet .
- Shtypim listat e pagave të dërguara nga Menaxheri i zyrës Personelit i dërgojmë për verifikim nga drejtorët përgjegjës dhe nënshkruhen nga shërbyesit civilë me përjashtim të Drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë të cilët i kryejnë vet.
- Gjatë kësaj periudhe kemi:
 - Lëndë të zotuarra 6600
 - Lëndë të shpenzuara 6540
 - Lëndë të certifikuarra dhe arkivuara 6443
- Kemi bërë shpërndarjen e faturave të Tatimit në Pronë (27152 fatura)

- Gjatë punës vjetore bëjmë shtypen e faturave të Tatimit në Pronë me kërkesë të tatimpaguesve dhe lëshojmë vërtetime të ndryshme .
 - Janë regjistruar 1120 objekte të reja.
Janë verifikuar afro 5797 objekte ekzistuese
 - Në këtë periudhë kemi pranuar dhe shqyrtuar të gjitha ankesat e qytetarëve
 - Përcjellim regjistrimin dhe transferet e inventarit
- Për periudhën dymbëdhjetë mujore(12) kemi këtë gjendje të të hyrave dhe shpenzimeve në DBF.

Të hyrat e Tatimit në Pronë

	Planifikimi 2019	Realizimi i të hyrave Janar- Dhjetor 2018	Realizimi i të hyrave Janar Dhjetor 2019	Krahasimi mes realizimit 2018 dhe 2019	% në mes planifikimit dhe realizimit 2019
Të hyrat nga tatimi në Pronë	1,440 000.00	1,412 114.62	1,651 323.48	116.94	114.680

Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka shpenzuar:

-Pagat 172,481.32€

-Mallra dhe shërbime 36,059.35€

-Shpenzime komunale 8,998.59 €

Gjithsej shpenzimet: 217,539.26€

X. DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Ky raport përfshinë periudhën nëntë mujore (Janar-Dhjetor 2019) të cilën Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e vlerëson si jashtëzakonisht pozitive, sa i përket të arriturve të drejtorisë në raport me realizimin e planit vjetor të punës.

Vlen të theksohet se e arritura kryesore e kësaj drejtorie është përmbyllja me sukses e procesit të negociimit të Marrëveshjes për financim për realizimin e projektit madhor infrastrukturor në vlerë prej 26 milion Euro “Impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe infrastrukturës përcjellëse në Komunën e Gjilanit” e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe BERZH me 9 Maj

2019 në Sarajevë. Gjatë këtij viti ka filluar procesi i vlerësimit të kompanisë konsulent, ndërsa projekti pritet të përfundojë në vitin 2022.

Më poshtë është prezantuar në mënyrë kronologjike një përmbledhje e aktiviteteve të realizuara me sukses me sa vijon:

- Realizmi i të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me rishikimin e studimit të fizibilitetit për projektin kapital “Impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe infrastrukturës përcjellëse” në Komunën e Gjilanit.
- Negocimi i marrëveshjes për financim për projektin e Impiantit për trajtimin e ujërave të zeza dhe nënshkrimi i së njëjtës siç është përmendur më lartë.
- Nënshkrimi i marrëveshjes tre palëshe si BERZH, Komuna e Gjilanit dhe Kompania Rajonale “Hidromorava” për zbatim të projektit në fjalë.
- Në bashkëpunim me KR “Hidromorava” dhe përfaqësuesit e BERZH ka vazhduar procesi i vlerësimit të kompanive dhe pritet të përzgjidhet dhe kontraktohet kompania konsulente e cila do t’i ofroj mbështetje profesionale teknike Njësisë për Implementimin e Projektit (NJIP) siç kërkohet me standardet e organizatave financiare ndërkombëtare për të ndërmarrë veprimet e nevojshme në lidhje me përgatitjen e dokumentacionit për tenderim derisa punimet në terren pritet të fillojnë vitin e ardhshëm.

Sa i përket investimeve kapitale, gjatë muajit Mars është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik për realizimin e projektit “Modernizimi i tregut të gjelbër në Komunën e Gjilanit” dhe kanë vazhduar punimet të cilat sipas kontratës pritet të përfundojnë vitin e ardhshëm. Ky projekt me infrastrukturë bashkëkohore do të ndikoj jo vetëm në përmirësimin e kushteve për shitjen e produkteve të freskëta të prodhuesve tanë, por edhe do ta transformoj plotësisht atë paraprak duke e bërë atraktiv për qytetarë dhe vizitorë. Ky investim publik do të ndikoj në përmirësimin e kushteve për shitjen e produkteve të freskëta pemë dhe perime për 100 prodhues tanë si dhe mbi 200 tregtar të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në tregun e gjelbër.

Në anën tjetër në bashkëpunim me NPL “Tregu” është realizuar plani për vendosjen e tregjeve mobile në disa pjesë të qytetit si Arbëri, Dardani, Kamnik dhe rruga afër Përlepticës, duke ju ofruar mundësi bujqve, prodhuesve të vegjël të Komunës së Gjilanit të shesin produktet e tyre në vendbanime me numër më të madh të banorëve dhe më të frekuentuara. Këto tregje mobile janë nën menaxhimin e NPL “Tregu” e cila do të përkujdeset për qëndrueshmërinë dhe funksionimin e plotë të tyre në të ardhmen.

Një projekt tjetër i cili është duke shkuar kah përmbyllja është projekti “ Vazhdimi i punimeve në lumin Mirusha faza II” me financim nga MMPH në vlerë prej 250,000 Euro për këtë vit si dhe me bashkë financim nga buxheti i DZHE. Ky projekt ka zhvilluar punimet sipas planit dinamik kohor të paraparë.

Një projekt tjetër i cili është finalizuar gjatë kësaj periudhe është terreni sportiv në fshatin Pogragjë i realizuar në bashkëpunim me shoqatën “Pogragja” me seli në Zvicër derisa është duke u punuar në ndërtimin e terrenit sportiv në fshatin Bresalc në bashkëpunim me “Rotary Club”.

Një sektor tjetër i rëndësishëm i kësaj drejtorie është edhe Eficienca e Energjisë (EE) Me kërkesën e MZHE ka vazhduar procesi i vlerësimit të kompanisë konsulente në kuadër të programit me KfW (Bankën gjermane) për projektin “Masat e efijencës së energjisë në ndërtesat publike”. Gjatë kësaj periudhe është përmbyll faza e parë e vlerësimit ndërsa faza e dytë e vlerësimit është në proces dhe pritet të përfundoj deri në fund të këtij viti ndërsa zbatimi i projekteve në terren pritet të filloj në fillim të vitit 2020. Komuna e Gjilanit synon që përmes këtij programi të intervenoj me masa të EE në tri shkolla si “ Ibrahim Uruqi” Bresalc, “Skënderbeu” Perlepnice dhe “Dëshmorët e kombit”, Gjilan.

Vlen të theksohet se DZHE ka vazhduar të bashkëpunoj ngushtë me projektin “Support on implementing the 3RD Energy package with focus on EE/ER”, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian, që zbatohet nga konsorciumi i udhëhequr nga GFA Consulting Group, Hamburg, Gjermani. Objektiva e përgjithshme e këtij projekti (Mbështetje në Implementimin e Pakos së Tretë të Energjisë me fokus në Efijencë të Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme) është mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Strategjisë Kombëtare të Energjisë. Si pjesë e këtij projekti përveç përkrahjes së komunës në hartimin e PKVEE, përgatitjen e një projekti për aplikim në fondet e BE të dedikuara për komunat e Kosovës në fushën e EE, përmes këtij projekti edhe do të instalohet softveri ENSMASOFT-it i cili zbatohet në bashkëpunim me GIZ dhe i cili do të shërbej për të menaxhuar efijencën e energjisë në objektet komunale në të ardhmen. Po ashtu dy zyrtarë komunal kanë ndjekur trajnim tre-ditor për përdorimin e këtij programi. Me përkrahjen e këtij projekti është finalizuar dokumenti “Plani Komunal i Veprimit të EE 2019-2021” dhe në këtë dokument janë planifikuar masa të efijencës së energjisë në 7 objekte publike derisa planifikojmë të aplikojmë me projekte (katër shkolla) për financim në fondin e lartpërmendur të EE i cili është pritur të lansohet gjatë këtij viti mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Programi tjetër me MZHE -AEE dhe KfW ka shënuar progres dhe vitin tjetër pritet të fillojë realizimi në tri shkollat e lartpërmendura në Bresalc, Perlepnice dhe “Dëshmorët e Kombit” në Gjilan. Sidoqoftë, drejtorja ka përgatitur projektin për aplikim për intervenim me masa të EE në shkollën në fshatin Uglar dhe është duke u realizuar nga donatori “Shqip king”.

Në kuadër të programit PPP gjatë këtij viti ka filluar procesi për realizimin e tri (3) studimeve të fizibilitetit për projekte në fushën e turizmit, energjisë, infrastrukturës biznesore, sportive etj. Realizimi i këtyre studimeve si: “Penda e Livoqit”, “ Shtrirja e rrjetit të gazit natyror dhe të kompresuar në Komunën e Gjilanit” dhe “Palestra e sporteve “Bashkim Selishta-Petriti” janë në faza të ndryshme të realizimit dhe do të krijojnë mundësi për investime përmes partneritetit publiko-privat për zbatim të projekteve zhvillimore duke e bërë kështu komunën atraktive për investitor vendor dhe të huaj. Pas nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim gjatë muajit

Korrik 2019 ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Qeverisë Zvicerane “Swiss Contact” janë zhvilluar takime me ekspertë ndërkombëtar në fushën e turizmit, ekspertë nga kompanitë franceze si “Geode” dhe “Avione Jaune” ku vlen të përmendet se tashmë janë përfunduar matjet gjeodezike në liqenin e Livoqit ndërsa studimi i fizibilitetit është në progres dhe pritet të përfundojë deri në fund të këtij viti eventualisht në fillim të vitit të ardhshëm.

Sa i përket projektit PPP “ Rregullimi i infrastrukturës së kompleksit të shkollave të mesme të Gjilanit”, projekt ky i cili ka për qëllim rregullimin, sigurimin, funksionalizimin e hapësirës shkollore dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për nxënësit dhe personelin është në realizim e sipër dhe gjatë këtij viti pritet të përfundojë të gjitha punët ndërtimore sipas kontratës. Partneri privat “Adea fast food” Sh.p.k ka qenë i hapur për bashkëpunim dhe në koordinim me Ekipin për Menaxhimin e Projektit, si dhe nën përkujdesjen e DZHE është dorëzuar me kohë raporti vjetor në Ministrinë e Financave të përgatitur sipas Direktivës #5 “Mënyra e Raportimit të Autoriteteve Publike tek KPPP”. Kjo kontratë PPP me formë koncesioni ka filluar në vitin 2015 dhe kohëzgjatja e saj përfshinë periudhën prej 15 vitesh.

Komuna e Gjilanit me datë 30 Maj 2019 zyrtarisht ka dërguar Njoftimin për Ndërprerje të Marrëveshjes PPP “Eco-higjiena” sh.p.k për shkëputje të kësaj kontrate si rezultat i mos përmbushjes së obligimeve ligjore nga ana e partnerit privat. Procesi i tranzicionit sipas marrëveshjes në fjalë është dashur të përbyllet brenda një periudhe gjashtë mujore, mirëpo marrëveshja është në proces gjyqësor dhe deri në fund të vitit nuk është marrë asnjë vendim gjyqësor nga ana e organeve kompetente.

Drejtoria gjatë periudhave të ndryshme ka realizuar me sukses katër (4) panairë me qëllim të promovimit të bizneseve dhe aktiviteteve të tyre afariste si dhe promovimin e shkathtësive për punë tek të rinjtë, pastaj tri (3) konferenca informuese me biznese dhe 1 konferencë për promovim të mundësive për investime në komunë si në vijim:

- Edicioni i dytë i Panairit të Punës i organizuar në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Qeveritare Gjermane GIZ, MPMS ku kanë marrë pjesë 45 biznese të cilat kanë ofruar rreth 500 vende pune.
- Mini panairi tre ditor (Qershor 2019) me gratë artizane dhe fermere organizuar në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 20 vjetorit të çlirimit të Gjilanit.
- Panairi “Gratë në biznes” i organizuar në bashkëpunim të ngushtë me MTI (17-19 Korrik 2019) ku kanë ekspozuar punimet artizanale rreth 30 gra nga komuna e Gjilanit dhe komunat tjera të Kosovës.
- Panairi Biznesi me konsumatorët i organizuar në bashkëpunim me Global Consulting and Development Associates (në muajin Shtator 2019) në kuadër të programit “Interdev 2” të UNDP ku kanë marrë pjesë 30 biznese nga komunat si Viti, Dragash dhe Shtërpce të përfshirë në aktivitete të bujqësisë, industrisë ushqimore dhe gastronomi turizëm.

- Konferenca informuese në bashkëpunim me MTI KIESA dhe BB me NVM dhe Shoqatat e Bizneseve, për Thirrjen e “Programit për Grantet e Përputhshme (PGP) “ që ka pasur për qëllim t’i ndihmoj NMVM-ve për Standardizimin/Certifikimin e Produkteve si dhe Shërbimet e Zhvillimit të Biznesit (ShZhB)/Trajnimit.
- Konferenca “Ditët e Biznesit të Vogël 2019” që kishte për qëllim të zhvillojnë dialogun publiko - privat i cili, së bashku me fuqizimin e ndërmarrësish, janë më se të domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit privat, respektivisht zhvillimit ekonomik.
- Në bashkëpunim me Klubin e Prodhuesve të Kosovës dhe përfaqësues të bizneseve ka organizuar sesion informues në lidhje me prezantimin e Platformës “Made in Kosova”. Kjo web platformë do të përfshijë të gjitha kompanitë e sektorit të prodhimit dhe shërbimeve në Kosovë me qëllim kryesor promovimin e produkteve dhe shërbimeve në mbarë botën. Platforma do të jetë një panair i përhershëm online, ku secila kompani do të ketë profilin e vet të kompanisë si dhe do të prezantohen të gjitha produktet e saj.
- Konventa me Diasporë organizuar nga USAID programi Fuqizimi i sektorit privat mbajtur me 25-26 Nëntor 2019 në Prishtinë ku nga vetëm 5 komunitat e përzgjedhura të Kosovës, janë prezantuar mundësitë për investime në Komunë para një numri të madh biznesesh nga diaspora.

DZHE është përkujdesur dhe ka bashkëpunuar ngushtë me tri projektet e financuara përmes programit “Fuqizimi i Sektorit Privat” të financuara nga Populli Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Vlen të përmendet se nga ky program kanë përfituar gjithsej 167 të rinj derisa me bashkë financim të Komunës së Gjilanit dhe Organizatës Gjermane “Help”, janë ndarë 19 (8 M dhe 8 F) grante në formë të pajisjeve kryesisht për biznese fillestare si dhe janë trajnuar 50 të rinj në përgatitje të planit të biznesit. Gjithashtu, në kuadër të projektit tjetër i cili realizohet nga “Klubi i Prodhuesve të Kosovës” gjatë këtij viti kanë përfunduar punën praktike me pagesë 57 të rinj në kompanitë “Fluidi”, “Flexograf”, “Menakon”, “Euro model”, “Gandizajn” etj. Projekti tjetër në kuadër të programit të USAID-it i cili zbatohet nga American University of Kosova (AUK) ka realizuar me sukses trajnimet në ICT dhe gjuhë gjermane ku kanë përfituar 60 të rinj nga Komuna e Gjilanit.

Sa i përket projekteve të financuara nga BE, Programi IPA BNK gjithsej 114 ndërmarrëse artizanale kanë përfituar shkathtësi për punime me “vek”, prodhim të produkteve artizanale prej materialeve ekologjike dhe paketimi e deri te përgatitja e ushqimeve tradicionale nga projektet e realizuara nga OJQ “Open door” dhe ATRC në bashkëpunim me komunën e Gjilanit. Një rezultat tjetër i këtij të fundit është krijimi dhe lansimi i platformës online për shitjen e produkteve artizanale “Arctcraft4you” si dhe krijimi i ndërmarrjeve sociale.

Sipas evidencave nga QRB viti 2019 shënon kthesë pozitive sa i përket numrit të bizneseve të regjistruara (513) dhe numrit të punëtorëve të regjistruar (910) si dhe numër më të vogël të bizneseve të ç regjistruara (77) dhe punëtorë (93) krahasuar me vitet paraprake. Ajo çfarë ia vlen të nënvizohet është se këtë vit, pas dy dekadave, prin veprimtaria shërbyese me 269 biznese të regjistruara, derisa më herët ka dominuar tregtia. Konsiderojmë se ky është një indikator pozitiv që sektori privat ka filluar të bëhet shtytës i zhvillimit ekonomik lokal.

Qendra ka ofruar 3140 shërbime bizneseve në fusha të ndryshme ndërsa 2004 biznese kanë ndërruar certifikatat e biznesit duke u pajisur me të reja sipas ndryshimeve që kanë filluar të aplikohen nga MTI/ARBK. Gjithsej janë përgatitur 219 Procesverbale dhe Vendime për taksë komunale si dhe drejtorja ka trajtuar 110 kërkesa të ndryshme duke respektuar afatet e parapara ligjore.

Drejtorja vazhdon të bashkëpunoj ngushtë dhe të koordinohet me Komisionet Komunale të NPL “Tregu”, “Stacioni i Autobusëve” si dhe me të gjithë akterët relevant në nivel lokal dhe qendror, donator, shoqëri civile, komunitetin e biznesit, me qëllim të arritjes së partneriteteve përmes koordinimit të iniciativave dhe aktiviteteve të cilat ndikojnë në përshpejtim dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal.

Arkëtimi i të hyrave vetanake përmes taksës nga bizneset ka shënuar trend pozitiv dhe është ndër më i larti që është arritur ndonjëherë. Të hyrat e planifikuara për këtë vit kanë qenë 70,000 Euro, ndërsa janë realizuar gjithsej 99,339.51, në përqindje realizimi arrin në 142% ose 24% , më shumë se të hyrat e planifikuara për këtë vit. Kjo situatë ka ndryshuar duke ju falënderuar përfaqësuesve të bizneseve të cilët ju kanë përgjigj pozitivisht ftesës për pagesë dhe shlyerje të obligimeve ndaj Komunës së Gjilanit. Ndërkaq, sfidë për ne mbetet shlyerja e borxhit nga bizneset, të akumuluar ndër vite, përkundër faktit se gjatë këtij viti nuk ka pasur rritje të borxhit të përgjithshëm, krahasuar me vitet paraprake.

Nga buxheti i përgjithshëm i drejtorisë prej 1.330,240.80 Euro, gjatë këtij viti, drejtorja ka shpenzuar gjithsej 1.257.237.37 Euro ose 94.5 %.

XI. DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPETIM

Drejtorja për Mbrojtje dhe Shpëtim, aktivitetin e saj e bazon në planin vjetor të cilin e harton në fillim të çdo viti kalendarik në periudhën Janar – Dhjetor të vitit pasues gjegjësisht vitin 2019.

Plani i punës së Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH), mbështetet në rregulloret dhe ligjet në fuqi, si në Ligjin mbi Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, me nr;04/L-027; Ligjin e Mbrojtjes nga Zjarri nr. 04/L-012, Ligjin për Zjarrfikje dhe Shpëtim me nr: 04/L-049, Ligjin përkatës Komunal, udhëzimet-rregulloret përkatëse të lamisë së emergjencave, të cilat kanë fushë veprimtarinë në menaxhimin e situatave Emergjente duke bërë identifikimin, lajmërimin dhe alarmimin me kohë të situatave të cilat kanë të bëjnë me atakimin e jetës së njerëzve dhe të mirave materiale në Komunën tonë, për të cilën veprimtari ka hartuar edhe plane konkrete si Planin e Vlerësimit të Rrezikut, Planin Operativ Emergjent, plane kontingjente etj.

Duke u bazuar në përgjegjësitë dhe ligjet në fuqi, DMSH ka ndërmarrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme, në bashkëpunim me subjektet relevantë duke bërë koordinimin e plotë, duke u bazuar nga lloji i fatkeqësive dhe përmasat e shkallës emergjente.

Puna e DMSH, është në m ‘varësi nga faktorët e ndryshëm natyror, por edhe faktorëve tjerë njerëzor e teknologjik, andaj aktivitetet e DMSH janë sipas intensitetit të këtyre faktorëve që i

cekëm më lartë dhe faktorëve të tjerë që përcaktohen nga kushtet e përgjithshme shoqërore dhe klimatike.

Në kuadër të tërë kësaj, do ta paraqesim raportin sipas aktiviteteve të zhvilluara për tërë vitin kalendarik 2019.

- Ky vit është filluar me hartimin e planit të punës për vitin 2019. Në bazë të kësaj, me kërkesë të AME-së, është hartuar edhe lista e trajnimeve të nevojshme të zyrtarëve me qëllim të ngritjes profesionale të Njësisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NjPZSh), por që në këtë vit si rezultat i angazhimit të madh të Akademisë në Vushtrri, trajnimet nuk janë mbajtur me kohe dhe sipas planit të paraparë nga Agjensioni, me përjashtim të trajnimit të një grupi vullnetar të Personelit Profesional të Zjarrfikësve dhe Vullnetarët nga Shoqata Zjarrfikësve në Gjilan.
- DMSH, ka marrë masa e nevojshme për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme si dhe ka përcjellë aktivitetet e subjekteve relevante duke bërë koordinimin me to varësisht nga karakteri, lloji dhe përmasat e fatkeqësisë.
- Në bashkëpunim me zyrën e Kryetarit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe subjekteve tjera emergjente, përgjatë këtij viti janë koordinuar aktivitetet e ndryshme në intervenime të përbashkëta në dalje në ndihmë qytetarëve për eliminimin e rrezikut nga zjarret, vërshimeve, stuhive dhe rreziqeve nga fatkeqësitë të tjera.
- Me 07 mars 2019 rreth orës 14:10 minuta, komuna e Gjilanit kishte një fatkeqësi komunikacioni me fatalitet, me shumë të lënduar dhe dëme materiale. Si pasojë e kësaj fatkeqësie në komunikacion, kishim një qytetar të vdekur në vend, 21 qytetarë të tjerë kanë marrë lëndime të rënda dhe të lehta, të cilët janë dërguar me urgjencë në Spitalin Regjional në Gjilan dhe tre prej tyre për në QKUK. Dëme materiale kanë qenë 11 vetura të dëmtuara, dy shtylla elektrike, dy drunjë, një CityLight i reklamave, katër tabela trafiku etj. Pas aksidentit, në vend të ngjarjes kanë dalë menjëherë të gjitha ekipet komunale emergjente nën mbikëqyrjen e tërësishme të shtabit të emergjencave të udhëhequr nga kryetari i Komunës z.Lutfi Hazri, ku kjo fatkeqësi është menaxhuar me përgjegjësi të lartë profesionale.
- DMSH, për gjatë gjithë vitit ka vazhduar të identifikoi objektet të cilat paraqesin rreziqe të ndryshme për qytetarët. Objekte të tilla janë për shkak të vjetërsisë dhe mos mirëmbajtjes së tyre, si dhe objekte të pa banuar që nga pas lufta si në rastin në Lagjen Avdulla Presheva, gjithashtu disa objekte Institucionale në qytet e rrethinë dhe objekte private sipas kërkesave të vetë qytetarëve.
- Ky vit, në vazhdimësi është karakterizuar me zjarre të hershme në mungesë të të reshurave e sidomos në periudhën: janar (35), shkurt (62 zjarre) dhe mars (117 zjarre) të këtij vitit kemi pasur rritje të intervenimeve në shuarjen e zjarreve. Pas tremujorit të parë ne kemi marrë masat e duhura në ngritjen e gatishmërisë me zyrtarët e DMSH, Njësisë Profesionale të Zjarrfikësve, ku kemi mbajtur disa takime me faktorët Komunal Emergjent: si me Policinë e Kosovës, zyrën operative emergjente 112, Inspektoratin e Zjarrfikjes së AME, zyrtarët e Pylltarisë, ku kemi dakorduar në marrjen e masave të duhura dhe në vazhdimësi kemi vazhduar bashkëpunimin në mes këtyre Institucioneve.

- Në kuadër të kësaj kemi bërë një fushat vetëdijesuese për qytetarët përmes njoftimeve të përgjithshme si: komunikimit të drejtpërdrejt me qytetarë, këshillave të lagjeve dhe fshatrave, posterëve, mediave elektronike dhe rrjeteve sociale, me qëllim të njoftimit dhe të vetëdijesimit të qytetarëve në parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore. Si rezultat i këtyre masave, gjatë sezonit të nxehtë verore në tre mujorin e tretë, përkundër temperaturave shumë të larta, ne kemi pasur rënie të dukshme të zjarreve malore dhe atyre fushore në muajt: korrik (38 zjarre), gusht (63 zjarre) dhe shtator (40), ku këto zjarre janë intervenime të ndryshme dhe shumë pak fushore edhe më pak intervenime malore. Tërë kjo falë bashkëpunimit dhe koordinimit të mirë në mes të institucioneve, gjithashtu edhe vetëdijesimit dhe kujdesi i vetë qytetarëve në parandalimin e zjarreve.
- Në fillim të këtij viti DMSH ka sjellë një donacion shumë me rëndësi nga Zvicra përmes Rotary Club të Gjilanit. Donacioni është Kamion për Intervenime të ndryshme Teknike për Shërbimin e zjarrfikjes dhe Shpëtimit në Gjilan. Ky ka një gjenerator elektrik që jep rryme 30 kë/h, reflektor për ndriçim 4000 wat dritë dhe shumë pajisje të tjera për raste të intervenimeve të ndryshme.
- Në bashkëpunim me AME-në, është mbajtur simulim një ditore për tërmetet me mjetin profesional simulues për tërmete në hapësirat e oborrit të shkollës fillore Selami Hallaqi, me çka kanë marrë përvojën e duhur mbi 400 nxënës të shkollave të komunës sonë.
- Njësinë profesionale të Zjarrfikëseve e kemi furnizuar me tri pompa (shpinore) profesionale të ajrit të llojit STIHL Br 600, për fikjen e zjarreve, të cilat shërbejnë dhe lehtësojnë punën në fikjen e zjarreve malore dhe fushore.
- Po ashtu, brenda këtij viti, DMSH, ka pajisur dhe furnizuar NjPZSh me shumicë ajrore, dyer të garazheve, pajisje tjera të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.
- Me kërkesë të drejtorisë së DMSH-së në bashkëpunim me Kompaninë Hidromorava, është krijuar grupi i përbashkët punues, në hartimin e Projektit të Hidrantëve Publik. Si pjesë e parë e këtij grupi profesional të punës, është arritur të aftësohen shtatë pika furnizuese të Hidrantëve në qytetin tonë të cilët më herët kanë qenë jashtë funksionit.
- Për shkak të thatësisë dhe mungesës së ujit në disa pjesë të qytetit, në bazë të situatës dhe gjendjes së krijuar, DMSH ka hartuar Planin Kontingjent për Përballimin dhe Menaxhimin e Mungesës së Ujit të Pijshëm-Thatësisrës, i cili i është dorëzuar me kohë zyrës së kryetarit dhe është njoftuar edhe kuvendi komunal me këtë plan.
- Jemi angazhuar në identifikimin e familjeve në nevojë për banim social përmes zyrtarit të DMSH-së, në Komisionin e formuar nga Kryetari i Komunës.
- Gjithashtu DMSH përmes zyrtarit është angazhuar dhe kemi marrë pjesë në Komisionin për dezinfektimin, dezinfektimin dhe deratizim (DDD) të objekteve dhe hapësirave publike i krijuar nga zyra e kryetarit.
- DMSH ka mbajtur takime të rregullta me Forcat e Sigurisë së Kosovës, Liaison Monitoring Team LMT KFOR në Gjilan, Policinë e Kosovës, Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit Hidromorava etj.
- DMSH përmes drejtorit është pjesë e përhershme e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, ku vazhdimisht ka qenë pjesë aktive përgjatë të gjitha takimeve dhe ka raportuar rregullisht për gjendjen dhe sigurinë në fushën e emergjencave

- Në DMSH janë implementuar më shumë se 225 aktivitete të ndryshme në kuadër të drejtorisë të evidentuar në librin zyrtar të protokollit si: kërkesa, përgjigje, procesverbale, propozime, rekomandime, vërtetime, autorizime etj.
- Nga raporti nëntë mujor i Intervenimeve në Njësinë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit (NjPZSh) për këtë periudhën: janar-dhjetor 2019 kemi 524 intervenime në zjarre të ndryshme, 60 intervenime teknike, 20 shërbime të ndryshme, 11 lajmërime të rrejshme, 7 vërshime, eksplozime 1, gjithsejtë deri më tani janë 623 dalje ose intervenime të përgjithshme nga NjPZSh.
- Nga raporti vjetor i Inspektoratit për Parandalimin nga Zjarreve, janë kryer inspektime të rregullta me ç ‘rast janë hartuar procesverbale dhe vendime, gjithashtu janë lëshuar, vërtetime mbi gjendjen e sigurisë nga zjarri të subjekteve të ndryshme, vërtetime mbi zjarrin e ndodhur në objekte të ndryshme kryesisht të sektorit privat, njoftime për njësinë e hetuesisë së policisë së Kosovës në Gjilan. Gjithashtu janë lëshuar edhe pëlqime të dokumentacioneve teknike në sektorin publik dhe atë privat në Komunën e Gjilanit. Nga aktivitetet e kësaj njësie, kemi inspektime 234, sektori i pasurisë 234, nga objekte të inspektuar sipas kategorisë 278, masa të propozuara 570, aktvendime të marra 27, masa të urdhëruara 101 ku (pëlqime në dokumentacionin investivo teknik 8, vend shikime të zjarreve 20).

XII. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Sektori i Kulturës:

Flaka e Janarit 2019

Ne muajin janar u mbajt Manifestimi kulturor-mbarëkombëtar ”Flaka e janarit 2019”- edicioni i 28-të. Me 11 janar fillon, me respektin dhe krenarinë për dëshmorët e kombit, duke bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve dhe në lapidarët në qytet, për të vazhduar “ndezja e flakadani”- Flakadani u ndez tek sheshi “Rexhep Mala e Nuhi Berisha” pranë lapidarëve të tyre. Manifestimi zyrtarisht u hap me 17 janar, me Akademinë e Flakës, kushtuar 20 vjetorit të çlirimit të Gjilanit. Pastaj duke vazhduar me ekspozitën e arteve figurative- pamore, ku edhe këtë vit kishte punimeve të shumta artistike. Më 19 janar në Bibliotekën e qytetit u mbajt “Tryeza historike kushtuar veprës së kolosit: “Mulla Idriz Gjilani”, ku folën historianët. Me 21 janar u mbajt: Akademia përkujtimore me rastin e 13 vjetorit të ndarjes nga jeta të Presidentit historik Ibrahim Rugova. Kjo akademi ishte pasuruar edhe me program artistik nga Shkolla e Muzikës në Gjilan si dhe nga kori “ Siparantum” nga Peja nën dirigjimin e prof. Memli Kelmendi, për të - vazhduar me koncert solistik nga muzika klasike me artist nga Shqipëria.

Nga 23 deri me 27 janar u organizua Festivali mbarëkombëtar i Dramës Shqipe:

“ Talia e Flakës 2019” Festivalin e hapi Teatri Kombëtarë i Kosovës me shfaqjen:“ I ligu për mend” autor Gjergj Fishta, regjia Altin Basha.

Në natën e dytë u paraqit Teatri i Gjilanit me shfaqjen “I vetëm në banesë” autor Avni Shkodra, regjia Natyrë Kallaba.

Në natën e tretë u prezantua Teatri Eksperimental “Kujtim Spahi vogli” nga Tirana me shfaqjen “Kreolët e Ballkanit” autor dhe regjisor Enver Petrovci.

Nata e katërt vazhdoi me teatrin “Multimedia” me shfaqjen “Hipokritët ose pacienti anglez” autor Jeton Neziraj regjia, Blerta Neziraj.

8. **Më 27 janar** ishte nata e fundit dhe përmyllja e Festivalit, në skenë u paraqit teatri “Adriana” nga Ferizaj me shfaqjen “Kur hana del”, autor Ag Apolloni, regjia Ben Apolloni, pas shfaqjes u ndanë edhe çmimet që jep Festivali.

9. **Më 28 janar** u mbajt Festivali i Këngës për fëmijë: “Xixat e Flakës”, ku u paraqitën shumë talent të rinjë.

10. **Më 31 janar**, në sallën e Bibliotekës u mbajt edhe Ora e madhe letrare “Pena e Flakës”, ku shumë krijues konkurruan me krijimet e tyre si në: poezi dhe prozë dhe në fund juria vlerësoi 3 krijimet më të mira, po ashtu u lexuan edhe shumë poezi nga shkrimtarë e poet nga të gjitha trevat shqiptare.

11. **Festivali mbarëkombëtarë** “Flaka e Janarit ” 2019, përfundoi me 31 janar me “Fest Flaka” – Festivali i muzikës popullore, po ashtu edhe këtë edicion, nga juria profesioniste u ndanë 3 çmimet e para, për solistët më të mirë.

Dita e Pavarësisë

17 Shkurti - u shënuar kjo ditë shumë e rëndësishme për Kosovën në ngritje të vlerave tona kombëtare e shtetërore, u mbajtën aktivitetet kulturore, në sallën e Kuvendit u mbajt ceremonia e ndarjes së çmimit qytetarë nderi, të ndara nga kryetari Haziri, po ashtu u shënuar ceremonia e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës nga objekti i Qeverisë arrin në Gjilan.

Më 5 - 6 mars, u shënuar Dita e dëshmorëve, të gjithë ata që ranë në altarin e lirisë, ata që dhanë gjithçka, dhanë edhe jetën, për lirinë që ne e gëzojmë sot. Ky aktivitet u shënuar në varrezat në “Kodrën e Dëshmorëve”, përgjegjës ishte DKRS, zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Shoqatën e OVL- të UÇK- së.

Më 15 Prill, në bashkëpunim me zyrën e kryetarit, OVL, familjet e dëshmorëve dhe përfaqësuesit e fshatit, është organizuar “Beteja e Zhegocit”, ku u përkujtuam dëshmorët e martirët të rënë në këtë betejë. Po ashtu këtë vit në parkun e lagjes “Dardania” u vunë bustet e heronjve, luftëtarëve e intelektualëve, që punuan pa ndalur deri në frymën e fundit për lirinë e vendit, qifti – Hanumshahe Abdullahu – Nushi e Tefik Zymberi.

Më 1,2 dhe 3 Prill, u mbajt Manifestimi: “Ditët e Agimit”, në fshatin Zhegër në vendlindjen e komandantit të Karadakut “Agim Ramadanit”, ky Manifestim u organizua nga Këshilli i fshatit në bashkëpunim me DKRS- në, dhe në koordinim me zyrën e Kryetarit. Qëllimi i këtij aktiviteti për vjetshëm është rikujtimi i veprës së jashtëzakonshme të heroit të kombit, komandantit “Agim Ramadani”, në luftën për çlirimin e Kosovës. U bënë homazhe pranë lapidarit të heroit “Agim Ramadani” nga familja e tij, bashkëluftëtarë e personalitete politike dhe po në këtë ditë në qendër

të qytetit u zbulua mozaiku i punuar me gëzhoja plumbash, portreti i komandantit “Agim Ramadani”.

Më 01 Qershor, u shënua dita ndërkombëtare e fëmijëve, në këtë ditë u organizuan shumë aktivitete me fëmijët dhe për fëmijët.

Aktivitete të organizuara nga Asambleja e fëmijëve, vizita në institucione të ndryshme komunale, vizitë zyrës së kryetarit të Komunës z. Lutfi Haziri etj.

Teatri i Qytetit shfaqti premierën e shfaqjes për fëmijë “Beli Blerta dhe Balena blu”, luajtur nga aktorët Safete Mustafa-Baftiu e Gzim Bucolli me regji të Burim Baftiu.

Kjo festë për fëmijë u përmyll me Festivalin “Lyra Fest” që u mbajt në teatrin e Qytetit, ky ishte edhe vit jubilar dhjetëvjetori i “Lyra Fest”.

Në muajin Qershor, për nderë të 20-të vjetorit të çlirimit të Gjilanit, për tri ditë u organizuan shumë aktivitete. Aktivitetet filluan me respektin për shkrimtarin, dramaturgun Gjilanas Beqir Musliu, homazhe te varri i tij.

Më 14 Qershor – shtegu i lirisë, vrapimi nga fëmijët e lindur në vitin e Pavarësisë, nisja nga kazerma e FSK-së. Inaugurimi i Shtëpisë së Kulturës “Zija Shemsiu” në Përlepnice, shpallja e më të dalluarve në sport, Hotel Astoria.

Shfaqje nga Presheva “Misteri” ora 20-00 teatri i Qytetit.

Me 15 Qershor, u fillua me homazhe te varrezat e dëshmorëve, shoqata e historianëve “Ali Hadri” simpozium për Mulla Idriz Gjilanin, shfaqje për fëmijë në teatrin e qytetit, trekëndëshi poetik Shurdhan, shpallja e më të dalluarave në kulturë e rini, në fund të programit kryetari Haziri ndau mirënjohje për më të dalluarit.

Tani do të fillojmë me koordinimin dhe përgatitjet për aktivitetet në shenjë falënderimi e respekti për mërgatën Korrik – Gusht e aktivitete të tjera sipas kërkesave e mundësive.

14 Korrik 2019 - “Shtegu i Lirisë”

Në Gjilan është mbajtur gara “Shtegu i Lirisë” me fëmijët e lindur në vitin e shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës. Pjesëmarrës ishin rreth 400 fëmijë të lindur në vitin 2008 dhe gara nuk kishte karakter garues.

Nisja e kësaj gare filloj nga Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë të FSK-ës, pasi që është simbolik e veçantë për vlerësimin e lartë për këtë institucion dhe për t’i kujtuar dëshmorët, heronjtë dhe martirët e kombit që u flijuan për ditët e lirisë që Gjilani dhe Kosova po i gëzon tash e 20 vjet.

24 Korrik 2019 - “Stretball Kosova 2019”

Në kuadër të organizimit të turneut “Stretball Kosova 2019”, edhe Gjilani ishte mikpritës i kësaj gare mjaft atraktive. Pjesëmarrës ishin 6 (gjashtë) ekipe ku ndeshja finale ishte shumë interesante në mes të “AIR FORE ONE” si dhe ekipit “PRO ENG PERLEPNICA”. Fitues i këtij turneu ishte “AIR FORCE ONE” ku edhe siguroj biletën për pjesëmarrje në finalen e madhe që u mbajt në Prishtinë.

Spektori i Sportit vazhdimisht është duke punuar që të respektohen rregulloret për shfrytëzimin e hapësirave sportive, ngritjen dhe intensifikimin e komunikimit me të gjitha klubet sportive të komunës.

1-6 Gusht 2019, “Ditët e Mërgatës”

Biblioteka ka pritur dhe përcjell fëmijët e mërgimtarëve në kuadër të aktiviteteve të Ditëve të Mërgatës.

12 Gusht 2019- “Dita e Rinisë”

Dita e Rinisë, u shënuar me një pjesëmarrje të gjerë të të rinjve në fushën e artit, muzikës, letërsisë dhe sportit, duke përcjellë mesazhin e rinisë aktive që Gjilani e ka.

13 Gusht 2019- “Fuqizimi i Rinisë dhe Rritja e Pjesëmarrjes”

Në Shtëpinë e Rinisë në Gjilan u mbajt aktiviteti i radhës për nder të ditës së rinisë me temë “Fuqizimi i Rinisë dhe Rritja e Pjesëmarrjes” e organizuar nga Organizata KGBTO e mbështetur nga Komuna e Gjilanit/ DKRS. Në këtë aktivitet pjesëmarrës ishin shumë organizata si KVRL, Forumi Rinor, Organizata Studentore, OJQ si dhe klube sportive. Në këtë takim u shfaqën shumë ide në të mirën e rinisë dhe komunës ku unë si ushtruese e detyrës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i pranova që t’i shqyrtoj kërkesat, sugjerimet, pakënaqësitë dhe idetë e tyre.

17 Shtator 2019- “20 Vjetori i Rivarrimit të Dëshmorëve të Kombit”

Aktiviteti i organizuar nga DKRS-ja në bashkëpunim me Shoqatën e Familjeve të Dëshmorëve filloj me:

- Homazhet tek varrezat- Kodra e Dëshmorëve.
- Akademi në nderim për dëshmorët në 20 Vjetorin e Rivarrimit në Teatrin e Qytetit.

27 Shtator 2019, aktivitet në atletikë me moton “Vrapo, kërce, hedh” në bashkëpunim me Federatën e Atletikës së Kosovës. Organizuar një program lojërash për fëmijë të titulluar BeActive - “Atletika për Fëmijë – Gjilani 2019”.

TEATRI

1 Qershor – Premiera e shfaqjes më të re për fëmijë “Beli, Blerta dhe Balena Blu” e cila shënoi 1 vjetorin e Teatrit Magjik të Fëmijëve;

Sjellja e shfaqjeve në Gjilan dhe Teatrit Dodona nga Prishtina me shfaqjen “Tango”

Përkrahja financiare dhe zhvillimi/implementimi i projektit të Teatrit të Gjilanit nga programi “Kultura për ndryshim / Culture for Change” – TEATRI MOBIL

Shfaqja “Të fala nga Gjilani 2” për Mërgimtarët në kuadër të Ditëve të Mërgatës.

Shpërblimi me 2 çmimet kryesore në festivalin e Mitrovicës “Shfaqja që shkon keq” si Shfaqja më e mirë dhe Aktorja më e mirë për Tringa Hasanin;

Në festivalin e Preshevës “Ditët e Komedisë” me Shfaqjen “Vrapo pas gruas tënde” u shpërblyen me dy çmime; Tringa Hasani me çmimin aktorja më e mirë, si dhe aktori Gzim Bucolli, aktori më i mirë në rol dytësorë. Më datë 14 Tetor 2019 në bashkëpunim me MotoCross 06, kemi organizuar garën në motoçiklizëm Enduro Race 2019

Pra, me mbështetjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Gjilanit, në Stanishor është mbajtur me sukses gara e motoçiklizmit Enduro Race 2019 – “Ilir Balaj & Manuel Herzog”.

Prezent gjatë këtij evenimenti sportiv ishin shume garues nga vende të ndryshme.

Me datë 19 Tetor 2019, u hap Vjeshta Letrare organizuar nga Ars Clubi “ Beqir Musliu”, i cili manifestim letrar i mbushur me veprimtari të shumta letrare do të zgjat dy muaj deri më 21 Dhjetor.

Me datë 19 Tetor 2019, Sindikata e Policisë së Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, organizoi edicionin e VII-të të lojërave sportive.

Sindikata e policisë së Kosovës në shenjë nderimi dhe respekti për zyrtarët e rënë në detyrë ka organizuar edicionin e VII -të të lojërave sportive në futboll të vogël, në qytetin e Gjilanit. Hapja e këtij eventit sportiv u bë në Palestrën e Sportive “Bashkim Selishta – Petriti” në Gjilan.

Shtatëmbëdhjetë ekipe futbollit nga të gjitha drejtoritë e Policisë së Kosovës kanë treguar përgatitje dhe cilësi të larta sportive.

Të pranishëm ishin familjarët e policëve të rënë në detyrë, eprorë të lartë nga Drejtoria e përgjithshme e Policisë së Kosovës, eprorë nga Drejtoria Rajonale e policisë së Kosovës në Gjilan, zyrtarë komunal. Gjithashtu, te pranishëm ishin edhe kryesitë e sindikatave të policisë nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia.

Më datë 20 Tetor 2019, Federata e Autosporteve të Kosovës në bashkëpunim me Auto Klub Gjilani si dhe Komuna e Gjilanit/ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport organizoi garën në Auto Sllallom Gjilani 2019.

Gara është mbajtur në rrugën “Marie Shllaku” në Gjilan dhe si veçanti e kësaj gare është fakti se kjo garë është zhvilluar në të dyja konkurrencat (meshkuj dhe femra), ndërsa interesimi ishte mjaft i madh.

Kjo garë solli në qytetin e Gjilanit makina sportive të llojeve të ndryshme, ku u paraqiten me atraksionet e tyre të garës dhe me pjesëmarrës nga vende të ndryshme.

Po ashtu, për sigurinë e këtij aktiviteti ishte Policia e Kosovës, Brigada e Zjarrfikësve dhe Ndhima e Shpejtë, ku ndërmorën të gjitha masat që gara të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Më datë 20 Tetor 2019, Klubi i karatesë Dardania në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport organizoj turneun e XIV-të Ndërkombëtar “Katana Open 2019”

Turneu u mbajt të dielën në Palestrën Sportive “Bashkim Selishta – Petriti” në Gjilan.

Për më të mirët u ndanë shpërblime duke ju dhënë medalje dhe kupa të ndryshme për të gjitha kategoritë fitues të këtij turneu.

Pjesëmarrës ishin shumë shtete si Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi si dhe dy ekipe nga Lugina e Preshevës.

Më datë 22 Tetor 2019, do te mbahet Panairi i Sportit 2019, në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës, si edicioni i tret me radhë i këtij panairi.

Me datë 28 Tetor 2019, do të bëhet hapja e projektit “ Rritja e pjesëmarrjes dhe Fuqizimi i Rinise”

Nga data 29,30,31 Tetor. Të rinjtë do të kenë mundësinë e pjesëmarrjes në trajnimin “ Hartimi i Projekteve, Planeve të Biznesit dhe Lidërshiptit.

Për nderë të 28 Nëntorit ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë- Festës së Flamurit Fillimin e muajit Nëntor do ta nisim me Promovimin e Librit të familjes së “ Gjinollëve”, një monografi e shkruar nga Ibrahim Kadriu në bashkëpunim me Komunën e Gjilanit, gjegjësisht Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për të vazhduar më tutje me aktivitete të tjera.

Aktivitetet e parapara u mbajtën pjesërisht, programet festive u anuluan nga kryetari Lutfi Haziri, pas tërmetit me pasoja tragjike ku humbën jetën dhjetëra njerëz e qindra të tjerë të lënduar.

Muaji dhjetor do ta përmbyll vitin kalendarik me festat e fund vitit për te cilat jemi duke planifikuar aktivitetet, e të cilat do të publikohen ne faqen e Drejtorisë në mënyrë që të gjithë qytetarët të kenë mundësinë dhe njohurinë për të ju bashkangjitur aktiviteteve, si dhe planifikimin e kalendarit kulturorë për vitin e ardhshëm 2020.

BIBLIOTEKA E QYTETIT “ FAN S NOLI “ GJILAN

Mbi 2 mijë libra të rinjë të të gjitha lëmive dhe shkencave, (kanë hy në Bibliotekë)

- 450 gazeta ditore dhe 180 revista dhe materiale tjera bibliotekare.
- 3907 anëtarë të rregullt,
- 22429 libra të huazuara,
- 45 333 shfrytëzues lexues në salla;
- 4300 gazeta të lexuara studiues dhe hulumtues dhe pensionistë;

Siç edhe e dini, nëse fillohet të shikohet në mënyrë kronologjike të ngjarjeve në Bibliotekën e Qytetit atëherë ato janë kështu

- Në janar në bibliotekë është mbajtur ora e madhe letrare e “Flakës së Janarit”;
- Po në muajin janar koncert i muzikës klasike nga soprano Besa Krasniqi dhe miq (gjithashtu performues të njohur të muzikës klasike) në Kosovë.
- Në muajin shkurt gjegjësisht më datë 17 Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe nën patronatin e kryetarit z Lutfi Haziri, janë dhënë Mirënjohje për 4 lexuesit më të dalluar për vitin 2018: Elina Hajrullahu, Tuana Ajvazi, Valdete Salihu, Haqife Rahimaj.
- Gjatë muajit shkurt-mars, punëtorë të bibliotekës kanë qenë pjesëmarrës të një aktiviteti shumë të rëndësishëm “Projekti- Digital Citizen | Qytetari Digjital dhe Fondacioni BONEVET përmes pajisjeve BOSSON Add-on
- Në muajin maj Lumturiye Arifi, Mukadeze Behluli dhe Shqipe Latifi ka ndjekur ligjëratat tri javore në formë trajnimi për *Përpunimin e materialeve bibliotekare* për formimin e Katalogut elektronik të bibliotekës nga COBISS nga datat 20 – 24 maj; 10- 14 qershor dhe 24 – 28 qershor 2019, ky trajnim ishte obligueshëm dhe shumë me rëndësi për veprimtarinë profesionale të Bibliotekës së Qytetit.
- Në qershor është rihapur *biblioteka degë në fshatin Përlepnice*.
- Me 15 qershor me nxënës dhe anëtarë të bibliotekës kanë shfaqur Programin kulturor me “Recitim dhe këngë për Dëshmorët e Kombit me rastin e Ditës së Çlirimit të qytetit Gjilanit dhe siç e dini edhe ju me
- 12 korrik në hapësirat e Bibliotekës së Qytetit me aktivitete të ndryshme u zhvillua manifestimi i Ditës së Rinisë në Gjilan.
- 1, 2, 3 dhe 5 e 6 gusht Biblioteka ka pritur dhe përcjellë fëmijët e mërgimtarëve në kuadër të aktivitetit(“ Ditët e Mërgatës)
- 23 gusht aktiviteti i tjetër Rinor “Basket Shishe” .
- Më 16 gusht 2019 Qendra Didaktike në Gjilan i ka dhuruar Bibliotekës 966 libra, 296 revista dhe 55 cd room dhe 80 DVD.
- Biblioteka në fshatin Zhegër është duke u kryer meremetimi –pritet pranim –dorëzimi
- Promovim i dy drama të dramaturgut italian Tino Caspanello.

Sektori i Rinisë

Gjatë vitit 2019 Sektori i Rinisë ka përmbushur në mënyrë profesionale dhe me përgjegjësi të lartë detyrat dhe obligimet rutinore-administrative të proceduara sipas përshkrimit të paraparë të punës.

Secilin muaj të vitit që nga fillimi kemi vazhduar që të kultivojmë dhe të mirëmbajmë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me të gjitha OJQ-të lokale që kanë në fokus rininë përmes takimeve të shpeshta, ku janë shqyrtuar shqetësimet dhe propozimet e tyre për avancimin e rinisë në Komunën e Gjilanit.

Kemi koordinuar veprimet me organizatat ndërkombëtare dhe institucionet tjera lokale që veprojnë në Komunën e Gjilanit.

Është mbajtur kontakt i rregullt me organizatat e huaja si OSCE, NDI dhe KFOR-i turk, si dhe komunikimi i rregullt nga ana e jonë me ministrinë e linjës, e që në këtë rast është Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport.

- Kemi krijuar Programin Vjetor të Punës së Rinisë për vitin 2019, implementimi i të cilit varet shumë nga gatishmëria e institucioneve të larta për tu përkrahur financiarisht.
- Në muajin janar, në bashkëpunim me KVRL-në kemi organizuar në teatrin e qytetit ligjëratën e prof.dr. Jahja Kokaj me temë “Zbulimet Nobel të vitit 2018”: Lufta kundër Kancerit, ndotjes së ambientit, varfërisë dhe ngrohjes globale”.
- Gjatë muajit shkurt, kemi respektuar afatin ligjor duke organizuar dhe mbikëqyrur mbajtjen e kuvendit zgjedhor të KVRL-së, ku pas një konkurrence të kënaqshme idesh është z.Mehmet Zylfiu që është zgjedhur kryetar i KVRL-së për një mandat të rregullt.
- Gjatë muajit mars, në bashkëpunim me Ballkan Green Foundation kemi organizuar sesionin informues ne lidhje me thirrjen për propozime për grante të vogla & mesme për rininë e Komunës së Gjilanit.
- Muaji prill kemi siguruar hapësirën për realizimin e projektit “Cyber Hackathons”, një garë informatike mes nxënësve me afinitet për IT, të realizuar nga ICT Academy
- Po ashtu në prill në bashkëpunim me DKRS, është prezantuar programi PODIUM nga UNICEF dhe IPKO
- Gjatë muajit maj i është krijuar hapësirë projektit Support Kosovo’s Next Success Story, të realizuar nga RIT Kosovo
- Në muajin qershor kemi marrë pjesë aktive në përzgjedhjen e më të dalluarve të vitit në sektorin e rinisë.
- Në muajin korrik, në bashkëpunim me UNICEF-in është realizuar projekti “ NDIHMA e PARË”

Po vazhdon praktika e komunikimit zyrtar me të gjithë të interesuarit të cilët i janë drejtuar me ndonjë kërkesë të veçantë Njesisë së Rinisë në Gjilan. Gjithë ky proces po ndodh në mënyrë të rregullt dhe në afate të përcaktuara ligjore.

Sektori i Sportit

Dita Olimpike

Më datë 27 Maj, Fëmijët e lindur në vitin e pavarësisë nga shkollat e regjionit të Gjilanit, ishin ata të cilët me vrapimin e tyre garues, nga kazerma e FSK-së deri në sheshin “Agim Ramadani” kanë shënuar Ditën Olimpikë 2019, duke mbushur kështu rrugët kryesore në një distancë të konsiderueshme.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport së bashku me Drejtorinë e Arsimit-Gjilan, Komitetin Olimpik të Kosovës Klubin Alpin Gjilani si dhe Shoqatën e Gjyqtarëve të Gjilanit kemi organizuar këtë vrapim të shkurtër me të gjithë fëmijët të lindur në vitin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Ideja e gjithë kësaj ishte që të njëjtët fëmijë të vrapojnë gjatë gjithë jetës së tyre dhe do të njihen si “Fëmijët e Pavarësisë”, dhe pse dikur do të bëhen prindër e gjyshër!

Pjesëmarrës ishin 650 fëmijë në këtë garë dhe fitues i kësaj gare ishin :

Kategoria e meshkujve

Besir Banushi nga Shkolla ‘Esat Berisha’- Llashticë

Rilind Maliqi” Nazim Hikmet” - Doberqan

Rion Emiri “Thimi Mitko –Gjilan

Ndërsa në kategorinë e femrave fituese ishin:

Elvina Sinani ” Mulla Idriz Gjilani” –Velekincë

Oltesa Zeneli “Ramiz Cernica” –Vrapçiq

Viola Jahiu “Mulla Idriz Gjilani” Velekincë

Shpallja e më të mirit 2018/19

Me qëllim të avansimit të vlerave të mirëfillta sportive, sektori i sportit, duke e përvijuar tashmë një traditë vjetore edhe sivjet ka bërë nominimet për sportistët dhe subjektet më të suksesshme në lëmin e sportit.

Për të qenë sa më profesional dhe për tu shpërblyer në mënyrë sa më meritore për të arriturat e tyre, sektori i sportit, ka formuar komisionin profesional për shpalljen e Laureatëve për periudhën Qershor 2018-Qershor 2019.

Më të mirët e këtij vitit në sektorin e sportit janë më sa vijon:

Shpresat e sportit për vitin 2018/19

Tringa Nevzadi – Klubi i Futbollit të Femrave “Intelektualet” (f) (Futbolliste e dalluar dhe reprezentuese e Përfaqësueses së Kosovës)

Aris Ismajli – Shkolla e Futbollit “Shkëndija” (m) (Golashënuesi më i dalluar në kategorinë e 13 vjeçarve.

Enea Miftari – Klubi i Gjimnastikës “Halil Alidema” (Balerinë e dalluar)

Ezana Sylejmani – Klubi i Karatesë “Dardania” (Karateiste e dalluar)

Dian Maksuti – Klubi i Basketbollit “Drita” (Basketbollist i dalluar)

Endi Surdulli –Klubi i Boksit “Drita” (Boksier i dalluar)

Juniorët më të dalluar 2018/19

Vesa Ibrahim – Klubi i Karatesë “Drita”

Betim Maliqi – Klubi i Karatesë “Katana”

Hatixhe Zejnullahu – Klubi i Karatesë “AS”

Adonit Isufi - Klubi i Hendbollit “Zhegra”

Punëtori Sportiv i vitit 2018/19 Armend Misini (për angazhimet në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe Lidhjen Rajonale të Futbollit)

KLUBI MË I MIRË NË KATEGORINË E PIONERËVE KH “ZHEGRA” (PIONERËT)
– KAMPION I KOSOVËS 2018/19 PËR SË DYTI HERË ME RADHË

REFERI MË I MIRË I VITI 2018/19 – MERVAN BEJTULLAHU- (njëri ndër referët më të dalluar në kampionatin elitare të futbollit kosovarë, drejtues i ndeshjeve më të rëndësishme të kampionatit)

Mirënjohje për VETERANËT E FUTBOLLIT TË GJILANIT

KLUBI MË I DALLUAR I VITIT 2018/19 - KLUBI I VOLEJBOLLIT "DRITA" (F)

TRAJNERI MË I DALLUAR I VITI 2018/19 -Lorik Ilazi- Klubi i Volejbollit "Drita" (fitues i titullit kampion me Klubin Volejbollit DRITA"(F)

Ndër 10 më të dalluarit e vitit 2018/19

10. Nysret Haziri –Klubi i boullingut “AR Katana” (m) (Kampion i Kosovës në garën e boullingut, fitues i Kupës së Kosovës, fitues i Super kupës, fitues i Mastër Kupës, pjesëmarrës në Kampionatin Mediteran dhe Kupën e Kampionëve të Evropës)

9. Ramush Shkodra – Klubi Alpin “Gjilani” (m) (Pushtues i Malit të Olimpmit – Greqi, Maja e Korabit – Shqipëri, Maja e Gjeravicës

8. Ermir Kryeziu – Klubi i Futsallit “Liburni”(m) (Fitues i kupës dhe titullit në futsall, si dhe reprezentues i kombëtares shqiptare në futsall)

7. Yll Sllamniku –Klubi i Hendbollit “Drita”(Golashënues i dalluar)

6.Edonis Maliqi – Klubi i Boksit “Drita” (m). (Kampion i Kosovës, fitues i disa nga turneve të mbajtura në Evropë, pjesëmarrës në Olimpiadën verore në Argentinë, pjesëmarrës në Kampionatin Evropian në Itali)

5.Flamur Grabovci – Bodibilding (m) - Karatisti (Kampion i Kosovës, Medalja e Bronzet në garat Ballkanike)

4.Edison Kqiku – Sport Club “Gjilani” (m) (Futbollist i dalluar i klubit, ish-reprezentues i moshave të Përfaqësueses së Kosovës)

3. Ardian Limani – Klubi Futbollistik “Drita” (m) (Futbollist i dalluar i klubit, fitues i Superkupës së Kosovës)

2.Vesa Shabani – Klubi Vojlebollit “Drita” (f) (Fituese e titullit kampion, fituese e Kupës së Federatës)

1. Linda Zeqiri – Klubi Pingpongut “Drita” (f) (Fituese e kampionatit të Kosovës, reprezentuese e Kosovës).

Post Mortum(mirënjohje)

Dërgut Abdullahu

Muharrem Halimi

Për kontribut jetësorë

Elmaz Bajrami

Rifat Shabani

Me çmim të veçantë e nderon futbollistin e përfaqësueses U21 të Kosovës Mirlind Daku (Sportisti i vitit 2018/19)

1. Elhami Shabani – Klubi Karatesë “Drita”
1. Kampion i Kosovës
2. Kampion Mbarëkombëtarë
3. Vendi i shtatë në Kampionatin Evropian në Spanjë

Më datë 14.06.2019, nën organizimin e sektorit të sportit është organizuar “Shtegu i Lirisë” me fëmijët e lindur në vitin e Pavarësisë

Në Gjilan është mbajtur gara “Shtegu i Lirisë” me fëmijët e lindur në vitin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Pjesëmarrës ishin rreth 400 fëmijë të lindur në vitin 2008 dhe gara nuk kishte karakter garues.

Nisja e kësaj gare filloje nga Batalioni i Parë i Reagimit të Shpejtë të FSK-së, pasi që është simbolikë e veçantë për vlerësimin e lartë për këtë institucion dhe për t’i kujtuar dëshmorët, heronjtë dhe martirët e kombit që u flijuan për ditët e lirisë që Gjilani dhe Kosova po i gëzon tani e 20 vite.

I pari i Gjilanit z. Lutfi Haziri konfirmoi se ky aktivitet me fëmijët e lindur në vitin e Pavarësisë do të jetë tradicional dhe do të mbahet për çdo vit.

Më datë 24 Korrik 2019, në kuadër të organizimit të turneut “Stretball Kosova 2019”, edhe Gjilani ishte mikpritës i kësaj gare mjaft atraktive. Pjesëmarrës ishin 6 ekiye ku ndeshja finale ishte shumë interesante në mes të “AIR FORE ONE” si dhe ekipit “PRO ENG PERLEPNICA” . Fitues i këtij turneu ishte “AIR FORCE ONE” ku edhe siguroj biletën për pjesëmarrje në finalen e madhe që u mbajt në Prishtinë.

Me 28 Korrik 2019, Sektori i Sportit në bashkëpunim me Klubin Alpin Gjilani, në kuadër të ditëve të diasporës që mbahen në Komunën e Gjilanit, për nderë të bashkatdhetarëve së bashku kemi organizua ecjen e bjeshkatave të radhës, të njëjtë si vitet e kaluara 2017, 2018. Edhe këtë vit ecja ishte në Malësinë e Karadakut e cila është ecje e lehtë dhe perfektë për fillestar.

Shtegu nëpër të cilin ecëm është shteg i shkurtër (6-8 KM), i cili fillon nga: Dunav, drejtë malit kufiri Kosovë – Maqedoni dhe shtegu përfundon te fusha lartë kodrës së fshatit Dunav.

Pas përfundimit të ecjes së shtegut dhe arritjes te fusha lartë Majës së Malit të bjeshkëve Dunav ishin të vendosura disa tavolina enkas për pritjen e alpinistëve, ku do të shërbehen me ujë, pije, dhe ushqim dhe do të ketë vend për t’u ulur.

Për herë të parë në Gjilan zhvillohet aktiviteti sportiv “Kids Athletics”

Me datë 27.09.2019, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Gjilan, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka hapur “Java Evropiane e Sportit – be active”, që zë vend në javën e fundit të muajit shtator e që ka për qëllim mbledhjen e përfaqësuesve dhe dashamirët e sportit.

Java evropiane e sportit “Be active” ka karakter zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive, por jo garuese. Aktiviteti i llojit të tillë u zhvillua sot për herë të parë në Gjilan, ku mbledhi 500 nxënës të klasave të pesta me qëllim të argëtimit të tyre përmes lojërave të ndryshme që u zhvilluan në stadiumin ndihmës.

Më datë 14.10.2019, në bashkëpunim me MotoCros 06, kemi organizuar garën në motoçiklizëm Enduro Race 2019 –

Me mbështetjen e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Gjilanit, në Stanishor është mbajtur me sukses gara e motoçiklizmit Enduro Race 2019 – “Ilir Balaj & Manuel Herzog”.

Prezent gjatë këtij evenimenti sportiv ishin shume garues nga shumë shtete të ndryshme .

Fitues sipas kategorisë me radhë janë me sa vijon :

Kategoria E 1 125 2t – 250 4t

1. Meriton Rexhaj -vendi 1
2. Agron Kelmendi -vendi 2
3. Valon Gajtani -vendi 3

Kategoria E 2 250 2t – 450 4t (Profi)

1. Alban Beqiri -vendi 1
2. Arbnor Ukaj -vendi 2
3. Albion Sylaj -vendi 3

Kategoria E 3 Hobi (16/17-vj + 40 vj.)

1. Shukri Maliqi -vendi 1
2. Riad Haliti -vendi 2
3. Lulzim Hysenaj -vendi 3

Klubi më masovik me më së shumti garues pjesëmarrës në garë shpallet MotoCross Theranda – 11 garues pjesëmarrës

Me datën 19,20 tetor 2019, Sindikata e Policisë së Kosovës në Bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, organizoi edicionin e VII-të të lojërave sportive.

Sindikata e policisë së Kosovës në shenjë nderimi dhe respekti për zyrtarët e rënë në detyrë ka organizuar edicionin e VII -të të lojërave sportive në futboll të vogël, në qytetin e Gjilanit.

Më datën 19,20 tetor, u bë edhe zyrtarisht hapja e eventit sportiv në Palestrën e Sporteve “Bashkim Selishta – Petriti” në Gjilan.

Shtatëmbëdhjetë ekipe futbollit nga të gjitha drejtorit e Policisë së Kosovës kanë treguar përgatitjedhe cilësi të larta sportive. Garat do të vazhdojnë edhe ditën e nesërme, me ç ‘rast edhe do të mësohet fituesi.

Të pranishëm ishin familjarët e policëve të rënë në detyrë, eprorë të lartë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, eprorë nga Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës në Gjilan, zyrtarë komunal si: drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Deniza Limani, kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sekretari Eroll Salihu, zv. selektori Muharrem Sahiti, kryetari i Sindikatës për Gjilanin, Ragip Ajeti, komandanti i stacionit policor, Alban Ramushi, kryetarja e sindikatës në nivel qendror, Valbona Kamberi, zv. drejtori i policisë së Kosovës, Dejan Jankovic, zv. drejtori për rajonin e Gjilanit, Shaban Azizi.

Gjithashtu, ta pranishëm ishin edhe kryesitë e sindikatave të policisë nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kroacia.

Më datë 20.10.2019, Federata e Auto sporteve të Kosovës në bashkëpunim me Auto Klubin Gjilani si dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, organizon garën në Auto Slalom Gjilani 2019. Gara është mbajtur në rrugën “Marie Shllaku” në Gjilan dhe është organizuar nga Auto Klubi Gjilani në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, AK Eurogoma RT, AK Gjilani dhe Federata e Auto Sportit e Kosovës (FASK).

Si veçanti e kësaj gare është fakti se kjo garë është zhvilluar në të dyja konkurrencat (meshkuj dhe femra), ndërsa interesimi ishte mjaft i madh nga të dy gjinitë.

Kjo garë solli në qytetin e Gjilanit makina sportive të llojeve të ndryshme, ku paraqiten me atraksionet e tyre të garës dhe me pjesëmarrës nga vende të ndryshme.

Po ashtu, për sigurinë e këtij aktiviteti ishte Policia e Kosovës, Brigada e Zjarrfikësve dhe Ndhima e Shpejtë, ku u ndërmerën të gjitha masat që gara të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme

Më datë 20.10.2019, Klubi i Karatesë Dardania në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, organizoi turneun e XIV-të Ndërkombëtar “Katana Open 2019”

Komuna e Gjilanit, nën përkujdesjen e kryetarit Lutfi Haziri, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, së bashku me Klubin e Karatesë “Dardania - Gjilan”, organizuan turneun e XIV-të Ndërkombëtar të Karatesë “Katana Open 2019”.

Turneu u mbajt të dielën në Palestrën Sportive “Bashkim Selishta – Petriti” në Gjilan.

Klubi i Karatesë Dardania nga Gjilani dëshmoi se është një klub i madh jo vetëm vendor por edhe ndërkombëtar, duke shfaqur profesionalizëm në organizim të aktiviteteve të mëdha të karatesë.

Organizatori për më të mirët ka ndarë shpërblime duke dhënë medalje dhe kupa të ndryshme për të gjitha kategoritë fituese të këtij turneu.

Pjesëmarrës ishin shumë shtete si: Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi si dhe dy ekipe nga Lugina e Preshevës.

Më datë 08.12.2019, Klubi i Boksit “Drita”, nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Gjilanit z.Lutfi Haziri, organizoi turneun memorial ndërkombëtar të boksit “Agim Rashiti”.

Ish-boksieri i Dritës, Agim Rashiti, ishte vra para 30 vitesh nga forcat serbe me 28 mars të vitit 1989 në oborrin e Spitalit Regjional të Gjilanit.

Në turneun e madh të këtij memoriali të boksit në shenjë të përkujtimit të Agim Rashitit, i cili u mbajt më 8 dhjetor në Palestrën e Sportive "Bashkim Selishta-Petriti" në Gjilan, marrin pjesë shumë boksier cilësor.

Pjesëmarrjen në këtë turne me cilësi të larta ishin boksierët më të mirë të këtyre shteteve: Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja Hercegovina.

RAPORTET E PUNËS SË ZYREVE DHE NJËSIVE

I. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Zyra e prokurimit gjatë periudhës janar –dhjetor të vitit 2019 sipas kërkesave nga Njësit kërkuese ka zhvilluar procedura të prokurimi për vitin 2019 gjithsej 138 aktivitete.

Aktivitete të zhvilluara në ZP:

Vlera Financiare e Kontratave të Nënshkruara gjatë vitit 2019 është si vijon :

- Kontrata Punë gjithsej 37 Kontrata të Nënshkruara në vlerë prej 15,259,568.95 euro
- Kontrata Furnizim gjithsej 38 Kontrata të Nënshkruara në vlerë prej 1,609,104.65 euro
- Kontrata Shërbim gjithsej 25 Kontrata të Nënshkruara në vlerë prej 2,753,716.50 euro
- Vlera Minimale gjithsej 33 Kontrata të Nënshkruara në vlerë prej 29,399.55 euro
- Konkurse të Projektimit gjithsej 5 Kontrata të Nënshkruara në vlerë prej 177,591.00 euro
- Ankande Publike në vlerë prej 106,329.59 euro
- Vlera totale Financiare e Kontratave të Nënshkruara gjatë këtij Viti Fiskal 19,935,710.24 euro.

Ndërsa, për aktivitetet të cilat janë në procedurë të bartura nga viti 2019 do të vazhdoj t'i realizoj sipas afateve dhe rregullave ligjore të LPP-së.

Gjatë kësaj periudhe zyra e prokurimit ka përgatitur vendimet lidhur me kërkesat për rishqyrtim të parashtruara nga OE, ku vlen të theksohet se shumë prej tyre pas pranimit të përgjigjeve nga AK të cilat kanë qenë bindëse dhe të argumentuara, OE janë pajtuar dhe nuk kanë parashtruar ankesë në OSHP.

Ndër tjera mund të specifikojmë në detale numrin e kërkesave për rishqyrtim si dhe ankesat drejtuar OSHP nga ana e OE :

Nr. Total i Vendimeve sa i përket OSHP gjithsej është 19

Vendimi i OSHP në favor të autoritetit kontraktues është 7

Vendimi i OSHP jo në favor të autoritetit kontraktues është 12

II. NJËSIA E KUVENDIT

Bazuar në Planin e punës së Njesisë së Kuvendit dhe Planin e punës të Kuvendit për periudhën JANAR-DHJETOR 2019, Njësia e Kuvendit ka kryer këto aktivitete:

- Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të rregullta të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, bazuar në orarin vjetorë për mbajtjen e seancave të KK-Gjilan,
- Përgatitja profesionale dhe teknike e seancave të jashtëzakonshme, të cilat KK-ja i ka mbajtur sipas nevojës, (në këtë periudhë raportuese nuk ka pasur asnjë seancë të jashtëzakonshme)
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në Kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve,
- Përcjellja e takimeve dhe mbajtja e procesverbaleve të KK-së dhe Komisioneve tjera të formuara nga KK-ja,
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Zyrës së Kryetarit dhe organeve tjera komunale, si dhe përkthimi simultan i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale,
- Dërgimi në MAPL i raportit mujor, për të gjitha aktet dhe shkresat e përkthyer të lëshuara nga Institucionet komunale,
- Lekturimi i të gjitha materialeve të Kuvendit dhe Komiteteve dhe materialeve e akteve tjera të KK-së,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha materialeve për seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takimeve tjera të institucioneve komunale, në formë fizike dhe elektronike,
- Përgatitja teknike e Sallës së Kuvendit, kujdesi për mirëmbajtjen e aparaturës për zërim dhe incizimi përmes kamerës dhe incizimi tonik i seancave.
- Njoftimi me kohë i anëtarëve të Kuvendit për mbajtjen e seancave të KK-së,
- Dërgimi i të gjitha vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,
- Dërgimin e raporteve të rregullta mujore në MAPL për të gjitha aktet e miratuara nga KK-Gjilan si dhe dërgimi i të gjitha akteve të nxjerra nga Kryetari i Komunës, në MAPL për vlerësim të ligjshmërisë së të njëjtave,
- Ekspedimi me kohë i të gjitha vendimeve, rregulloreve, rekomandimeve e akteve tjera brenda institucioneve komunale, me qëllim të implementimit të tyre.,
- Bashkëpunimi brenda institucioneve komunale dhe me organet qeveritare dhe ministritë tjera të linjës, në funksion të mbarëvajtjes së funksionimit sa më të mirë të organeve komunale.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, Kuvendi dhe Komitetet e KK-së kanë mbajtur takimet si në vijim:

- Kuvendi ka mbajtur 11 seanca të rregullta, një të jashtëzakonshme dhe një solemne dhe ka miratuar 64 vendime, prej të cilave 4 rregullore, (Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe shpërblimeve, Rregulloren për themelimin dhe strukturën e asamblesë komunale të fëmijëve dhe Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale dhe Rregulloren për Transparencë të Komunës së Gjilanit)
- Komiteti për Politikë dhe Financa, ka mbajtur 11 mbledhje dhe ka nxjerr 63 Rekomandime për miratim në Kuvend

- Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka mbajtur, 8 takime dhe ka nxjerr 6 rekomandime
- Komiteti për Komunitete, ka mbajtur 8 takime dhe ka nxjerr 2 rekomandime
- Komiteti për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ka mbajtur 4 takime dhe ka nxjerr 5 rekomandime
- Komiteti për Shërbime Publike, Banim, Mbrojtje dhe Shpëtim, ka mbajtur 3 dhe ka nxjerr 2 rekomandime
- Komiteti për Arsim, ka mbajtur 10 takime dhe ka nxjerr 5 rekomandime
- Komiteti për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ka mbajtur 5 takime dhe ka nxjerr 6 rekomandime
- Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, ka mbajtur 11 takime dhe ka nxjerr 29 rekomandime
- Komiteti për Zhvillim Ekonomik dhe Agrikulturë, ka mbajtur 6 takime dhe ka nxjerr 6 rekomandime
- Komiteti për Barazi Gjinore, ka mbajtur 9 takime dhe ka nxjerr 6 rekomandime
- Komiteti për Bashkëpunim Ndërkufitarë, ka mbajtur 6 takime dhe ka nxjerr 3 rekomandime
- Komiteti konsultativ i Ekspertëve të planifikimit Hapësinor, ka mbajtur 3 takime dhe ka nxjerr 2 rekomandime
- Komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuar, ka mbajtur 7 takime dhe ka nxjerr 16 rekomandime
- Këshilli për vlerësimin e meritave ka mbajtur 2 takime dhe ka nxjerr 4 rekomandime
- KKSB ka mbajtur 6 takime-dhe ka nxjerr 3 rekomandime
- Debate publike për Rregulloret komunale janë mbajtur 6
- Debate për Buxhet janë mbajtur 10

Njësia e Kuvendit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019, nga bashkëpunimi që ka pasur me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të akteve të dërguara, konfirmim negativ kemi marr vetëm për Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoha komunale, (harmonizimi me Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje si dhe me Udhëzimin Administrativ 02/2018 për taksat administrative, leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifat për rregullimin e Infrastrukturës) për çka KK në afatin ligjor e ka zbatuar sugjerimin e MAPL.

III. NJËSIA E PERSONELIT

Njësia e personelit merret kryesisht me menaxhimin e burimeve njerëzore të cilët janë pasuria kryesore e një organizate buxhetore.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është proces i cili tejkalon kufijtë e njësive buxhetore dhe përbëhet nga disa komponentë edhe atë:

Planifikimi, punësimi, menaxhimi i performancës, trajnimi dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë.

Po ashtu Njësia e personelit bënë mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave ligjore dhe akteve nënligjore, kryesisht nga marrëdhënia e punës dhe procedura administrative, duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet e saj me Kryetarin e Komunës dhe drejtoritë përkatëse lidhur me zbatimin e përgjegjësive të Komunës, të cilat rrjedhin nga ligjet dhe aktet nënligjore nga sfera e marrëdhënies së punës dhe pagave të SHC.

Andaj, Njësia e personelit në kuadër të planit të saj punues këtë vit ka kryer aktivitetet punuese si në vijim:

- akt emërimi - 83,
- kontrata në vepër dhe kontrata tjera - 305,
- 8 konkurse për 50 pozita me gjithsej 111 dokumente përcjellëse,
- vendimeve të ndryshme - 211
- takime pune – 54,
- vërtetime të ndryshme - 63,
- pushime mjekësore - 94,
- pushime vjetore- 426,
- raporte dhe procesverbale - 19,
- seanca të komisioneve - 13,
- shkresa - 80,
- njoftime - 35,
- përgjigje - 14,
- ftesa, kërkesa të ndryshme - 39,
- plotësimi i formularëve për MAP -200,
- konsultime me zyrtarë dhe të tjerë 95,
- aktivitete të ndryshme 333,
- janë përpunuar, skanuar dhe regjistruar në SIMBNJ dosje - 17,
- marrëveshje për shërbime të veçanta - 26,
- skanuar dhe kopjuar dokumente 670,
- shërbime dhe këshilla të ndryshme - 456.

Aktivitetet shitesë:

- Mbajtja e përhershme e evidencës së punëtorëve të Komunës përmes sistemit elektronik;
- Menaxhimi me lista të pagave së Shërbyesve civil;
- Menaxhimi me stafin në aspektin e mbajtjes së trajnimeve të ndryshme;
- Raportimi nivelit qendror; MAPL dhe MAP për numrin e punëtorëve sipas gjinisë, kualifikimit, etnitetit etj;
- Përgatitja e formularëve: për punëtorë të ri, ndryshime, të larguar, retroaktive dhe dërgimi i tyre në Ministrinë e Administratës Publike - Divizioni i pagesave, Prishtinë;
- Ofrimi i të dhënave për auditorin e brendshëm, jashtëm dhe KPMSHCK;
- Përpunimi dhe azhurimi i listës së SHCK;
- Nxjerrja e të dhënave financiare të SHCK për buxhetin 2019;
- Pjesëmarrja në hartimin e buxhetit 2020;
- Bashkëpunimi me të gjithë drejtoritë komunale sa i përket aspektit të nëpunësit civil;
- Përgatitja e konkurseve, publikimi i tyre dhe zhvillimi i procedurave rekrutuese konform konkurseve, si dhe përmes SIMBNJ;

- Organizimi i punëve të Komisionit disiplinor dhe Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të Komunës.
- Shfrytëzimi i pushimeve vjetore, mjekësore, vdekjes, lehonisë, etj. përmes SIMBNJ
- Përpunimi i dosjeve të nëpunësve civil dhe futja e dosjeve në SIMBNJ
- Pjesëmarrja në trajnime rreth SIMBNJ, monitorimit të performancës
- Pjesëmarrje në hartimin e Planit të integritetit dhe Kodit të etikës për Komunën e Gjilanit, etj.

IV. NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Raporti pasqyron përmbledhjen e punëve të Njesisë Komunale për të Drejtat e Njeriut për periudhën Janar -Dhjetor 2019.

Në raport janë prezantuar aktivitetet që pasqyrojnë dhe reflektojnë angazhimin dhe rezultatet e shënuara gjatë kësaj periudhe të cilat i trajton Njësia për të Drejtat e Njeriut.

Si mekanizëm përgjegjës NJDNJ, promovon dhe mbron të drejtat e njeriut në nivelin komunal.

Monitoron përputhshmërinë e respektimit të standardeve për të Drejtat e Njeriut në këto fusha: mundësi të barabarta, mbrojtje nga diskriminimi, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve, personat me nevoja të veçanta, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve dhe kundër trafikim me qenie njerëzore e të tjera.

Koordinatori dhe zyrtaret e NJDNJ gjatë kësaj periudhe 1 vjeçare kanë monitoruar seancat e Kuvendit, Komiteteve dhe takime të tjera të organizuara në kuadër të komunës.

Zyrtarja për barazi gjinore si anëtare e Komisionit për sistemin e menaxhimit të performancës komunale në fushën e të drejtave të njeriut, gjatë muajit janar të vitit 2019 ka mbledhë të dhënat e të punësuarve për vitin 2019, të ndara sipas kategorisë duke përfshirë numrin total, strukturën gjinore dhe etnike për të gjithë të punësuarit në institucionet komunale.

Zyrtarët e NJDNJ-së, morën pjesë në takimin e organizuar më 17 janar në “Swis Diamond” ku u lansua raporti me temë” Strehimoret për viktimat e dhunës në familje në Kosovë”.

Në muajin shkurt zyrtarët e NJDNJ-së morën pjesë në punëtorinë në qytetin e Vlorës në kuadër të projektit SoR-i të mbështetur nga Giz-i, “Shërbimet sociale për grupet vulnerabël” ku prezent ishin 2 komuna të Kosovës, Gjilani dhe Ferizaj dhe 2 komuna të Shqipërisë, Elbasani dhe Vlora.

Përmes këtij projektit është synuar që të arrihet ngritja e vetëdijes së qytetarëve për përfitimin e shërbimeve sociale nga komuna në një rën anë si dhe ngritjes së bashkëpunimit të zyrtarëve komunal në adresimin e problematikave që kanë të bëjnë me grupet e cenushme.

U shënuar 17 Shkurti Dita e Pavarësisë, me aktivitete të ndryshme nga zyrtarët e NJDNJ, Asambleja e Fëmijëve dhe nxënësit e SHFMU të Komunës së Gjilanit.

Për nderë të “**7 Marsit Ditës së Mësuesit**”, Zyrtarja për të drejtat e fëmijëve me Asamblenë e Fëmijëve kanë realizuar vizitat në SHFMU “Rexhep Elmazi”, “Musa Zajmi”, “Selami Hallaqi”, “Abaz Ajeti” dhe “Thimi Mitko” ku fëmijëve me aftësi të kufizuara u shpërndanë dhurata.

8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas u shënuar me aktivitete:

- Vizitë Policisë së Kosovës
- U mbajt tryeza me temë:
“Rëndësia e aktivizimit të gruas në shoqëri”
Vizitë në strehimore për mbrojtjen e gruas dhe fëmijës “Liria”

NJDNJ, pas disa takimeve, punëtorive dhe dëgjimit publik të organizuar më 8 mars për draft rregulloren mbi themelimin dhe strukturimin e asamblesë së fëmijëve të Komunës së Gjilanit, Kuvendi Komunal i Gjilanit më 28 mars 2019 miratoi **Rregulloren mbi Themelimin dhe Strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.**

Më 15 mars u mbajt takimi regjional me anëtarët e mekanizmave kundër dhunës në familje, ku u dhanë udhëzimet për grumbullimin e të dhënave për indikatorët e Objektivave Strategjike të Planeve Lokale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Pjesëmarrja e zyrtarëve të NJDNJ-së më 19 mars, në takimin e Koalicionit për Barazi me temë: Fuqizimi i Grave në Politikë, ku u theksua nevoja e organizimit të takimeve nëpër lokalitete të ndryshme për të diskutuar për përkrahjen e grave në politikë, për t’u përgatitur për zgjedhjet e ardhshme që të kemi sa më shumë gra në vendimmarrje.

NJDNJ, në kuadër të projektit SOR-i mbështetur nga GIZ- implementuar nga OJQ Inpo më 26 mars realizuan dëgjimin publik “Informimi dhe promovimi në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve”. ZDF me Asamblenë e Fëmijëve për nderë të **26 Marsit- “Ditës Ndërkombëtare të Ujit”** realizuam vizitën në KRU-Hidromorava.

Në muajin prill zyrtarët e NJDNJ-së morën pjesë në tryezën rajonale të organizuar nga OSBE për promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal si dhe punëtorinë me temë: Kuadri ligjor dhe i politikave për dhunën në familje në Kosovë

ZBGJ mori pjesë në trajnimin 3 ditor në Durrës me temë: “Parandalimi i dhunës në familje dhe trajtimi i rasteve të dhunës sipas Konventës së Stambollit.

ZBGJ mori pjesë në të gjitha takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe në takimet e Komitetit për Barazi Gjinore gjatë periudhës 1 vjeçare.

Më 15 maj u shënua “Dita Ndërkombëtare e Familjes”, ku GP i komunës në kuadër të projektit SOR-i të mbështetur nga Giz, realizuan vizita në familjet me nevoja sociale ku gratë janë nëna vetushqyese, me ç ‘rast u njoftuan për shërbimet sociale që ofron komuna për këto kategori dhe ju dhuruan pako ushqimore dhe veshmbathje.

Më 20 maj ZBGJ, në bashkëpunim me OSBE-në dhe Komisionin për themelimin e këshillave lokale, organizuan takimin konsultativ me këshilltarët komunale gra, Komitetin për Barazi Gjinore dhe gratë aktive të komunës me qëllim që të lobohet dhe njëherë të kërkohet që këshillat lokale të kenë përbërje gjinore 50%-50%, në mënyrë që të zbatohet Kushtetuta, Ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Zyrtarja për të Drejta të Fëmijëve në bashkëpunim me Asamblenë e Fëmijëve shënuan **“1 Qershori Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”**

- Vizitë Policisë së Kosovës nga Asambleja e Fëmijëve

➤ Vendorsja e Panos para Teatrit të qytetit.

Aktivitet për shënimin e Ditës Botërore kundër duhanit nga ISHP

-Spitali Rajonal Gjilan në bashkëpunim me AF.

- Realizimi i aktiviteteve me Asamblenë e Fëmijëve, nxënësit e të gjitha komuniteteve dhe nxënësit me aftësi të kufizuara të SHFMU të Komunës së Gjilanit.
- Vizitë fëmijëve në repartin e Pediatriisë në Spitalin Rajonal të Gjilanit – shpërndarja e dhuratave për fëmijët.
- Vizitë Çerdhes “Poema”.
- Pjesëmarrja e fëmijëve në Teatrin Magjik në premierën dhe shfaqjen për fëmijë “Beli, Blerta dhe Balena Blu”

NJDNJ në bashkëpunim me Asamblenë e Fëmijëve, GP- në kuadër të projektit Sor-i- GIZ, QRSHP, DSHMS, Policia e Kosovës, FSK, DKA shënuan **26 qershorin “Ditën Botërore kundër Abuzimit dhe trafikimit me droga”** me aktivitete:

- Realizimi i shfaqjes
- Shpërndarja e fletushkave dhe vizatimeve të punuara nga vetë fëmijët prezent.

Mbajtja e takimeve të rregullta të Asamblesë së Fëmijëve, pjesëmarrja e Asamblesë së Fëmijëve në aktivitete të ndryshme për **“Ditët e Diasporës”**.

Takimi i shkëmbimit të përvojave të Asamblesë së Fëmijëve të Komunës së Gjilanit e realizuar në Prizren me Asamblenë e Fëmijëve të Prizrenit, me këtë rast u vizituan vendet historike në Prizren.

Pjesëmarrja e ZBGJ në trajnimin për Konventën e Stambollit, organizuar nga OJQ “Medica”

Zyrtarët e NJDNJ-së më **25 Tetor 2019** është mbajtur një fushatë vetëdijesuese para Teatrit të Qytetit të Gjilanit **për kancerin e gjirit**, është një fushatë vjetore ndërkombëtare që synon të shpërndajë informacion dhe të edukoj njerëzit për rëndësinë e shëndetit të gjirit, për zbulimin e mëhershëm të kancerit të gjirit, te gratë dhe vajzat në të gjithë botën

NJDNJ- ka shënuar 20 nëntorin **“Ditën Ndërkombëtare e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve”** me aktivitete te shumta duke filluar vizitat nga Asambleja e Fëmijëve në tri SHFMU: “Selami Hallaqi”, “Thimi Mitko” dhe “Rexhep Elmazi” pastaj aktiviteti i Çerdhes ku fëmijët kanë përgatitur 120 pako dhurata për fëmijët me nevoja të veçanta.

NJDNJ më 25 nëntor hapi fushatën **“16 ditë të aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas”** në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave dhe Vajzave me aktivitete:

- Shpalesja e Panos me moton “Zbatimi i Normave – Ndryshimi i Mendësisë”
- Shpërndarja e fletëpalosjeve dhe fanellave me mesazh kundër dhunës në familje.

- Tryezë diskutimi e organizuar nga OSBE ku u lansua Anketa për Mirëqenien e Gruas në Kosovë dhe u prezantua roli i Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje në Komunën e Gjilanit nga ZBGJ.
- Organizimi i ligjëratave nga anëtarët e MKKDHf në fshatin Dobërçan të Komunës së Gjilanit me temë: “Roli i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe rëndësia e raportimit të rasteve të dhunës në familje”.

NJDNJ-zyrtarja për të Drejtat e Fëmijëve, Asambleja e Fëmijëve morën pjesë në shënimin e 3 dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, organizuar nga shoqata Handikos, me aktivitete të ndryshme nga fëmijët e Handikosit, SHFMU “Thimi Mitko” dhe Asambleja e Fëmijëve me ç ‘rast u realizua një program për fëmijët e vegjël me nevoja të veçanta.

Gjilani ka bërë edhe një progres në avancimin e të drejtave të kësaj kategorie, duke e themeluar Komitetin Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuar.

10 Dhjetori Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut

NJDNJ për nder të kësaj dite, u vizitua nga disa nxënës të SHFMU “Thimi Mitko”, ku diskutuan për të drejtat e njeriut e posaçërisht për të drejtat e fëmijëve.

10 dhjetor – takimi i fundit për këtë vit i zyrtares për të Drejtat e Fëmijëve dhe Asamblesë së Fëmijëve me OJQ-“Syri i Vizionit” dhe “Save the Children” , bisedë në lidhje me punën dhe aktivitetet vjetore të Asamblesë së Fëmijëve – Gjilan dhe Roli i Asamblesë së Fëmijëve në shkollat e tyre.

Gjate periudhës 1 vjeçare janë mbajtur 5 takime të mekanizmit kundër dhunës në familje të cilin e koordinon ZBGJ. Takimi i fundit i Mekanizmit Kundër Dhunës në Familje u mbajt më 24 dhjetor, ku u diskutuan sfidat dhe problemet që i hasin institucionet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Sa i përket numrit të rasteve të raportuara, rezulton me ngritje të raportimit diku rreth dhjetë raste më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Gjithashtu gjatë këtij takimi u nxorën rekomandimet për Zyrën e kryetarit për mbështetje të institucioneve në mbarëvajtje më efikase të punëve, trajtim të dinjitetshëm për viktimat dhe trajtim psikiatrik për kryerësit e dhunës kur ajo është e nevojshme.

Pjesëmarrja e ZBGJ në takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe takimet e Komitetit për Barazi Gjinore, ku çdo 6 muaj iu ofron raport për punët e realizuara dhe planin vjetor të punës së ZBGJ.

Zyrtarët e NJDNJ-së gjatë periudhës 1 vjeçare morën pjesë në tryeza, punëtori, trajnime, dëgjime publike, vizita të organizuara nga MAPL, ABGJ, ZQM, OSBE, UN-women, USAID, Helvetas, Syri i Vizionit, Save the children, GIZ etj.

NJDNJ bashkëpunon ngushtë në kryerjen e detyrave dhe realizimin e projekteve me OJQ vendore dhe ndërkombëtare.

V. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për vitin 2019 punën e vetë e ka bazuar në Planin Strategjik për vitet 2019 -2021 dhe Planin Vjetor për vitin 2019. Plane këto të aprovuara nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.

Brenda këtij viti NJAB-ja, ka arritur ta realizoi plotësisht Planin Vjetor, duke i kryer 12 auditime, aq sa kanë qenë të planifikuara për vitin 2019 (*duke e përfshirë edhe auditimin për rishikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve*).

Pas rishikimit të zbatueshmërisë së rekomandimeve për auditimet e kryera kemi arritur të të gjeturat se gjatë vitit 2019 në **11** auditimet e kryera janë dhënë gjithsejtë **24** rekomandime. Prej tyre katër (**4**) rekomandime kanë qenë të përsëritura nga auditimet e kaluara dhe **20** rekomandime të reja.

Sipas prioriteteve kemi vlerësuar se prej gjithsejtë 24 rekomandimeve, me prioritet të lartë janë vlerësuar **20** rekomandime, kurse **katër** rekomandime me prioritet të mesëm.

Ndërsa, verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve është bërë vetëm për **21** rekomandime, me që **tri (3)** rekomandime janë dhënë në **dy** auditimet e përfunduara krejt në fund të muajit dhjetor të vitit 2019 (*auditimi i menaxhimit të pasurisë komunale dhe auditimi në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik*), ashtu që përcjellja e zbatueshmërisë së tyre do të bëhet në tremujorin e parë të vitit 2020.

Prej 21 rekomandimeve të verifikuara (*tri të përsëritura dhe 18 rekomandime të reja*):

- plotësisht janë duke u implementuar 13 rekomandime, apo 61.91%,
- në proces janë shtat (7) rekomandime, apo 33.33%,
- ndërsa një (1) rekomandim ende nuk është duke u implementuar, apo 4.76%.

Brenda vitit 2019 janë kryer këto auditime:

1. Auditimi në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme,
2. Auditimi i Procesit të Shpenzimeve në tërë Administratën Komunale (*me përjashtim të drejtorisë së Arsimit dhe Shëndetësisë, ku te këto drejtori kryhen auditime të veçanta*),
3. Auditimi në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
4. Auditimi në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport,
5. Auditimi në Shërbimin e Autoparkut,
6. Auditimi në Drejtorinë për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim,
7. Auditimi në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
8. Auditimi në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa – Sektori i Tatimit në Pronë dhe
9. Auditimi në Zyrën e Prokurimit,
10. Auditimi për Menaxhimin e Pasurisë Komunale,
11. Auditimi në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik dhe

12. Auditimi për rishikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

E gjithë kjo është arritur me një angazhim të shtuar të stafit të NJAB-së dhe me një bashkëpunim të mirë me të gjitha menaxhmentet e subjekteve të audituara.

Angazhimet e menaxhmentit të Komunës gjithsesi kanë pasur ndikim në dhënien e numrit më të vogël të rekomandimeve, por megjithatë niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve ende nuk e ka arritur nivelin e pritjeve tona.

Rekomandimet e dhëna në të gjitha auditimet e kryera kanë ndikuar në evitimin apo përmirësimin e të metave të identifikuara në disa procese apo sisteme si në fushën e prokurimit, zbatimit të kontratave për punë, menaxhimit të pasurisë komunale, shfrytëzimit të parasë publike etj.

Zbatueshmëria e rekomandimeve ka pasur ndikime financiare pozitive për Komunën në aspektin e zvogëlimit të shpenzimeve, rritjes së shkallës së inkasimit të të hyrave nga Tatimi në Pronë, në arsyetimin e subvencioneve të dhëna, si dhe në aspektin e ngritjes së nivelit të kontrollit të brendshëm te proceset e ndryshme.

Aktivitetet e tjera të cilat janë planifikuar ose janë realizuar për zhvillimin e auditimit të brendshëm në kuadër të Komunës (shkurtimisht):

- Në fillim të vitit 2019 është përgatitur Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2018. Pastaj gjatë fillimit të muajit prill ka pasur angazhime lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm të dhëna në vitin 2018 dhe rekomandimeve të Auditorit të Zyrës Kombëtare të dhëna në Raportin e vitit 2017. Gjithashtu edhe në muajin korrik dhe dhjetor, NJAB-ja ka pasur angazhime lidhur me verifikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Auditorit të Brendshëm të dhëna në vitin 2019.

Për të gjeturat gjatë këtyre verifikimeve lidhur me zbatueshmërinë e rekomandimeve janë përgatitur Raporte të cilat i janë dorëzuar Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit.

- Janë mbajtur katër takime të rregullta me Komitetin e Auditimit të Brendshëm, ku është shqyrtuar Raporti Vjetor i NJAB-së për vitin 2018, Raportet e NJAB-së të përfunduara në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2019, si dhe Planet e NJAB-së (*Plani Strategjik për vitet 2020-2022 dhe Plani Vjetor për vitin 2020*).
- Edhe këtë vit pas plotësimit final të Pyetësorit vet-vlerësues për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, drejtori i NJAB-së sipas sugjerimit të auditorit të ZKA-së ka bërë rishikimin e këtij pyetësori, për çka ka përgatitur një informatë për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Komisionit për plotësimin e këtij pyetësori duke u rekomanduar që ky pyetësor të shqyrtohet nga Këshilli i Drejtorëve me qëllim të informimit me përgjigjet e dhëna ndaj 106 pyetjeve (të ndara në pesë komponent), ashtu që në komponentët e vlerësuar me pikë më të ulëta (1 apo 2) të rrisin angazhimet dhe veprimet e tyre për përmirësimin e atyre fushave.

- Nga fundi i muajit mars drejtori i NJAB-së me përzgjedhjen e MF- NJQHAB dhe me aprovimin e Kryetarit të Komunës ka qenë i angazhuar në cilësinë e mentorit për një kandidatë e cila ka qenë në fazën e certifikimit kombëtar për auditim të brendshëm. Kandidatja është dashur t'i kryej dy auditime praktike për të fituar të drejtën e provimit me gojë. Auditimet janë kryer në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe në Shërbimin e Autoparkut.
- NJAB-ja ka pasur angazhime dhe aktivitete të ndryshme me përfaqësuesit e Projektit TEAM (Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse), me ç' rast drejtori i NJAB-së, së bashku me këshilltaren për auditim në kuadër të Programit TEAM ka bërë rishikimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e Pasqyrave Financiare për vitin 2016 dhe 2017.
Edhe në gjashtëmujorin e dytë kanë vazhduar angazhimet dhe aktivitetet e ndryshme me përfaqësuesit e Projektit TEAM (Komuna Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse), me ç' rast është bërë rishikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e Pasqyrave Financiare për vitin 2018. Rezultat i kësaj është emërimi i një ekipi punues për monitorimin e zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit, ku koordinatori i këtij ekipi ka raportuar Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe Menaxhmentin e lartë të Komunës për gjendjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve.
- Drejtori i NJAB-së me 19.06.2019 ka marrë pjesë në Tryezën me udhëheqësit e Njësive Komunale të auditimit të brendshëm me temë: Proceset audituese – Ndarja e përvojave, të organizuar nga USAID-Projekti TEAM dhe Njësia Qendrore, Harmonizuese për Auditim të Brendshëm.
- NJAB-ja në tremujorin e tretë ka bërë rishikimin, plotësimin dhe harmonizimin e Statutit të NJAB-së me legjislacionin aktual, i cili Statut është aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Komitetit të Auditimit.
- NJAB-ja ka përgatitur Planin Strategjik për vitet 2020-2022 dhe Planin Vjetor për vitin 2020, të cilat Plane janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit.
- Drejtori i NJAB-së ka marrë pjesë në trajnimin me temë:
 - Programi për Sigurimin e Cilësisë dhe Planifikimin e bazuar në rrezik për auditorët e brendshëm (organizuar nga projekti TEAM-USAID),
 - Menaxhimi i Pasurisë Komunale (organizuar nga DEMOS/MAPL),
- Si aktivitete tjera mund të ceket ofrimi i ndihmave profesionale të vazhdueshme për të gjitha Drejtoritë Komunale që kanë shfaqur interesim dhe nevojë.

Sfidat:

Edhe në këtë vit sfidë kryesore e NJAB-së ka qenë realizimi i tërësishëm i Planit Vjetor për vitin 2019, duke i realizuar objektivat kryesore të auditimit, e që kanë pasur të bëjnë me ofrimin e ndihmës menaxhmenteve të drejtorive komunale për ngritjen dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme në sistemet dhe proceset e tyre ku ata janë përgjegjës. Kemi arritur që të gjitha

objektivat e planifikuara për auditim t'i realizojmë plotësisht, përkundër asaj se kanë pasur një fushëveprim mjaftë të gjerë dhe kompleks.

Sfidë e veçantë këtë vit ka qenë auditimi i proceseve të prokurimit nga sistemi i E-Prokurimit *(me që nuk kemi pasur trajnime të mjaftueshme lidhur me përdorimin e sistemit E-Prokurimi)*.

Në secilin auditim të kryer, pos të gjeturave menaxhmentit të Drejtorisë së audituar i janë dhënë edhe rekomandime për përmirësimin e proceseve dhe sistemeve, duke u bërë në vazhdimësi përcjellja e zbatueshmërisë së atyre rekomandimeve.

Edhe pse numri i rekomandimeve të dhëna në këtë vit ka qenë më i vogël në krahasim me vitet e tjera, edhe më tutje sfidë e vazhdueshme mbetet mos zbatimi i plotë i të gjitha rekomandimeve të dhëna. Andaj kërkohet në vazhdimësi një angazhim më konkret i menaxhmenteve të Drejtorive Komunale dhe menaxhmentit të lartë të Komunës lidhur me implementimin e rekomandimeve të dhëna si nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Auditimit, ashtu edhe nga Auditori i Brendshëm.

Punët Kryesore në vazhdim:

Deri me 15.01.2020 NJAB-ja duhet t'i dorëzoi Raportin e punës për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2019 dhe Raportin Vjetor: Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njësisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm në kuadër të Ministrisë së Financave.

Më pastaj fillojnë auditimet e planifikuara sipas Planit Vjetor të vitit 2020.

VI. ZYRA LIGJORE

Po ju ofrojmë raportin e punës së **Zyrës Ligjore** për periudhën janar –dhjetor **2019**.

Raporti përfshinë aktivitet kryesore si më poshtë:

1. Hartimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale nr. 016-126416 dt. 29.12.2016.
2. Hartimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Rregulloren për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Gjilanit nr. 01.16-59035 të dt. 27.06.2013.
3. Hartimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve 01. nr. 016-126660 të dt. 26.11.2018.
4. Hartimi dhe miratimi i Rregullores për konstituimin dhe themelimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve
5. Harmonizimi i rregullores për transparencë

Aktivitetet tjera:

1. Projekt - kontratë/marrëveshje mirëkuptimi, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-**83**
2. Vendime të hartuara, ndryshimi dhe plotësimi i tyre-**179**
3. Përgjigje në shkresa/kërkesa/ankesa -**6**
4. Qarkore ligjore-**5**

5. Opinione ligjore-16
6. Konsultime/këshilla ligjore-juridike-21
7. Shkresa/njoftime dërguar organeve dhe institucioneve lokale dhe qendrore -5
8. Urdhëresa të hartuara- 2
9. Debate/Dëgjime publike për akte të ndryshme-7

Numri i aktiviteteve, gjithsej 328.

Lekturimi: në kuadër të Zyrës ligjore janë kontrolluar **1204** faqe, gjegjësisht **268** dokumente të ndryshme të Administratës Komunale.

VII. ZYRA PËR INFORMIM

Zyra për Informim Publik (ZIP) ka komunikuar me qytetarët përmes formave të ndryshme në më shumë se 600 raste në periudhën janar – dhjetor 2019, edhe atë përmes komunikatave për media, ftesave për aktivitete publike, njoftime.

Që të gjitha janë publikuar në afat rekord dhe në mënyrë profesionale në web faqen zyrtare të Komunës dhe në faqen tjetër në rrjetin social Facebook. (mesatarisht 3 komunikata për media për ditë pune).

ZIP, gjatë periudhës një vjeçare, ka organizuar dy cikle të konferencave për media, me ç’rast është paraqitur puna e ekzekutivit në vazhdimësi.

Zyra për Informim, punë shumë e madhe ka bërë në aspektin e Qasjes në Dokumente Publike, ku për këtë periudhë kanë ardhur 54 kërkesa dhe që të gjitha kanë pasur përgjigje në kohë reale. Kërkesat kanë ardhur kryesisht nga ana e qytetarëve, shoqëria civile, mediat dhe partitë politike. Një punë tejet të rëndësishme, Zyra për Informim ka bërë në publikimin në web faqe të të gjitha akteve komunale në gjuhët zyrtare, sikurse edhe vendimet, procesverbalet, njoftimet e konkurset etj.

Një hap drejtë transparencës më të madhe është bërë me publikimin e kontratave me operatorët, si vazhdimësi e partneriteti me USAID.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Zyra për Informim Publik, ka vazhduar implementimin e projektit shumë të rëndësishëm për avancimin e transparencës “Livestream”, ku njëmbëdhjetë seancat e Kuvendit Komunal të Gjilanit janë transmetuar drejtpërdrejtë në kanalën zyrtar të Komunës në Youtube, derisa videot e plota janë publikuar në web faqe.

Ky është projekti i parë i kësaj natyre i realizuar në nivel vendi, i cili ka nisur në shkurt 2016 dhe është realizuar me një shumë simbolike.

Pas çdo mbledhje të Kuvendit Komunal të Gjilanit, ZIP u ka përcjellë mediave komunikatë zyrtare me ballafaqim pozitiv-opozitë. Edhe për këtë duhet përmendur faktin që Gjilani është komuna e vetme që lanson kumtesë për media të kësaj natyre.

Gjatë kësaj periudhe, ZIP ka mbuluar të gjitha mbledhjet e trupave të Kuvendit (Komitetet), duke ua përcjellë mediave kumtesën zyrtare për atë se çka është diskutuar e vendosur në komitete.

Gjithashtu, Zyra për Informim ka përgatitur, e dizajnuar të gjitha llojet e ftesave, mirënjohjeve, çmimeve, në kuadër të punës së vitit 2019.

Bashkëpunimi i mirë i Zyrës për Informim Publik e Komunës së Gjilanit me mediat, ka bërë që të gjitha aktivitetet e ekzekutivit dhe legjislativit të mbulohen në mënyrën më të mirë, edhe atë në portale, gazeta, televizione dhe radio, për çka shprehim falënderim të veçantë!

VIII. ZYRA PËR INTEGRIME EVROPIANE

Misioni i Zyrës për integrime evropiane është që, “Në bashkëpunim me instancat përkatëse lokale dhe qendrore, të mbështesë Komunën në arritjen e standardeve evropiane dhe përmbushjen e obligimeve të dala nga dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian si dhe të koordinojë të gjithë çështjet lokale të procesit të integritit evropian, përmes respektimit të praktikave dhe rregullave të përcaktuara nga BE-ja.”

Zyra për integrime evropiane gjatë periudhës gjashtëmujore ka zhvilluar një varg aktivitetesh që dalin nga obligimet dhe përgjegjësitë e saja.

Zyra ka përcjellë punën dhe aktivitetet e Komunës;

1. Koordinimin e procesit të integritit evropian;
2. Pjesëmarrjen në caktimin e prioriteteve komunale dhe zhvillimit të kornizës rregullative dhe të politikave nga ana e Drejtorive sektoriale, me qëllim të reflektimit të obligimeve përkatëse në lidhje me integrimin evropian në kuadër të secilit sektor;
3. Monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit dokumenteve strategjike dhe prioriteteve komunale te Kryetari i Komunës dhe autoritetet qendrore, përmes Ministrisë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale;
4. Koordinimin dhe pjesëmarrjen në zhvillimin dhe implementimin e politikave dhe strategjive me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve të Komunave për të kryer më sukses të gjitha reformat e nevojshme, përfshirë monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të tyre;
5. Ofrimin e mbështetjes të gjitha strukturave komunale në përmirësimin e konsultimeve dhe dialogun civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara dhe publikun e gjerë në nivelin komunal.
6. Ngritjen e vetëdijes së administratës komunale, shoqërisë civile, mediave, komunitetit të biznesit si dhe të publikut të gjerë mbi procesin e integritit evropian dhe promovimin e vlerave dhe standardeve evropiane.
7. Përveç obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara ZKI ka organizuar Javën e Evropës, duke organizuar debate, konferenca dhe aktivitete tjera me qëllim të informimit me strukturat dhe kriteret e BE.
- 9 .ZKIE ka raportuar në mënyrë permanente në MAPL dhe MI.

IX. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Pozicioni dhe mandati i Zyrës Komunale për komunitet dhe kthim rregullohet me Rregulloren 2010/02.

Ky raport përfshin fushat e mëposhtme të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim:

1. Kthim i qëndrueshëm
2. Procesi i ri pranimit

3. Çështjet e komuniteteve

Duhet të theksohet se për periudhën raportuese, sipas të dhënave të cilat udhëheq zyra, janë regjistruar 126 raste ose kërkesa, si më poshtë:

Procesi i ri pranimit ----- 3

Kthim i qëndrueshëm ----- 9

Çështjet e komuniteteve ----- 69

Lëndët e zyrës----- 45

Kthim i qëndrueshëm:

Në pajtim me Rregulloren 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjen e përhershme, me vendim të Kryetarit të Komunës më 15.01.2019, u krijua një Komision komunal për kthim, i përbërë prej 8 anëtarëve.

Sipas të dhënave të ZKKK, në vitin 2019, 4 persona kanë aplikuar në zyrë, 5 persona kanë kërkuar ndihmë direkt përmes UNHCR. Prandaj, të gjithë personat në listë (9 persona nga komuniteti serb) përmes punës së përbashkët të ZKKK dhe UNHCR janë regjistruar në Regjistrin e kthimit.

- Komuna e Gjilanit në fillim të vitit 2019 ka nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi me DRC (Këshillin Danez të Refugjatëve) për projektin BPRM, ndihmë dhe mbështetje të familjeve të kthyer në drejtim të;
- Rindërtimin të shtëpive dhe projekte AG (projekte për hapjen e biznesit familjar)
- Projektet e granteve rurale
- Në kontekstin e këtij programi, kemi pasur disa aktivitete, të cilat janë:
- Puna në terren (plotësimi i një pyetësori për 80 familje)
- Vlerësimet në terren për përdoruesit të mundshëm
- Takim me drejtorin e Administratës Komunale, drejtorin për Bujqësi dhe drejtorin e drejtorisë të Zhvillimit Ekonomik
- Dy takime publike me familjet e kthyer të interesuara dhe qytetarë të tjerë (informacioni rreth programit dhe projekteve të zhvillimit rural).
- Tri (3) trajnime për përfituesit e zgjedhur për një grant rural
- Organizimi i një panairi (Gjilan, Klinë dhe Prizren) për familje cilat kanë përfituar grante rurale
- Trajnimi dhe përmirësimi i stafit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim (menaxhimi në bazën e të dhënave, puna në programet kompjuterike etj.)
- Punëtori dhe trajnime për anëtarët e komisionit komunal për kthim.

Projekti i përmendur DRC - BPRM është realizuar plotësisht:

- Është rinovuar një shtëpi
- Projekte AG për 4 (katër) familje
- Grante rurale për 10 (dhjetë) familje (9 familje serbe dhe 1 familje shqiptare)

Me nënshkrimin e Memorandumit (Komuna e Gjilanit dhe DRC) në fillim të nëntorit 2019, i njëjti projekt do të vazhdojë të zbatohet gjatë vitit 2020 për familje të kthyer në Gjilan. Në

fillim të dhjetorit 2019, kemi mbajtur takimin tonë të parë në mënyrë që të zhvillohet koncepti se si do të zbatohet projekti gjatë vitit 2020.

- Komisioni komunal për kthim.
- Ka mbajtur dy (2) takime.

Takimi i parë i komisionit komunal.

U diskutua rreth katër (4) përfituesve potencialë për të ndihmuar në rindërtimin e shtëpive dhe projekteve AG (projekti i fillimit të biznesit). Të katër (4) përfituesit u pranuan në komision dhe janë rekomanduar në Komisionit Qendror për procesin e mëtejshëm.

Takimi i dytë i komisionit komunal

U diskutua rreth projektit grantit rural. Në total kanë aplikuar 18 aplikues në thirrjen publike që është shpallur nga DRC. Sipas kriterëve të DRC-së, u krijua një listë prej 10 përdoruesve. Komisioni komunal miratoi këtë listë prej 10 përfituesve.

MKK (Ministria për Komunitete dhe Kthim)

Si pjesë të këtij projekti të BPRM / DRC, u mbajt një (1) takim në nivelin qendror për katër (4) përfitues potencial të rekomanduar nga Komisioni komunal për kthim. Të katër (4) përdoruesit janë miratuar.

I jemi drejtuar me kërkesë Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, ku kemi kërkuar ndihmë për ndërtimin e tri (3) shtëpive për familje të kthyer të cilat janë në listën e prioriteteve. Dy (2) familje romë që jetojnë si qiramarrëse dhe një familje nga komuniteti serb (nëna vetushqyese).

UNHCR

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur disa vizita në terren (monitorim të të drejtave të njeriut dhe nivel të integritit) me përfaqësuesit e UNHCR-it. Monitorimi bëhet për familjet që janë të regjistruara dhe të asistuar gjatë 6-12 muajve të fundit. Gjatë monitorimit u konstatua se nuk kishte probleme të sigurisë, që familjet kishin qasje të plotë në të gjitha shërbimet publike në komunë dhe kanë rregulluar dokumentacionin personal.

- Me punën në terren me përfaqësuesit e UNHCR-it, tek anëtarët e komunitetit rom, ne kemi krijuar dhe rishikuar listën e të kthyerve që jetojnë si qiramarrës dhe janë raste sociale. Lista iu është dërguar Ministrisë dhe presim ndihmë adekuate në periudhën e ardhshme.
- Nëpërmjet bashkëpunimit me përfaqësuesit e UNHCR-it dhe AT, me fëmijët e familjeve të kthyer të komunitetit rom, ne festuam Ditën botërore të fëmijëve përmes argëtimit dhe koktejit.
 - Dita ndërkombëtare e refugjatëve në Komunën e Gjilanit, u shënuar duke punuar me përfaqësuesit e UNHCR-it dhe AT në terren është biseduar me qytetarët dhe janë shpërndarë broshura dhe informatorë.

- Puna në terren me stafin e UNHCR- it, ndihmë me një pako ushqimore dhe dru zjarri për katër (4) familje të komunitetit rom.

Procesi i riintegrit të personave të riatdhesuar

Gjatë kësaj periudhe raportuese, të gjitha aktivitetet që lidhen me procesin e riintegrit ose ripranimit janë në përputhje me ligjin e aplikueshëm 13/2017 "Të drejtat e ndihmës dhe kriteret reale" të Ministrisë së punëve të brendshme.

Në periudhën prej 01.01.2019 deri më 18.10.2019, sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme dhe bazës së të dhënave që kemi, janë kthyer dhe në sistem është plotësuar edhe me nëntëmbëdhjetë (19) familje ose individë.

Sipas regjistrimit të personave të ripranuar në ZKKK, kemi pranuar tri (3) kërkesa për përfituesit e mundshëm për ofrimin e ndihmës në këtë proces.

Përveç numrit të kërkesave, dyzet e dy (42) persona nga procesi i ripranimit personalisht iu drejtuan zyrës me kërkesa të ndryshme (informacione mbi procesin e ripranimit, plotësimi i dokumenteve, regjistrimi në sistemin elektronik, lëshimi e një certifikate nga sistemi elektronik, ndihmë për punësim, ndihmë për të shkruar një biznes projekt, regjistrim shtesë në bazën e të dhënave elektronike të Ministrisë së Punëve të Brendshme etj).

Është bërë regjistrimi dhe plotësimi në bazën elektronike të të dhënave në Ministrinë e punëve të brendshme.

Zyrtarët e ZKKK-së janë në kontakt të përditshëm me koordinatorin rajonal të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Për periudhën e përmendur me koordinatorin rajonal të MPB-së, kemi pasur shtatëmbëdhjetë (17) vizita në terren. Gjatë këtyre vizitave janë vizituar tridhjetë e pesë (35) persona.

Përveç vizitave me koordinatorin rajonal të MPB-së, kemi pasur edhe katër (4) vizita në terren për katër (4) persona, nga procesi i ripranimit me përfaqësuesit e organizatës GIZ.

GIZ-i është një nga partnerët e rëndësishëm në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes në këtë proces.

Komisioni komunal i ripranimit mbajti një (1) mbledhje, ku janë shqyrtuar dy (2) kërkesa:

Kërkesa për renovimin e shtëpisë - - - - - Kërkesa e refuzuar

Kërkesa për mobile - - - - - Kërkesa e refuzuar

Kërkesat u refuzuan në bazë të procesverbalit të punës së Qendrës për punë sociale, i cili në bazë të punës në terren vizitoi familjen e aplikuesit për ndihmë dhe vërtetoi gjendjen faktike dhe verifikoi se kjo familje nuk i përket kategorisë së personave të cenuar. Ky vendim dhe

procesverbali i komisionit në fjalë, janë bazë për Komisionin e Riintegritimit Komunal për të marrë një vendim përfundimtar, duke respektuar rregullativën 13/2017 neni 18.

Përveç këtyre aktiviteteve kemi marrë pjesë në:

Bazuar në rekomandimin e Ministrisë së Brendshme, Kryetari i Komunës së Gjilanit themeloi një komision për të hartuar një plan komunal për integrimin e qëndrueshëm të personave të kthyer nga procesi i ripranimit. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë siç parashikohet nga MPB. Komisioni ka për detyrë të hartojë një plan komunal në periudhën e ardhshme, i cili më pas do t'i përcillet Kuvendit për miratim.

Pyetjet e komuniteteve:

Ministria për Komunitete dhe Kthim, në bazë të kërkesave dhe kritereve nga buxheti i vet ka financuar ndërtimin e katër (4) shtëpive për anëtarët e komunitetit serb. Nga organi mbikëqyrës, komisioni dhe me praninë e zyrtarëve të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, është bërë një pranim teknikë dhe çelësat janë dorëzuar për shtëpitë e ndërtuara, për të gjithë përdoruesit.

Në projektin "Giz" janë realizuar dy vizita në dy (2) familje me gjithsej shtatë (7) anëtarë të komunitetit rom. Janë analizuar nevojat, prona, gjendje materiale dhe shëndetësore të këtyre familjeve, si dhe nevojat prioritare për ndihmë të mundshme.

Aktiviteti në Kryqin e Kuq - Gjilan për të ndihmuar anëtarët e komunitetit rom me një pako rrobash.

Ndihma në asistencë anëtarëve të komunitetit rom në ushtrimin e të drejtës për sigurimin material për nënat vetushqyese.

Lëshimi i certifikatave të përkatësisë etnike anëtarëve turk, boshnjak, goran për regjistrimin në fakultete dhe rregullimin e dokumenteve personale,

Plotësimi i pyetësorit në bazë kërkesës nga Zyra për të Drejtat e njeriut dhe Ministrisë së vetëqeverisjes lokale, për të drejtat e komuniteteve me një fokus të veçantë në komunitetin RAE.

Aktivitet me personelin e Policisë së Kosovës, në organizimin e turneut në basketboll nga KFOR-i, një ekip i caktuar nga komuniteti Rom.

Aktivitet me stafin e Umnik-ut dhe Ombusperson, shkëmbimi i informacioneve mbi edukimin e anëtarëve të komunitetit rom, numri i nxënësve në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe numri i pjesëtarëve të komunitetit rom që vijojnë fakultetin, struktura gjinore të studentëve si dhe numri i stafit mësimdhënës nga komuniteti.

IOM-i ka ndarë 2 (dy) grante për anëtarët të komunitetit serb për themelimin e bizneseve private. Lartësia e grantit është 4,000 €.

Me mbështetjen financiare të IOM-it dhe MCR, u realizua një projekt për Shtëpinë e Kulturës në Shillovë. Qendra Kulturore është pajisur me video pajisje dhe materiale të tjera për projeksione filmike. Lartësia e projektit në fjalë është 6,000 €.

ZKKK është pjesë e një projektit të zbatuar nga Zyra e Kryeministrit / Zyra e Komisionerit për Gjuhët, i cili përfshin punën me të rinjtë e të gjitha komuniteteve në lidhje me fushatat ndërgjegjësuese për të inkurajuar të rinjtë për trajtim profesional dhe të mësojnë gjuhë përmes projektit.

ZKKK, në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të Komunës së Gjilanit, ka organizuar një takim me menaxhmentin e OJQ-së 'VORAE', lidhur me vazhdimin e punës së Qendrës së Edukimit të Komunitetit RAE në Komunën e Gjilanit.

Të dhënat statistikore

ZKKK posedon bazën e të dhënave për personat nga procesi i kthimit dhe procesi i riatdhesimit. Baza e të dhënave përditësohet çdo ditë dhe udhëhiqen të dhënat statistikore.

Më poshtë kemi statistikën për personat nga programi i ripranimit

Shteti	Vendi I lindjes	data e kthimit	Komuna	data dhe muaj e largimit	Mënyra e riatdhesimit	me familje	Individualisht	Meshkuj	Femra	Fëmijë	Nacionaliteti
Franca	Gjilan	15.10.2019	Gjilana	0/0/2013	Me dhunë	√	/	1	1	2	Shp.
Franca	Laqiq	20.09.2019	Gjilana	05.01.2015	Vullnetar	/	√	1	/	/	Shp.
Gjermania	Gjilan	10.9.2019	Gjilana	0/0/1997	Me dhunë	√	/	1	1	2	Rom
Franca	Gjilan	6.8.	Gjilana	13.7.2017	Vullnetar	√	/	/	1	2	Shp.
Franca	Gjilan	6.8.	Gjilana	13.7.2017	Vullnetar	/	√	1	/	/	Shp.
Gjermania	Gjilan	11.07.2019	Gjilana	22.12.2014	Me dhunë	/		1	/	/	Shp.
Gjermania	Kravariçe	23.07.2019	Gjilana	23.10.2014	Vullnetar	√	/	1	1	3	Shp
Gjermania	Bukovik	21.05.2019	Gjilana	26.12.2014	Vullnetar	√	/	1	/	1	Shp
Gjermania	Pogragj	13.08.2019	Gjilana	0/0/2017	Me dhunë	√	/	1	1	1	Shp
Gjermania	Gjilan	21.3.2019	Gjilana	17.01.2015	Vullnetar	√	/	1	1	2	Shq.

Franca	Malishevë	07.04.2019	Gjilana	15.10.2017	Vullnetar	√	/	1	1	/	Shq.
Suedi	Gjilan	11.6.2019	Gjilana	0/0/2003	Me dhunë	√	/	1	1	1	Rom.
Franca	Radivojc	05.02.2019	Gjilana	27.09.2017	Vullnetar	√	/	1	1	/	Shq.
Zvicra	Muçibab	16.04.2019	Gjilana	0/0/2016	Me dhunë	/	√	/	1	/	Shq.
Franca	Gjilan	28.02.2019	Gjilana	25.08.2017	Me dhunë	/	√	1	/	/	Shq.
Franca	Zhegër	05.02.2019	Gjilana	27.09.2017	Vullnetar	/	√	/	1	/	Shq.
Austri	Kopërrnicë	31.01.2019	Gjilana	26.08.2016	Me dhunë	/	√	/	1		Shq.
Austri	Pogragjë	31.01.2019	Gjilana	26.08.2016	Me dhunë	√	/	1	/	2	Shq.
Zvicra	Muçibaba	09.01.2019	Gjilana	0/0/2016	Me dhunë	/	√	/	1	/	Shq.

11	8	13	14	16
----	---	----	----	----

X. ZYRA E AVOKATIT TË KOMUNËS

Aktivitetet:

- Seanca gjyqësore në çështje juridike të ndryshme - 608,
- Padi nga Komuna - 2,
- Padi kundër Komunës - 99
- Përgjigje në padi - 99,
- Plotësim të përgjigjeve në padi - 1,
- Fjalë përfundimtare - 54,
- Ankesa - 123,
- Përgjigje në Ankesë - 48,
- Revizione - 10,
- Përgjigje në revizion - 4,
- Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë - 16,
- Kundërshtime / Prapësime - 20,
- Parashtresa - 132,
- Kërkesa - njoftime drejtorive (email) - 237,
- Aktgjykime– aktvendime të gjykatës themelore - 262,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës së Apelit - 124,
- Aktgjykime – aktvendime të gjykatës Supreme -4,
- Pranimi i thirrjeve për seancë - 643.
- Propozim për përmbarim nga pala-24
- Propozim për përmbarim nga Komuna-22

Gjithsejtë aktivitete 2532

- Të refuzuar palës – 46
- Në rigjykim – 6
- Të tërhequra – 15
- Përfundon procesi -38
- Të pezulluara – 3
- Hedhet poshtë – 3

Detyrimet Kontingjente:

1. 8,039,461.82 Vlera e lëndëve (kërkesëpadive) në shkallë I-rë
 2. 2,865,254.05 Vlera e lëndëve (kërkesëpadive) në shkallë II-të
 3. 45,442.60 Shpenzime procedurale (barrë e komunës)
-

Gjithsejtë 10,950,158.4

Sfidat:

Sfidat për vitin 2019 si në vijim;

- Numri i madh i lëndëve gjyqësore në raport me komunën.
- Problem mbetet edhe më tutje zgjidhja e çështjes së shpronësimeve që kanë ndodhur para lufte dhe pas lufte.
- Gjithashtu hapja e rrugëve të ndryshme, nuk duhet të ndodh pa përfunduar shpronësimet dhe pa u bërë bartja e tyre në emër të komunës. Përpos kompensimeve për shpronësime, palët në gjykatë po kërkojnë edhe kamatën ligjore dhe kompensimet për avokatë, të gjitha këto e rëndojnë buxhetin e komunës.
- Problem i vazhdueshëm mbeten lëndët e ndryshme nga çështja e arsimit (mos pagesave e pagave për angazhimet në punë në të kaluarën, mos pagesa e pagave me rastin e pensionimit dhe kompensimet tjera etj.
- Problem në vete në vazhdim paraqiten në gjykatë edhe kërkesat sa i përket kompensimeve për dëmin e pretenduar se ju është shkaktuar palëve të ndryshme kontraktuese në raport me komunën si autoritet publik, për mos zbatim të kontratave apo zbatim të pjesshëm të tyre.

XI. ZYRA PËR PRESHEVË, BUJANOC DHE METVEGJË

Në pika të shkurta do t'iu paraqes raportin për vitin 2019, të zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, lidhur me punën dhe aktivitetet që do t'i kem si zyre që funksionojmë në kuadër të zyrës së Kryetarit të Komunës.

Gjatë kësaj periudhe dymbëdhjetë mujore, kemi mbajtur takime të rregullta me Zyrën për Azil dhe Migracion, MPB- Prishtinë, po ashtu më datën 07.09.2019 kemi mbajtur takim me qytetarët e Kosovës Lindore në restorant Bujana, me përfaqësuesit e MPB-së, ku pjesë e këtij takimi kanë qenë edhe përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, ku kemi diskutuar me qytetarët e

Kosovës Lindore dhe i kemi njoftuar se me datën 03.09.2019 është nënshkruar Udhëzimi Administrativ nr. 09/2019 për Procedurat dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt, ku edhe qytetarët e Kosovës Lindore bëjnë pjesë në këtë Udhëzimi Administrativ i cili udhëzim do t'ia mundësoj këtyre qytetarëve pajisjen me dokument identifikimi të përhershëm ose të përkohshëm deri në plotësimin e kushteve për marrjen e Shtetësisë së Kosovës.

Në këtë takim ne si komunë kemi kërkuar nga MPB, të dimë se cilat kompetenca i kemi ne si zyre për t'ia kompletuar dokumentet këtyre qytetarëve, sepse kemi menduar se nëse ne jemi kompetent për kompletimin e dokumentacionit ta bëjmë një sportel apo zyre enkas për këta qytetar për t'ia kompletuar dokumentet, mirëpo nga zyrtarët e MPB-së, kemi marr përgjigje se ne si komune nuk kemi të bëjmë asgjë lidhur me kompletimin e dokumenteve, por megjithatë ne si zyre prapë se prapë i kemi nxjerr disa kritere nga Udhëzimi Administrativ për kompletimin e dokumenteve, që së paku po ia lehtësojmë procedurat për aplikim.

Deri më tani në zyrën tonë janë paraqitur gjithsej 650 qytetar, ndërsa deri më tani mbi 350 qytetar kanë aplikuar për letërnjoftim të përkohshëm 5 vjeçar, ndërsa 255 qytetar, janë duke i kompletuar dokumentet për aplikim për letërnjoftim nga këta, 45 janë ankuar tek ne edhe pse këta qytetar i plotësojnë kushtet për të aplikuar për letërnjoftim të përkohshëm 5 vjeçar.

Këtyre qytetareve ia kanë refuzuar të drejtën e aplikimit për letërnjoftim të përkohshëm sepse po ju kërkohet dëshmia e banimit 5 vjeçar, ku si dëshmi po ja kërkojnë faturat e rrymës, ku unë sipas vizitave që po i bëjë tek qytetarët e Kosovës Lindore, një pjesë e madhe është duke jetuar me qira ose kemi raste kur këta qytetar janë duke banuar në shtëpi me qira dhe pa pagese.

Të gjithë këta te cilët kanë aplikuar për letërnjoftim të përkohshëm ende nuk i kanë pajisur me letërnjoftim e që e kanë kaluar edhe afatin ligjor mbi tremujsh (3) ku ne si zyre i kemi thirrur ne telefon për të lënë një takim në MPB, për ti pyetur rreth këtyre problemeve që po hasin këta qytetar gjithë na është thënë jemi jashtë vendit.

Dhe krejt në fund na mbete si zyre ne bashkëpunim me kryetari e Komunës z. Lutfi Haziri t'ju drejtohem me një shkresë Ministrisë të Punëve të Brendshme në Prishtinë, lidhur me ngecjen e punës rrethe thirrjeve të qytetarëve për tu pajisur me letërnjoftim po ashtu edhe rrethe mos zbatimit të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2019 për Procedurat dhe Kriteret e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt.